



Republika e Shqipërisë  
Ministria e Integritit



## ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit European

*Profesor Klaus-Dieter Borchardt*



Projekt i financuar nga  
Bashkimi European (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane



Federal Ministry  
for Economic Cooperation  
and Development



Projekt i zbatuar nga  
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

# ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit European

*nga Profesor Klaus-Dieter Borchardt*

Botuar për herë të parë në gjuhën angleze me titullin  
*The ABC of European Union law*  
nga Zyra e Botimeve të Bashkimit Europian  
© Bashkimi Europian, 2010

Botimi në shqip: © Ministria e Integritimit, 2011  
Ministria e Integritimit Europian mban plotësisht përgjegjësinë për përkthimin

Fotot në faqet 8, 23, 35, 56, 67, 84, 94, 116 dhe 124:  
Fonti i Medias së Komisionit Europian, Bruksel. © Bashkimi Europian, 2010

*Botim i:*  
Ministritë së Integritimit Europian

*Ky botim u mbështet nga:*  
Ky botim u mbështet nga Projekti: “Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)”. Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

*Përgatiti për shtyp:*  
Blerina Raça

*Përkthet:*  
Rudina Vuksani Nervaj

*Redaktimi gjubësor:*  
Dr. Mariana Ymeri

*Redaktimi ligjor:*  
Prof. Dr Xhezair Zaganjori

*Paraqitja grafike:*  
Erald Lamja

*Shtypi:*  
Shtëpia Botuese & Shtypshkronja PEGI

*Ky botim është mundësuar me mbështetjen e Bashkimit Europian dhe Qeverisë Gjermane. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e projektit “Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)” dhe në asnjë mënyre nuk mund të interpretohet si opinion i Bashkimit Europian.*

## SHËNIM PËR LEXUESIN

*ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit European* pasqyron ndryshimet që u janë bërë Traktateve Europiane nga Traktati i Lisbonës. Përveçse rastit kur ka citime apo kur është e nevojshme për shkak të kontekstit historik, nenet e cituara u referohen ekskluzivisht variantit aktual të Traktateve Europiane (*Gazeta Zyrtare e Bashkimit European* C 83 datë 30 Mars 2010). Informacioni që përmbahet në këtë botim, është i saktë deri në mars 2010.

# Përmbajtja

7	<b>PARATHËNIE</b>
9	<b>PREJ PARISIT NË LISBONË, DUKE KALUAR PËRMES ROMËS, MASTRIHTIT, AMSTERDAMIT DHE NISËS</b>
19	<b>VLERAT THEMELORE TË BASHKIMIT EUROPIAN</b>
21	<b>BE-ja si garantuese e paqes</b>
21	<b>Uniteti dhe barazia si motive kryesore</b>
22	<b>Liritë themelore</b>
22	<b>Parimi i solidaritetit</b>
24	<b>Respektimi i identitetit kombëtar</b>
24	<b>Nevoja për siguri</b>
24	<b>Të drejtat themelore</b>
30	<b>'KUSHTETUTA' E BASHKIMIT EUROPIAN</b>
30	<b>Natyra juridike e BE-së</b>
34	<b>Detyrat e BE-së</b>
40	<b>Kompetencat e BE-së</b>
45	<b>Institucionet e BE-së</b>
48	<b>Institucionet: Parlamenti Europian — Këshilli Europian — Këshilli — Komisioni Europian — Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian — Banka Qendrore Europiane — Gjykata e Audituesve</b>
79	<b>Mekanizma këshillimor: Komiteti Europian Ekonomik dhe Social-Komiteti i Rajoneve</b>
81	<b>Banka Europiane e Investimeve</b>
82	<b>RENDI JURIDIK I BE-së</b>
82	<b>BE-ja si krijim i së Drejtës dhe komunitet që bazohet tek e Drejta</b>
83	<b>Burimet e së Drejtës së Bashkimit Europian</b>
84	<b>Traktatet themelues të BE-së si burim parësor i së drejtës së Bashkimit: Instrumentet juridike të BE-së si burim dytësor i së drejtës së Bashkimit</b>

- Marrëveshjet ndërkombëtare të BE-së — Parimet e përgjithshme të së Drejtës — E Drejta zakonore — Marrëveshjet ndërmjet Shteteve Anëtare
- 89 Instrumentet e veprimit të BE-së**
- 92** Rregulloret — Direktivat — Vendimet — Rekomandimet dhe Opinionet — Rezolutat, Deklaratat dhe Programet e Veprimit
- 101 Procesi legjislativ në BE**
- 103** Procedura e zakonshme legjislative — Procedura e miratimit — Procedura e thjeshtuar
- 106 Sistemi i BE-së për mbrojtjen juridike**
- 107** Procedimet për shkelje të traktatit — Padi për anulim — Padi për mosveprim — Padi për dëmshpërblim — Padi nga stafi i komunitetit — Konfliktet ligjore për patentat e bashkimit — Procedura e apelimit — Mbrojtja juridike e përkohshme — Vendimi paragjykimor
- 114 Përgjegjësia e Shtetit Anëtar për shkelje të së drejtës së Bashkimit**
- 115** Përgjegjësia e Shteteve Anëtare për akte juridike dhe për mosveprim — Përgjegjësia e gjykatave për shkelje të së drejtës së Bashkimit
- 117 VENDI I TË DREJTËS SË BASHKIMIT NË RAPORT ME RENDIN JURIDIK NË TËRËSI**
- 117 Autonomia e rendit juridik të BE-SË**
- 118 Ndërveprimi ndërmjet së drejtës së bashkimit dhe së drejtës kombëtare**
- 121 Konflikti ndërmjet së drejtës së Bashkimit dhe së drejtës kombëtare**
- 121** Zbatimi i drejtpërdrejtë i të drejtës së Bashkimit në të drejtën kombëtare — Epërsia e së drejtës së Bashkimit mbi të drejtën kombëtare — Interpretimi i së drejtës kombëtare në përputhje me të drejtën e Bashkimit
- 130 PËRFUNDIME**
- 131 SHTOJÇË**



## Parathënie

Rendi juridik i krijuar nga Bashkimi European (BE) është bërë tashmë pjesë e pandarë e jetës sonë politike dhe e shoqërisë. Në zbatim të Traktateve të BE-së, çdo vit merren me mijëra vendime me efekte thelbësore për Shtetet Anëtare dhe jetën e shtetasve të tyre. Prej kohësh, individët nuk janë më thjesht qytetarë të vendit, qytetit apo rajonit ku jetojnë, por edhe qytetarë të Bashkimit European. Në këtë këndvështrim, është shumë e rëndësishme që ata të informohen për rendin juridik që ndikon në jetën e tyre të përditshme. Gjithsesi, kompleksiteti i strukturës së Bashkimit dhe i rendit të tij ligjor nuk janë të lehta për t'u kuptuar. Arsyeja e parë është se traktatet kanë formulim disi të ndërlikuar, duke bërë që detyrimet e percaktuara të mos jenë lehtësisht të kapshme. Një tjetër arsye është mungesa e familjaritetit me shumë koncepte, me të cilat operojnë traktatet. Ky punim është një përpjekje për të sqaruar strukturën e Bashkimit dhe shtyllat mbështetëse të rendit juridik european, si dhe për të ndihmuar qytetarët e BE-së të kuptojnë më mirë të drejtën europiane.





7 Maj 1948, Hagë.

Winston Churchill pritet ngrohtësisht në Kongresin e Europës. Ish- Kryeministri Britanik, lideri i opozitës në atë kohë, drejtoi seancën e hapjes së Kongresit. Më 19 shtator 1946, ai bëri thirrje për bashkim europian në fjalimin e tij në Zyrh.

## Prej Parisit në Lisbonë, duke kaluar përmes Romës, Mاستrihtit, Amsterdamit dhe Nisës

Në vitet e para pas Luftës II Botërore, koncepti ynë për shtetin dhe jetën politike ishte ngjizur duke u bazuar pothuajse krejtësisht te kushtetuta dhe legjislatiioni i secilit vend. Pikërisht mbi këtë bazë u krijuan rregullat e sjelljes që janë të detyrueshme jo vetëm për shtetasit dhe palët e tjera në shtetet tona demokratike, por edhe për vetë shtetin dhe organet e tij. U desh shkatërrimi i Europës dhe rrënimi i saj politik dhe ekonomik, që të pëqeshin kushtet për një fillim të ri dhe për t'i dhënë një shtysë të re idesë së një rendi të ri europian.

Pas Luftës II Botërore, në kuadër të përpjekjeve për bashkimin e Europës, u krijuan një sërë organizatash, të cilat vështirë t'i mbash mend. Për shembull, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Bashkimi European Perëndimor (BEP), Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Këshilli i Europës dhe Bashkimi European bashkëjetojnë pa ndonjë lidhje të thelbësore mes tyre. Numri i vendeve anëtare në këto organizata varion nga 10 (BEP) deri në 47 (Këshilli i Europës).

Kjo mori organizatash është e justifikueshme nga pikëpamja e strukturës vetëm nëse analizojmë qëllimet dhe objektivat e tyre specifike. Ato mund të ndahen në tre grupime kryesore.

### **GRUPIMI I PARË: ORGANIZATAT E EURO-ATLANTIKUT**

Organizatata euro-atlantike u krijuan pas Luftës II Botërore, si rezultat i aleancës ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Europës. Nuk është rastësi që organizata e parë europiane e pasluftës, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik European (OEEC) e themeluar më 1948, u krijua me nismën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në vitin 1947, Sekretari amerikan i Shtetit në atë kohë, George Marshall, u bëri thirrje shteteve të Europës të bashkonin forcat për

rindërtimin e ekonomive të tyre, dhe për këtë qëllim premtoi edhe ndihmën e SHBA-së. Kjo ndihmë u mishërua në Planin Marshall, i cili hodhi bazat për rindërtimin e shpejtë të Europës Perëndimore. Qëllimi fillestar i OEEC-së konsistonte kryesisht në liberalizimin e tregtisë ndërmjet vendeve. Në vitin 1960, shtetet anëtare të OEEC-së, të cilave iu bashkuan edhe SHBA-ja dhe Kanadaja, shtuan edhe një objektiv tjetër, që ishte nxitja e progresit ekonomik në vendet e Botës së Tretë, nëpërmjet ndihmës për zhvillim. Kësisoj, OEEC u bë OECD.

Në vitin 1949 u themelua NATO, si një aleancë ushtarake me pjesëmarrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë. Për të forcuar bashkëpunimin politik mes vendeve europiane në lidhje me çështjet e sigurimit, në vitin 1954 u krijua BEP, që përfshinte shtetet nënshkruese të Traktatit të Brukselit (Belgjikën, Francën, Luksemburgun, Holandën dhe Mbretërinë e Bashkuar), të cilave iu bashkuan edhe Republika Federale e Gjermanisë dhe Italia. Ndërkohë, anëtare janë bërë edhe Portugalia, Spanja dhe Greqia. BEP shënoi në vitin 1954 fillimet e një politike për sigurinë dhe mbrojtjen në Europë. Megjithatë, roli i tij nuk është zhvilluar më tej, duke qenë se pjesa më e madhe e kompetencave iu është kaluar institucioneve të tjera ndërkombëtare, sidomos NATO-s, Këshillit të Europës dhe BE-së. BEP vazhdon të jetë përgjegjëse për mbrojtjen kolektive, një rol ky, që ende nuk i është kaluar BE-së.

## **GRUPIMI I DYTË: KËSHILLI I EUROPËS DHE OSBE-ja**

Tipari i përbashkët i grupimit të dytë të organizatave europiane është struktura e tyre, e cila mundëson pjesëmarrjen e sa më shumë vendeve. Sakaq, ekzistonte mirëkuptimi që bashkëpunimi ndërmjet këtyre organizatave, nuk do të shkonte përtej bashkëpunimit tradicional mes shteteve.

Në këtë grup bën pjesë Këshilli i Europës, i themeluar si institucion politik më 5 maj 1949. Në statutin e Këshillit të Europës nuk përmendet vullneti për të krijuar një federatë apo bashkim dhe as për ndonjë transferim apo ushtrim të përbashkët të të drejtave sovrane. Vendimet për të gjitha çështjet e rëndësishme merren mbi bazën e parimit të unanimitetit, çka nënkupton se çdo vend ka të drejtën e vetos; ky rregull zbatohet edhe në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Që në fillimet e tij, Këshilli i Europës u konceptua si një mekanizëm për bashkëpunimin ndërkombëtar mes shteteve anëtare. Me

nismën e Këshillit të Europës janë miratuar konventa të shumta në fushën ekonomike, politike, kulturore, politiko-sociale dhe të drejtësisë. Mes tyre, më e rëndësishmja -dhe më e njohura- është Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e nënshkruar më 4 nëntor 1950 (Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut ose KEDNj). Kjo Konventë, jo vetëm që përcaktoi një nivel minimal për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për t'u zbatuar nga Shtetet Anëtare, por krijoi edhe një sistem me garanci juridike, që u jepte organeve të ngritura prej saj (Komisionit Europian për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut) kompetencën për të dënuar shkeljen e të drejtave të njeriut në Shtetet Anëtare.

Këtij grupimi organizatash i përket edhe OSBE (Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë), e themeluar më 1994, në vijim të Konferencës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë. OSBE-ja u përmbahet parimeve dhe qëllimeve të parashtruara në Aktin Final të Helsinkit të vitit 1975 dhe Kartës së Parisit të vitit 1990. Përkrah masave për të krijuar një klimë besimi ndërmjet vendeve të Europës, këto objektiva përfshijnë edhe realizimin e një 'rrjeti sigurie' për të mundësuar zgjidhjen e konflikteve me mjete paqësore. Në të vërtetë, ngjarjet e fundit kanë treguar se Europa ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim.

## GRUPIMI I TRETË: BASHKIMI EUROPIAN

Grupimi i tretë i organizatave europiane përfshin Bashkimin Europian. BE-ja dallon nga organizatat ndërkombëtare tradicionale mes Shteteve për shkak të një tipari thelbësor: BE-ja bashkon Shtete Anëtare, që kanë hequr dorë pjesërisht nga disa të drejta sovraane të tyre në favor të BE-së dhe i kanë dhënë kësaj të fundit kompetenca për të vepruar e pavarur prej Shteteve Anëtare. Në zbatim të këtyre kompetencave, BE-ja miraton legjislacion, që ka të njëjtën fuqi me ligjet e miratuara nga shtetet anetare.

Gurin e parë për ndërtimin e Bashkimit Europian e vendosi ministri i Jashtëm francez i asaj kohe, Robert Schuman, me deklaratën e tij të 9 majit 1950, në të cilën parashtrroi planin për të cilin kishte punuar së bashku me Jean Monnet, që parashikonte bashkimin e industrisë europiane të qymyrit dhe çelikut në një Komunitet Europian të Qymyrit dhe Çelikut. Sipas tij, kjo ishte një nismë historike në favor të "Europës së organizuar dhe energjike",

e cila ishte “e domosdoshme për qytetërimin” dhe pa të cilën “nuk mund të garantohet paqja në botë”. ‘Plani Schuman’ u bë realitet më 18 prill 1951 (Traktati i Parisit), me nënshkrimin nga gjashtë shtetet themeluese (Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda) të Traktatit themelues të Komunitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut (KEQC, i cili hyri në fuqi më 23 korrik 1952. Ky Komunitet u themelua për një periudhë 50-vjeçare dhe u u përfshi në Komunitetin Europian kur traktatit themelues të KEQC i mbaroi afati më 23 korrik 2002. Disa vjet më vonë, mbi bazën e Traktateve të Romës të 25 marsit 1957, po këto Shtete krijuan Komunitetin Ekonomik Europian (KEE) dhe Komunitetin Europian të Energjisë Atomike (KEEA), të cilat e filluan aktivitetin më 1 janar 1958, me hyrjen në fuqi të traktateve respektive.

Krijimi i Bashkimit Europian me anë të Traktatit të Mastrohtit shënoi një etapë të re në procesin e unifikimit politik të Europës. Traktati, i nënshkruar në Mastroht më 7 shkurt 1992, hyri në fuqi vetëm në 1 nëntor 1993, pasi u kapërcyen një sërë pengesash në procesin e ratifikimit (miratimi nga populli danez erdhi vetëm gjatë referendumit të dytë, ndërsa në Gjermani pas vendimit që dha Gjykata Kushtetuese për kushtetueshmërinë e këtij Traktati. Vetë Traktati i Mastrohtit përkufizohet si “një fazë e re në procesin e krijimit të një bashkimi gjithnjë e më të ngushtë ndërmjet popujve të Europës”. Ai përmbante aktin themelues të Bashkimit Europian, pavarësisht se nuk e përfundoi këtë proces. Traktati ishte hapi i parë drejt një sistemi kushtetues europian. Zhvillime të tjera pasuan me Traktatet e Amsterdimit dhe të Nisës, të cilat hynë në fuqi përkatësisht më 1 maj 1999 dhe 1 shkurt 2003. Qëllimi i këtyre reformave ishte të ruhej kapaciteti i BE-së për veprime të efektshme në BE-në e zgjeruar nga 15 në 27 ose më shumë anëtarë. Për këtë arsye, këto dy Traktate u përqendruan te reformat institucionale. Krahasuar me reformat e tjera, në Nisë nuk u konstatua vullneti i duhur politik për të thelluar integrimin europian.

Kritikat që erdhën nga disa shtete, hapën një debat mbi të ardhmen e BE-së dhe organizimin e saj institucional. Si rezultat, më 5 dhjetor 2001 në Laeken (Belgjikë), krerët e Shteteve ose Qeverive, miratuan një Deklaratë mbi të Ardhmen e Bashkimit Europian, në të cilën BE-ja u zotua se do të bëhej më demokratike, më transparente dhe më efektive, si edhe do t’i hapte rrugën krijimit të një Kushtetute Europiane. Hapi i parë për arritjen e këtij synimi ishte krijimi i Konventës Kushtetuese, të kryesuar nga ish-presidenti francez, Valéry Giscard d’Estaing, me detyrën për të hartuar një Kushtetutë Europiane. Me datë

18 korrik 2003, në emër të Konventës, Kryetari i paraqiti zyrtarisht Presidentit të Këshillit European Projekt-Kushtetutën e hartuar nga Konventa. Pasi iu bënë disa ndryshime, ky Projekt u miratua nga Kryetarët e Shteteve ose Qeverive më 17 dhe 18 korrik në Bruksel, pas aderimit të 10 Shteteve të reja Anëtare më 1 maj 2004 dhe pas zgjedhjeve të Parlamentit European, në mes të qershorit 2004.

Kushtetuta synonte ta shndërronte Bashkimin European dhe Komunitetin European, në një Bashkim European të ri dhe unik, bazuar mbi një Traktat të vetëm Kushtetues. Vetëm Komuniteti European i Energjisë Atomike do të vazhdonte të ekzistonte si një komunitet i veçantë, duke bashkëpunuar ngushtësisht me Bashkimin European.

Sidoqoftë, përpjekja për të pasur një Kushtetutë dështoi në procesin e ratifikimit. Pas votimeve në favor të saj në 13 prej 25 Shteteve Anëtare, Traktati u hodh poshtë përmes referendumeve në France (54.68% kundër, pjesëmarrja 69.34%) dhe Holande (61.7% kundër, pjesëmarrja 63%).

Pas një periudhe reflektimi pothuaj dy vjeçare, në gjysmën e parë të vitit 2007 u paraqit një paketë e re reformash. Kjo paketë reformash përfaqësonte njëfarë devijimi nga ideja e një Kushtetute Europiane, sipas të cilës të gjithë traktatet ekzistuese do të zëvendësoheshin nga një tekst i vetëm i quajtur 'Traktati Themelues i Kushtetutës Europiane'. Në të kundërt, u miratua një Traktat Reformash, i cili ashtu si Traktatet paraardhëse të Mاستrihit, Amsterdamit dhe Nisës, bëri disa ndryshime të rëndësishme në Traktatet ekzistuese të BE-së, me qëllim forcimin e kapaciteteve të saj për të vepruar brenda dhe jashtë Bashkimit, forcimin e legjitimitetit demokratik dhe rritjen e efektivitetit të veprimeve të BE-së në përgjithësi. Në vijim të traditës, ky Traktat Reformash u quajt Traktati i Lisbonës.

Traktati u hartua jashtëzakonisht shpejt, më së shumti për shkak se vetë Krerët e Shteteve apo Qeverive parashtruan shumë hollësisht në konkluzionet e takimit të Këshillit European të 21 dhe 22 qershorit 2007 në Bruksel, se si dhe deri në ç'masë ndryshimet e negociuara në Konferencën Ndërqeveritare të 2004-ës do të përfshiheshin në Traktatet ekzistuese. Nisma që ata ndërmoren që e pazakontë, sepse nuk u kufizuan vetëm në dhënien e orientimeve të përgjithshme që do të zbatoheshin nga një Konferencë Ndërqeveritare, por hartuan vetë strukturën dhe përmbajtjen e ndryshimeve që do të bëheshin, madje shpeshherë bënë edhe formulimin e dispozitave. Debatu kryesor u përqendrua në disa aspekte si: ndarja e kompetencave ndërmjet Bashkimit

dhe Shteteve Anëtare; e ardhmja e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit; roli i ri i parlamenteve kombëtare në procesin e integritetit; transpozimi i Kartës së të Drejtave Themelore në të drejtën e Bashkimit dhe progresi në fushën e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale.

Për pasojë, Konferencës Ndërqeveritare që u mbledh më 2007 i mbeti pak hapësirë veprimi. Asaj iu la kompetencë vetëm për të zbatuar teknikisht ndryshimet e kërkuara. Konferenca Ndërqeveritare e përfundoi punën më 18 dhe 19 tetor 2007 dhe mori miratimin politik të Këshillit Europian, i cili po zhvillonte njëkohësisht një takim informal në Lisbonë. Si përfundim, Krerët e Shteteve ose Qeverive të 27 Shteteve Anëtare të BE-së e nënshkruan Traktatin më 13 dhjetor 2007 në Lisbonë.

Procesi i ratifikimit për këtë Traktat rezultoi tejet i vështirë. Megjithatë Traktati i Lisbonës – në ndryshim nga Traktati themelues i Kushtetutës Europiane - u ratifikua me sukses në Francë dhe në Holandë. Ai u rrëzua në referendumin e parë të Irlandës më 12 qershor 2008 (53.4% kundër, pjesëmarrja 53.1%). U desh të vendoseshin disa garanci ligjore që kufizonin fushën e veprimit të Traktatit të ri, që në tetor 2009 të organizohej një referendum i dytë në Irlandë për Traktatin e Lisbonës. Kësaj here, Traktati mori mbështetjen e plotë të popullit irlandez (67.1% pro, pjesëmarrja 59%). Suksesi i referendumit në Irlandë i hapi rrugë ratifikimit të Traktatit të Lisbonës në Poloni dhe në Republikën Çeke. Presidenti polak Kaczyński e kishte kushtëzuar nënshkrimin e instrumentit të ratifikimit me rezultatin pozitiv të referendumit irlandez. Edhe presidenti çek, Václav Klaus, fillimisht donte të priste rezultatin e referendumit irlandez, por më pas e firmosi instrumentin e ratifikimit, pasi mori garanci që “Dekretet e Beneshit” të vitit 1945 - të cilat nuk lejonin ngritjen e pretendimeve për pronësinë mbi sipërfaqe të tokave të Republikës Çeke që më parë kishin qenë të Gjermanisë - nuk do të cenoheshin nga Traktati i Lisbonës dhe sidomos nga Karta e të Drejtave Themelore, e transpozuar në Traktatin e BE-së. Me t’u gjetur zgjidhja për këtë kërkesë, Presidenti çek e nënshkroi instrumentin e ratifikimit më 3 nëntor 2009. Kështu, procesi i ratifikimit u përfundua edhe në vendin e fundit të 27 Shteteve Anëtare dhe Traktati i Lisbonës mundi të hynte në fuqi më 1 dhjetor 2009.

Traktati i Lisbonës shkrin Bashkimin Europian dhe Komunitetin Europian në një Bashkim të vetëm Europian. Fjala ‘Komunitet’ zëvendësohet kudo me fjalën ‘Bashkim’. Bashkimi zëvendëson dhe pason Komunitetin Europian. Megjithatë, ligji i së drejtës i Bashkimit formësohet ende prej tre Traktateve të mëposhtme.

### **Traktati i Bashkimit European**

Traktati i Bashkimit European (Traktati i BE-së — TBE) është ristrukturuar krejtësisht në gjashtë titujt e mëposhtëm: Dispozita të përgjithshme (I), Dispozita për parimet demokratike (II), Dispozita për institucionet (III), Dispozita për forcimin e bashkëpunimit(IV), Dispozita të përgjithshme për veprimin e jashtëm të Bashkimit dhe dispozita specifike për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit (V) dhe Dispozitat përfundimtare (VI).

### **Traktati për Funkcionimin e Bashkimit European**

Traktati për Funkcionimin e Bashkimit European (TFBE) rrjedh prej Traktatit themelues të Komunitetit European dhe ka pak a shumë të njëjten strukturë si Traktati i KE-së. Ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkombëtare të BE-së dhe futjen e kapitujve të rinj, sidomos në lidhje me politikën mbi energjinë, bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale, hapësirën, sportin dhe turizmin.

### **Traktati themelues i Komunitetit European të Energjisë Atomike**

Traktati themelues i Komunitetit European të Energjisë Atomike (Traktati Euratom) është ndryshuar disa herë. Në çdo rast, ndryshimet specifike janë bërë te protokollet që i janë shtuar Traktatit të Lisbonës.

TBE dhe TFBE kanë të njëjtin vlerë juridike. Kysqarim juridik është i nevojshëm, pasi emërtimi i ri i ish-Traktatit të KE-së (“Traktati për Funkcionimin e BE-së”) dhe nivelet e rregullimeve në të dy traktatet, të japin përshtypjen që TBE është një lloj Kushtetute apo Traktati bazë, kurse TFBE nënkuptohet si një Traktat zbatues. E megjithatë, TBE dhe TFBE nuk kanë natyrë kushtetuese. Termat e përdorur përgjithësisht në këto Traktate e reflektojnë këtë qasje të ndryshuar, krahasuar me ish Projekt-Kushtetutën. Shprehja ‘Kushtetutë’ nuk përdoret më; “ministri i Jashtëm i BE-së” përmendet si ‘Përfaqësuesi i



Lartë i Bashkimit për Politikën për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Politikën e Sigurimit'; është hequr dorë nga përkufizimet 'ligj' dhe 'ligj kuadër'. Traktatet e ndryshuara nuk përmbajnë më nene që u referohen simboleve të BE-së, si për shembull flamurit, himnit apo motos. Epërsia e së drejtës së BE-së nuk shprehet në mënyrë eksplicite në traktat, por buron si dhe më parë prej praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European. Kjo praktikë gjyqësore përmendet në një deklaratë shpjeguese.

Në Traktatin e Lisbonës është hequr dorë gjithashtu nga 'tri shtyllat' e BE-së. Shtylla e parë që konsiston kryesisht në tregun e përbashkët dhe politikat e BE-së, bashkohet me çështjet e shtyllës së dytë që konsiston në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, si dhe me shtyllën e tretë që mbulon bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale. Sidoqoftë, kanë mbetur në fuqi procedurat e veçanta që lidhen me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, përfshi mbrojtjen europiane. Deklaratat e Konferencës Ndërqeveritare bashkëlidhur këtij Traktati theksojnë natyrën e veçantë të kësaj fushe dhe përgjegjësitë e veçanta të Shteteve Anëtare në këtë drejtim.

Aktualisht, BE-ja ka 27 Shtete Anëtare. Këtu përfshihen në radhë të parë 6 shtetet bashkëthemeluese të KEE-së, konkretisht Belgjika, Gjermania (përfshi territorin e ish-Republikës Demokratike Gjermane pas bashkimit të dy Gjermanive më 3 tetor 1990), Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda. Më 1 janar 1973, Danimarka (pa Groenlandën e cila me referendumin e shkurtit 1982, edhe pse me diferencë të ngushtë, vendosi që të mos qëndronte në KE), Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar iu bashkuan Komunitetit; hyrja e Norvegjisë u refuzua përmes referendunit popullor në tetor 1972 (me 53.5% të votave kundër anëtarësimit në KE). 'Zgjerimi drejt Jugut' fillon më 1 janar 1981 me pranimin e Greqisë dhe përfundoi më 1 janar 1986 me pranimin e Spanjës dhe Portugalisë. Zgjerimi tjetër ndodhi më 1 janar 1995 kur Austria, Finlanda dhe Suedia u bënë pjesë e BE-së. Në Norvegji, një tjetër referendum vetëm sa përsëriti rezultatin e 22 viteve më parë, thjesht me një shumicë më të vogël (52.4%) kundër anëtarësimit të vendit në BE. Më 1 maj 2004, në Bashkimin European hynë edhe shtetet baltike të Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë, shtetet e Europës Lindore dhe Qendrore: Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Sllovenia dhe Sllovakia, si edhe dy ishujt mesdhetarë Qiproja dhe Malta. Zgjerimi drejt lindjes ndodhi pas pak më shumë se

dy vitesh, me hyrjen e Bullgarisë dhe të Rumanisë më 1 janar 2007. Këto anëtarësime e shtuan numrin e Shteteve Anëtare nga 15 në 27 dhe e rritën popullsinë e BE-së me rreth 90 milionë banorë, duke e çuar në 474 milionë. Ky zgjerim historik i BE-së është tipari thelbësor i një procesi të gjatë që çon drejt ribashkimit të një Europe, e cila për më se gjysmë shekulli, ka qenë e përçarë prej Perdes së Hekurt dhe Luftës së Ftohtë. Ky zgjerim pasqyron mbi të gjitha dëshirën për të sjellë paqe, stabilitet dhe mirëqenie ekonomike në një kontinent evropian të bashkuar.

BE vazhdon negociata për anëtarësim me disa shtete, sidomos me Turqinë, e cila ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në BE që më 14 prill 1987. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Turqisë datojnë edhe më herët. Që më 1963, Turqia dhe KEE lidhën një marrëveshje asociimi, me synimin e një anëtarësimi të mundshëm. Në vitin 1995 u formua bashkimi doganor dhe në dhjetor 1999 në Helsinkë, Këshilli Europian vendosi t'i japë zyrtarisht Turqisë statusin e vendit kandidat. Ky hap pasqyronte besimin se Turqia kishte tiparet themelore të një sistemi demokratik, edhe pse vazhdonte të ishte mjaft problematike për sa u takon të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve. Në dhjetor të vitit 2004, bazuar në rekomandimin e Komisionit, Këshilli Europian ndezi më në fund dritën e gjelbër për hapjen e negociatave për anëtarësim me Turqinë; këto negociata vazhdojnë që prej tetorit 2005. Qëllimi madhor i këtyre negociatave është anëtarësimi, por nuk ka asnjë garanci se ky qëllim do të përmbushet. Brenda BE-së ekziston mendimi se anëtarësimi i Turqisë nuk do të jetë i mundur para vitit 2014. Çdo anëtarësim duhet të përgatitet me kujdes, në mënyrë që të mundësojë integrim gradual dhe të parandalojë vënien në rrezik të arritjeve 50-vjeçare të integritimit evropian. Kandidatë të tjerë për anëtarësim janë Kroacia, negociatat për anëtarësim të së cilës u hapën në tetor 2005, si dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë që mori zyrtarisht statusin e vendit kandidat në dhjetor 2005, por pa caktuar një datë të saktë për hapjen e negociatave për anëtarësim. Islanda e dorëzoi aplikimin për anëtarësim në BE më 17 korrik 2009. Më 24 shkurt 2010, Komisioni Europian i rekomandoi Këshillit të hapë negociatat e anëtarësimit me Islandën.

Aktualisht, BE-ja po punon intensivisht për zgjerime të reja në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ajo ka vendosur të ndjekë me vendet e Ballkanit Perëndimor të njëjtën metodologji që ndoqi më parë për Shtetet e reja Anëtare. Për rrjedhojë, procesi i zgjeruar i Stabilizim-Asociimit mbetet

kuadri i përgjithshëm për rrugëtimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësismit. Një hap i parë i rëndësishëm në këtë drejtim janë 'Partneritetet Europiane' të shpallura me Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi, përfshirë edhe Kosovën.<sup>1</sup> Roli i Partneriteteve Europiane është që të ndihmojnë vendet e Ballkanit Perëndimor me përgatitjet e tyre për anëtarësim brenda një kuadri koherent, si dhe me përgatitjen e planeve të veprimit, në të cilët parashikohet zbatimi i reformave dhe afatet kohore për realizimin e tyre, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat për integrimin e mëtejshëm të këtyre vendeve në BE.

Traktati i Lisbonës parashikon gjithashtu edhe mundësinë e tërheqjes së cdo vendi Anëtar nga Bashkimi Europian. Traktati i BE-së parashikon tashmë shprehimisht një mundësi të tillë. Bashkimi nuk ka vendosur kushte për një tërheqje të tillë; mjafton një marrëveshje ndërmjet BE-së dhe Shtetit Anëtar lidhur me modalitetet e largimit të këtij të fundit. Nëse një marrëveshje e tillë nuk arrihet, atëherë largimi bëhet juridikisht i vlefshëm dy vjet pas njoftimit për tërheqje. Duhet thënë gjithashtu që nuk ka ndonjë dispozitë për përjashtimin e një Shteti Anëtar nga BE-ja për shkelje të rënda dhe të vazhdueshme të Traktateve.

---

<sup>1</sup> Në pajtim me Rezolutën 1244, datë 10 qershor 1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

# Vlerat themelore të Bashkimit European

## ***Neni 2 i TBE (Vlerat e Bashkimit)***

Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e anëtarëve të pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri të karakterizuar nga pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave.

## ***Neni 3 i TBE (Qëllimet e Bashkimit)***

1. Bashkimi ka për synim nxitjen e paqes, vlerave që mbart dhe mirëqenies së popujve të tij.

2. Bashkimi u ofron qytetarëve të tij një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie pa kufij të brendshëm, në të cilën sigurohet lëvizja e lirë e njerëzve së bashku me masat e duhura sa i takon kontrollit të kufijve të jashtëm, azilit, imigracionit, parandalimit të kriminalitetit dhe luftën kundër këtij të fundit.

3. Bashkimi krijon një treg të brendshëm. Ai punon për zhvillimin e qëndrueshëm të Europës, mbështetur në rritjen e drejtpeshuar ekonomike dhe në qëndrueshmërinë e çmimeve, në një ekonomi tregu sociale tejet konkurruese, që synon punësimin e plotë dhe përparimin shoqëror, një nivel të lartë mbrojtjeje dhe përmirësimi të cilësisë së mjedisit. Ai nxit përparimin shkencor dhe teknologjik.

Bashkimi lufton përjashtimin social dhe diskriminimin dhe nxit drejtësinë dhe mbrojtjen sociale, barazinë midis grave dhe burrave, solidaritetin midis brezave dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Ai nxit kohezionin ekonomik, social dhe territorial dhe solidaritetin mes Shteteve Anëtare.

Ai respekton diversitetin e pasur kulturor dhe gjuhësor dhe siguron mbrojtjen dhe rritjen e trashëgimisë kulturore të Europës.

4. Bashkimi krijon një bashkim ekonomik dhe monetar, monedha e të cilit është Euro.

5. Në marrëdhëniet me pjesën tjetër të botës, Bashkimi mban dhe nxit vlerat dhe interesat e veta dhe jep kontribut në mbrojtjen e qytetarëve të vet. Ai kontribuon në paqen, sigurimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Tokës, solidaritetin dhe respektin e ndërsjelltë midis popujve, tregtinë e lirë dhe të ndershme, zhdukjen e varfërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos të të drejtave të fëmijëve, si edhe zbatimin e rreptë dhe zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe respektimin e parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

[...]

Themelet e një Europe të bashkuar u hodhën mbi ide thelbësore dhe vlera të cilat Shtetet Anëtare i përqafojnë dhe i mishërojnë në realitet praktik përmes ndërveprimit të institucioneve të Komunitetit. Këto janë paqja e qëndrueshme, uniteti, barazia, liria, solidariteti dhe siguria. Qëllimet e shpallura haptazi të BE-së janë mbrojtja e parimeve të lirisë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës, që janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare, si edhe respektimi i lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut. Edhe shtetet që aspirojnë të bëhen pjesë e BE-së, duhet të synojnë arritjen e këtyre vlerave. Cilido Shtet Anëtar mund të ndëshkohet në rast shkeljesh të rënda dhe të përsëritura të këtyre vlerave dhe parimeve. Nëse Kryetarët e Shteteve ose Qeveritë - që veprojnë me propozimin e një të tretës së Shteteve Anëtare apo me propozim të Komisionit dhe me miratimin e Parlamentit European - deklarojnë se ka ndodhur një shkelje e rëndë dhe e përsëritur e vlerave dhe parimeve themelore të BE-së, atëherë Këshilli mund të vendosë me shumicë të cilësuar që t'i heqë Shtetit Anëtar në fjalë disa të drejta që burojnë nga zbatimi i Traktatit të BE-së dhe Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit European, përfshirë këtu dhe të drejtën e votës në Këshill. Nga ana tjetër, detyrimet mbi këtë Shtet Anëtar në bazë të Traktateve vazhdojnë të mbeten në fuqi. Në marrjen e këtyre masave ndëshkuese, Këshilli vlerëson me kujdes efektet që mund t'u shkaktohen të drejtave dhe detyrimeve të shtetasve apo ndërmarrjeve.

## BE-JA SI GARANTUESE E PAQES

Nuk ka motivim më të madh për unifikimin e Europës se sa dëshira për paqe. Gjatë shekullit të kaluar, dy luftërat vunë përballë shtete që sot janë Shtete Anëtare të Bashkimit European. Për këtë arsye, politika për Europën është sinonim i politikës për paqen. Me themelimin e BE-së, u hodhën bazat për krijimin e një kuadri european paqeje që e bën të pamundur çdo luftë të mundshme mes Shteteve Anëtare. Këtë e dëshmojnë më së miri mbi 50 vjet paqe në Europë. Sa më shumë shtete t'i bashkohen BE-së, aq më i fortë bëhet ky kuadër paqeje. Dy zgjerimet e fundit të BE-së që përfshinë 12 vende kryesisht të Europës Qendrore dhe Lindore, kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në këtë drejtim.

## UNITETI DHE BARAZIA SI MOTIVE KRYESORE

Kryefjala e BE-së është uniteti. Problemeve të sotme mund t'u bëhet ballë vetëm nëse vendet europiane ecin në rrugën që i çon ato drejt unitetit. Shumë gjykojnë se pa integrimin european, pa Bashkimin European, është e pamundur të garantohet në të ardhmen paqja (në Europë dhe në Botë), demokracia, shteti i së drejtës, mirëqenia ekonomike dhe sociale. Papunësia, rritja e pamjaftueshme ekonomike dhe ndotja e mjedisit prej kohësh nuk janë më probleme vetëm të një Shteti dhe as që nuk mund të zgjidhen në nivel kombëtar. Vetëm në kuadrin e BE-së mund të arrihet në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe vetëm nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të vendeve europiane, mund të arrihet në një politikë ekonomike ndërkombëtare që siguron karakterin konkurrues të ekonomisë europiane dhe që kontribuon në drejtësinë sociale. Pa kohezion të brendshëm, Europa nuk do të jetë në gjendje të ruajë pavarësinë e saj politike dhe ekonomike nga pjesa tjetër e botës, dhe as të rifitojë influencën në arenën ndërkombëtare apo të ketë rol në politikën botërore.

Uniteti mund të ekzistojë vetëm aty ku mbizotëron barazia . Asnjë qytetar i Bashkimit nuk mund të jetë objekt diskriminimi për shkak të kombësisë së tij/saj. Duhet të luftohet kundër çdo trajtimi diskriminues mbi baza gjinie, race, përkatësie etnike, fetare apo ideologjie, paaftësie fizike, moshe apo orientimi seksual. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European shkon akoma më tej, duke ndaluar çdo lloj diskriminimi mbi baza të tilla si ngjyra, tËparet gjenetike, gjuha, opinionin politik apo ndonjë opinion tjetër, përkatësia në një minoritet

kombëtar, prona apo prejardhja. Të gjithë qytetarët e Bashkimit janë të barabartë para ligjit. Bazuar në këtë parim, asnjë Shtet Anëtar nuk mund të ketë epërsi mbi cilindo Shtet tjetër dhe, sipas këtij parimi, shuhet rëndësia e dallimeve natyrore, si madhësia e territorit, numri i popullsisë apo strukturat e ndryshme.

## LIRITË THEMELORE

Liria është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e paqes, unitetit dhe barazisë. Krijimi i një hapësire më të madhe që bashkon tashmë 27 shtete, garanton një sërë lirish si ajo e lëvizjes së lirë përtej kufijve kombëtare, sidomos liria e lëvizjes së punëtorëve, liria e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime, si dhe lëvizja e lirë e mallrave dhe e kapitalit. Këto liri themelore u garantojnë sipërmarrësve lirinë në vendimmarrje, punëtorëve lirinë për ta zgjedhur vetë vendin e punës dhe konsumatorëve lirinë për të përzgjedhur ndërmjet një larmie më të madhe produktesh. Konkurrenca e lirë u mundëson bizneseve të ofrojnë mallra dhe shërbime në një hapësirë shumë më të madhe me klientë potencialë; punëtorët mund të kërkojnë punë në të gjithë territorin e BE-së dhe ta ndryshojnë atë sipas dëshirave dhe interesave vetjakë; konsumatorët mund të përzgjedhin produktet më të lira dhe më të mira, mes një game më të gjerë produktesh, pikërisht për shkak të rritjes së konkurrencës.

Megjithatë, për shtetasit e shteteve që u anëtarësuan më 1 maj 2004 dhe 1 janar 2007 vazhdojnë të jenë në fuqi disa rregulla kalimtare. Traktati i Anëtarësimit përmbante përjashtime, veçanërisht për lëvizjen e lirë të punëtorëve, lirinë për të ofruar shërbime dhe lirinë e vendosjes. Për pasojë, Shtetet Anëtare 'të vjetra' mund t'ua kufizojnë lirinë e lëvizjes punëtorëve që janë qytetarë të Shteteve Anëtare 'të reja' për një periudhë deri në shtatë vjet, duke e bërë të drejtën e punësimit objekt të legjislacionit të brendshëm apo të marrëveshjeve dypalëshe.

## PARIMI I SOLIDARITETIT

Solidariteti është korrigjuesi i nevojshëm i lirisë, pasi abuzimi me lirinë bie gjithmonë mbi kurriz të të tjerëve. Për këtë arsye, që rendi komunitar t'i rezistojë kohës, duhet ta njohë solidaritetin si parim thelbësor, si edhe t'i shpërndajë avantazhet (si mirëqenia), por edhe detyrimet, në mënyrë të barabartë dhe të ndershme mes të gjithë anëtarëve të vet.



1-3 qershor 1955, Taormina (Itali)

Joseph Bech, Paul-Henri Spaak dhe Johan Willem Beyen në kopshtin e hotelit ku qëndruan gjatë konferencës së Mesinës.

Këta tri ministra të Jashtëm, hartuan Memorandumin e Beneluksit, i cili u diskutua nga të Gjashtë gjatë konferencës.



## RESPEKTIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR

Bashkimi respekton identitetin kombëtar të Shteteve Anëtare. Ideja nuk është që BE të jetë një ‘shkrirje’ shtetesh, por një bashkim Shtetesh Anëtare që sjellin dhe ruajnë karakteristikat e tyre kombëtare. Është pikërisht kjo larmi karakteristikash dhe identitetesh kombëtare që i jep BE-së forcën morale, e cila vihet më pas në shërbim të të gjithë BE-së si një e tërë.

## NEVOJA PËR SIGURI

Të gjitha këto vlera themelore varen tek e fundit nga siguria. Sidomos që prej sulmeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA, lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar në Europë është rikthyer në qendër të vëmendjes. Bashkëpunimi policor e gjyqësor vazhdon të konsolidohet dhe mbrojtja e kufijve të jashtëm të BE-së vazhdon të forcohet.

Siguria në kontekstin europian nënkupton edhe sigurinë sociale të të gjithë qytetarëve që jetojnë në BE: sigurinë e vendit të punës, kushte të përgjithshme ekonomike të sigurta që mundësojnë veprimtari të sigurt biznesi. Në këtë aspekt, u takon institucioneve të BE-së që t’iu sigurojnë shtetasve dhe bizneseve stabilitetin e nevojshëm, në menyrë që këta të fundit të mund të marrin vendimet për të ardhmen.

## TË DREJTAT THEMELORE

Vlerat themelore të BE-së përfshijnë edhe vlerat themelore të qytetarëve si individë të Bashkimit. Historia e Europës është karakterizuar prej më se 200 vitesh nga përpjekjet e vazhdueshme për të forcuar mbrojtjen e të drejtave themelore. Duke nisur me deklaratat e të drejtave të njeriut dhe ato civile në shekullin e 18, të drejtat dhe liritë themelore janë mishëruar tashmë në kushtetutat e pjesës më të madhe të shteteve të civilizuara. Kjo vlen sidomos për Shtetet Anëtare të BE-së, sistemet ligjore të të cilave bazohen në mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe respektin për dinjitetin, lirinë dhe të drejtën e vetëzhvillimit të individit. Ekzistojnë mjaft konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mes të cilave rëndësi shumë të veçantë ka Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. U desh të pritej viti 1969 që

Gjykata e Drejtësisë të nxirrte një përmbledhje të praktikës së vet gjyqësore, e cila do të shërbente si një kuadër i përgjithshëm i të drejtave themelore.

Arsyeja e kësaj vonese ishte se, në fillimet e veta, Gjykata i kishte refuzuar të gjitha paditë që lidheshin me të drejtat themelore, me arsyetimin se çështjet e të drejtës kushtetuese kombëtare nuk ishin në kompetencë të saj. Më pas, Gjykatës iu desh ta rishqyronte qëndrimin e vet, kryesisht mbi bazën e parimit që ajo vetë e kishte sanksionuar: përparësisë të së drejtës së Bashkimit mbi legjislationin e brendshëm. Ky parim mund të respektohet vetëm nëse mbrojtja e të drejtave themelore që garanton e drejta e Bashkimit është e barabartë me mbrojtjen që garantojnë kushtetutat kombëtare.

Zanafilla e kësaj praktike gjyqësore ishte çështja Stauder, në të cilën përfituesi i një pensioni si veteran i luftës, e konsideronte cënim të dinjitetit personal dhe shkelje të parimit të barazisë, faktin që duhej të deklaronte emrin për të blerë gjalpë me çmim të ulët gjatë periudhës së Krishtlindjeve. Edhe pse Gjykata e Drejtësisë, në interpretim të dispozitës së Komunitetit, arriti në përfundimin që deklarimi i emrit nuk ishte i nevojshëm dhe që ishte e tepërt të merrej me shqyrtimin e pretendimit për shkelje të të drejtave themelore, në konkluzionet e saj konstatonte se respektimi i të drejtave themelore bën pjesë në parimet e përgjithshme themelore të rendit juridik të Komunitetit, rend të cilin Gjykata e ka për detyrë ta garantojë. Kështu, Gjykata njohu për herë të parë ekzistencën e një kuadri juridik të BE-së edhe për të drejtat themelore.

Gjykata fillimisht vendosi masat mbrojtëse për çdo të drejtë themelore, nisur nga një sërë dispozitash të Traktateve. Ajo përcaktoi shumë “ndalime diskriminimi” që buronin nga aspekte të ndryshme të parimit të përgjithshëm të barazisë. Mes tyre janë ndalimi i trajtimit diskriminues mbi bazën e kombësisë (Neni 18 i TFBE), ndalimi i trajtimit të pabarabartë mbi baza gjinie, race, përkatësie etnike, fetare apo besimi, paaftësie fizike, moshe apo orientimi seksual (Neni 10 i TFBE), trajtimi i barabartë për mallrat dhe personat në lidhje me katër liritë themelore (liria e lëvizjes së mallrave — Neni 34 i TFBE; liria e lëvizjes së personave — Neni 45 i TFBE; e drejta e vendosjes — Neni 49 i TFBE; dhe liria për të ofruar shërbime — Neni 57 i TFBE), konkurrenca e lirë (Neni 101 etj. i TFBE) dhe pagë e barabartë për meshkujt dhe femrat (Neni 157 i TFBE). Katër liritë themelore të Komunitetit, të cilat garantojnë liritë bazë të jetës profesionale, mund të konsiderohen edhe si një

e drejtë themelore Komunitare për lëvizjen e lirë dhe ushtrimin e lirë të një veprimtarie profesionale. Gjithashtu, garantohet qartë e drejta e formimit të organizatave (Neni 153 i TFBE), e drejta e ankimit (Neni 24 i TFBE) dhe mbrojtja e sekretit tregtar dhe atij profesional (Neni 339 i TFBE).

Gjykata e Drejtësisë i ka zhvilluar e plotësuar vazhdimisht këto baza për një mbrojtje juridike Komunitare të të drejtave themelore, duke njohur dhe zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës dhe duke u frymëzuar nga konceptet e përbashkëta të kushtetutave të Shteteve Anëtare dhe të konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, konventa në të cilat Shtetet Anëtare. Më e spikatura ndër to është Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ndihmoi në përcaktimin e thelbit të të drejtave themelore në Bashkim dhe të mekanizmave për mbrojtjen e tyre. Mbi këtë bazë, Gjykata ka ngritur në rangun e të drejtave themelore edhe një sërë lirish, si: e drejta e pronës, liria e ushtrimit të veprimtarisë profesionale, paprekshmëria e banesës, liria e mendimit, të drejtat e përgjithshme të personalitetit, mbrojtja e familjes (për shembull e drejta e pjesëtarëve të familjarëve për t'u bashkuar me një punëtor emigrant), liria ekonomike, liria e fesë ose besimit, si edhe një sërë të drejtash themelore procedurale ,f.v., e drejta për një proces të rregullt ligjor, parimi i komunikimit konfidencial ndërmjet avokatit dhe klientit (të njohura si 'komunikime të privileguara' në vendet e sistemit Common Law), mosdënimi dy herë për të njëjtën shkelje, apo detyrimi për të dhënë informacion mbi aktet ligjore të BE-së.

Një parim veçanërisht i rëndësishëm dhe i evokuar shpesh në procedime gjyqësore është parimi i trajtimit të barabartë. Në kuptimin e përgjithshëm, kjo do të thotë që rastet e ngjashme duhet të trajtohen në mënyrë të ngjashme, përveçse kur ka arsye objektive për të bërë dallim në gjykim. Por Gjykata e Drejtësisë, në ndryshim nga praktika e deritanishme ndërkombëtare, është shprehur që ky parim nuk ndalon zbatimin e masave më të rrepta për shtetasit apo mallrat e prodhuara në vend nga ato që zbatohen për shtetasit ose produktet nga Shtete të tjera Anëtare. Ky 'diskriminim në sens të kundërt' është rezultati i pashmangshëm i sferës së kufizuar të kompetencave të Bashkimit dhe nuk mund të zgjidhet nga e drejta Komunitare. Sipas vendimeve që Gjykata ka marrë deri tani, rregullat që kërkojnë liberalizim dhe që burojnë prej lirive themelore, gjejnë zbatim vetëm për tregtinë ndërkufitare. Rregullat në lidhje me prodhimin dhe tregtimin e produkteve kombëtare apo me statusin

juridik të shtetasve të vendit në fjalë në territorin e Shteteve të tjera Anëtare, konsiderohen brenda fushës së veprimit të të drejtës Komunitare vetëm nëse ekziston një harmonizim normativash në nivel të Bashkimit Europian.

Falë praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë, Bashkimi disponon një bazë të konsiderueshme me parime të shtetit të së drejtës që lidhen me të drejtat themelore. Rëndësi shumë të madhe praktike në këtë drejtim merr parimi i proporcionalitetit. Kjo do të thotë që qëllimi i synuar dhe mjetet e përdorura, duhet të peshohen dhe të jenë në ekuilibrin e duhur, në mënyrë që shtetasi të mos mbajë barrë të tepërt. Mes parimeve të tjera thelbësore që lidhen me të drejtën e Bashkimit janë dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative dhe koncepti i procesit të rregullt ligjor: pritshmëritë e ligjshme duhet të mbrohen, dispozitat prapavepruese që vendosin detyrime apo që prapësojnë të drejta të fituara në mënyrë të ligjshme ndalohen, dhe e drejta për proces të rregullt ligjor- drejtësi natyrale është termi tradicional për këtë- duhet të sigurohet si në procedimet administrative të Komisionit ashtu edhe në procedimet gjyqësore përpara Gjykatës së Drejtësisë. Rëndësi e madhe i kushtohet edhe nevojës për transparencë më të lartë, që do të thotë se vendimet duhet të merren në mënyrë sa më publike dhe sa më pranë qytetarit europian. Një aspekt kyç i kësaj transparence është se shtetasi i BE-së apo personi juridik i regjistruar në një Shtet Anëtar, mund të ketë akses në dokumentet e Këshillit apo të Komisionit. Të gjitha grantet dhe subvencionet nga buxheti i BE-së duhet të jenë të hapura për personat fizikë dhe juridikë, përmes bazës së të dhënave që duhet të jetë i aksesueshëm për çdo qytetar të Bashkimit.

Duke vlerësuar punën e Gjykatës së Drejtësisë në përkufizimin e të drejtave themelore të pashkruara, u konstatua që përcaktimi i “të drejtave themelore europiane” paraqiste një pengesë të madhe: Gjykata duhet të kufizohet në çështjet specifike. Në këto kushte, Gjykata nuk ishte në gjendje që të zhvillonte të drejta themelore prej parimeve të përgjithshme të së drejtës, për të gjitha fushat ku kjo gjë rezulton e nevojshme ose e dëshirueshme. Gjykata, madje, nuk mundi as të përcaktonte fushën e veprimit dhe kufizimet e mbrojtjes së të drejtave themelore, ashtu siç ishte e nevojshme të bëhej qoftë në përgjithësi, ashtu edhe në veçanti. Kjo situatë nuk i lejon institucionet e BE-së të vlerësojnë me saktësi të mjaftueshme rrezikun e shkeljes prej tyre të një te drejte themelore. Nga ana tjetër, as shtetasi i interesuar i Bashkimit nuk është në gjendje të gjykojë në çdo rast nëse i është shkelur ndonjë nga të drejtat themelore.

Për një kohë të gjatë, aderimi i BE-së në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut konsiderohej si mënyra më e mirë për të dalë nga kjo situatë. Megjithatë, Gjykata në Opinionin e saj 2/94 u shpreh se ashtu siç ishte e drejta Komunitare, BE-ja nuk kishte kompetenca për të aderuar në këtë Konventë. Gjykata u shpreh se edhe pse mbrojtja e të drejtave të njeriut ishte një premisë e ligjshmërisë së akteve të BE-së, aderimi në KEDrNJ do të kërkonte ndryshim rrënjësor të sistemit aktual të Bashkimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pasi do të sillte futjen e BE-së në një sistem institucional të veçantë ndërkombëtar, si edhe do të bënte të mundur transpozimin e të gjitha dispozitave të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut në rendin juridik të Bashkimit. Gjykata konsideroi që një ndryshim i tillë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në BE, me implikimet institucionale që sillte si për Bashkimin ashtu edhe për Shtetet Anëtare, do të mbartte një peshë kushtetuese që për natyrën e vet, do të shkonte përtej kompetencave të dhëna nga neni 352 i TBE-së. Për pasojë, aderimi i BE-së në Konventë u parashikua posaçërisht në Nenin 6(2) të Traktatit të Bashkimit Europian. Megjithatë, Traktati i Lisbonës hodhi një tjetër hap vendimtar drejt krijimit të një kuadri të përbashket kushtetues për BE-në dhe e vendosi mbrojtjen e të drejtave themelore në BE, në një tjetër nivel. Neni i ri për të drejtat themelore në Traktatin e BE-së (Neni 6 TBE) i referohet Kartës së Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore, duke deklaruar se ajo është detyruese për institucionet e BE-së dhe Shtetet Anëtare, për sa kohë që ato ndjekin dhe vënë në zbatim të drejtën e Bashkimit.

Kjo Kartë e të Drejtave Themelore është e bazuar në një projekt që ishte hartuar fillimisht nga një grup i veçante me 16 përfaqësues të Krerëve të Shteteve ose Qeverive të Shteteve Anëtare dhe Presidentit të Komisionit Europian, 16 deputetë të Parlamentit Europian dhe 30 anëtarë të parlamenteve kombëtare (dy për çdo Shtet Anëtar të asaj kohe) nën drejtimin e Profesor Roman Herzog. Kjo Kartë u shpall solemnisht më 7 Dhjetor 2000 nga Kryetari i Parlamentit Europian, Presidenti i Këshillit dhe Presidenti i Komisionit Europian si 'Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian'. Gjatë negociatave për një Kushtetutë Europiane, kjo Kartë e të Drejtave Themelore u rishikua dhe u bë pjesë e pandarë e Traktatit themelues të Kushtetutës Europiane më 29 tetor 2004. Pasi ky Traktat dështoi, Karta e të Drejtave Themelore u shpall edhe njëherë solemnisht më 12 Dhjetor 2007 në Strasburg nga Presidentët e

Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit Europian, si një instrument i vecante me titull 'Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian'. Traktati i BE-së i referohet këtij versioni të Kartës. Kjo e bën Kartën e të Drejtave Themelore ligjërish të detyrueshme, si edhe vendos zbatueshmërinë e të drejtave themelore në të drejtën e Bashkimit. E megjithatë, kjo nuk gjen zbatim për Poloninë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Këto dy Shtete Anëtare nuk ishin në gjendje, apo nuk donin, që të miratonin sistemin e të drejtave themelore të Kartës, pasi në këtë rast do të ishin të detyruar që të hiqnin dorë ose të paktën të ndryshonin disa qëndrime kombëtare, për shembull për çështje fetare apo trajtimin e pakicave. Prandaj keto dy vende nuk janë të lidhura me të drejtat themelore të percaktuara ne Kartë, por ashtu si edhe më parë, vetëm me jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë.

## ‘KUSHTETUTA’ E BASHKIMIT EUROPIAN

Çdo organizim social ka kushtetutë. Kushtetuta është mjeti me anë të të cilit përkufizohet struktura e sistemit politik, pra, specifkohet marrëdhënia e pjesëve të ndryshme si me njëra tjetrën ashtu dhe me të tërën, përcaktohen objektivat e përbashkët dhe parashtrohen rregullat për marrjen e vendimeve me fuqi detyruese. Pra, kushtetuta e BE-së, si një bashkim shtetesh të cilave u janë caktuar detyra dhe funksione të qarta, duhet të jetë në gjendje t’u përgjigjet problemeve ashtu si edhe kushtetuta e çdo shteti të veçantë.

Politika e përbashkët e Shteteve Anëtare rregullohet përmes dy parimeve thelbësore: shteti i së drejtës dhe demokracia. Të gjitha veprimtaritë e Bashkimit, për të qenë konform kërkesave themelore të shtetit të së drejtës dhe demokracisë, duhet që të jenë legjitime nga ana juridike dhe demokratike: elementet mbi të cilat bazohet, struktura, kompetencat, mënyra se si vepron, pozicioni i Shteteve Anëtare dhe i institucioneve të tyre, si edhe pozicioni i shtetasve.

Pas dështimit të Traktatit Themelues të Kushtetutës Europiane të 29 tetorit 2004, ‘Kushtetuta’ e BE-së ende nuk është e shkruar në një dokument gjithëpërfshirës kushtetues, ashtu siç janë pjesa më e madhe e kushtetutave të Shteteve Anëtare, por rrjedh prej tërësisë së rregullave dhe vlerave themelore, të cilat perceptohen si të detyrueshme për vetë autoritetet shtetërore. Këto rregulla gjenden pjesërisht në Traktatet Europiane apo në instrumentet ligjore të miratuara nga institucionet e Bashkimit, por gjithashtu, gjenden pjesërisht edhe tek tradita.

### **NATYRA JURIDIKE E BE-së**

Përcaktimi i natyrës juridike të BE-së duhet të nisë duke vlerësuar me kujdes

tiparet e saj karakteristike. Megjithëse natyra juridike e BE-së bazohet në dy vendime që shënuan precedentë të Gjykatës së Drejtësisë të vitit 1963 dhe 1964, në lidhje me Komunitetin Ekonomik Europian të asaj kohe. Këto vendime janë edhe sot të vlefshme për Bashkimin Europian, në formën që ai ka marrë aktualisht.

### ***VAN GEND & LOOS***

Në këtë mosmarrëveshje juridike, kompania holandeze e transportit Van Gend & Loos, ngriti padi kundër autoriteteve doganore holandeze për vendosjen e një detyrimi doganor për një produkt kimik të importuar nga Gjermania, i cili ishte më i lartë se sa detyrimet doganore për importet e mëparshme. Për kompaninë, kjo ishte shkelle e Nenit 12 të Traktatit KEE, i cili e ndalon vendosjen e detyrimeve të reja doganore apo rritjen e detyrimeve ekzistuese doganore ndërmjet Shteteve Anëtare. Gjykata në Holandë, e pezulloi gjykimin dhe ia kaloi çështjen për sqarim Gjykatës së Drejtësisë, për sa i takon fushës së veprimit dhe implikimeve ligjore të nenit të sipërpërmendur të Traktatit themelues të KE-së.

Gjykata e Drejtësisë e përdori këtë mundësi për të parashtruar një sërë konstatimesh me një vlerë thelbësore lidhur me natyrën juridike të BE-së. Në vendimin e saj, Gjykata u shpreh ndër tv tjera:

‘Qëllimi i Traktatit KEE që është krijimi i një tregu të përbashkët, funksionimi i të cilit është në interesin e drejtpërdrejtë të palëve në Komunitet, nënkupton që ky Traktat është më tepër se sa një marrëveshje që krijon thjesht detyrime të ndërsjella ndërmjet shteteve që janë palë. Ky këndvështrim, konfirmohet edhe në preambulën e Traktatit, e cila i referohet jo vetëm qeverive, por edhe popujve. Ai konfirmohet më hollësisht me krijimin e institucioneve, të cilat vishen me të drejta sovraane, ushtrimi i të cilave ndikon jo vetëm tek Shtetet Anëtare, por edhe te shtetasit e tyre...Pra, arrihet në konkluzionin se Komuniteti përfaqëson një rend të ri juridik të së drejtës ndërkombëtare, në favor të të cilit Shtetet i kanë kufizuar, edhe pse në sektorë të veçantë, të drejtat e tyre sovraane, një rend juridik që njeh si subjekte jo vetëm Shtetet Anëtare, por edhe shtetasit e tyre.



***COSTA v ENEL***

Vetëm një vit më pas, çështja *Costa v ENEL* i dha Gjykatës së Drejtësisë mundësinë që ta shtjellonte më hollësisht pozicionin e saj. Faktet e çështjes ishin si vijon: Në vitin 1962, Italia shtetëzoi prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike dhe i transferoi asetet e ndërmarrjeve elektrike te Bordi Kombëtar i Energjisë, ENEL. Z. Kosta, si aksioner i Edison Volt, një prej ndërmarrjeve që u shtetëzua, pretendonte se ishte privuar nga dividenti i tij dhe, për pasojë, kishte refuzuar të paguante një faturë të energjisë elektrike prej IIL 1926. Gjatë procesit në gjykatën e arbitrazhit të Milanos, një prej argumenteve të paraqitura nga Z. Kosta në mbështetje të veprimit së tij, ishte se ligji për shtetëzimin shkelte një sërë dispozitash të Traktatit KEE. Për të vlerësuar parashtrimin që Z.Kosta bëri për mbrojtjen e vet, gjykata i kërkoi Gjykatës së Drejtësisë që të interpretonte disa dispozita të veçanta të Traktatit KEE. Për sa i takon natyrës juridike të KEE, në vendimin që mori, Gjykata e Drejtësisë u shpreh si më poshtë:

‘Ndryshe nga traktatet e zakonshme ndërkombëtare, Traktati KEE ka krijuar një sistem të veçantë juridik, i cili është bërë pjesë e pandarë e sistemeve juridike të Shteteve Anëtare dhe që është i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat e këtyre shteteve. Në fakt, duke krijuar një Komunitet me kohëzgjatje të pacaktuar, i cili ka institucionet e veta, personalitetin e vet, zotësinë e vet juridike dhe aftësinë e përfaqësimit në planin ndërkombëtar, por sidomos kompetenca të vërteta që burojnë nga kufizimi i sovranitetit apo kalimi i kompetencave nga Shtetet Anëtare tek Komuniteti, Shtetet Anëtare i kanë kufizuar të drejtat e tyre sovrane... dhe, për pasojë, kanë miratuar një tërësi ligjesh që janë të detyrueshme si për Shtetet Anëtare ashtu edhe për shtetasit e tyre.’

Bazuar në konstatimet e saj të hollësishme, Gjykata arriti në përfundimin e mëposhtëm:

‘Prej tërësisë së elementeve të përmendura, rezulton se e drejta që buron prej Traktatit, si një burim i pavarur i së drejtës, nuk mundet, për shkak të natyrës së saj të veçantë dhe origjinale, t’u nënshtrohet dispozitave kombëtare ligjore, sido që të jenë formuluar ato, pa u zhveshur nga natyra e saj si e drejtë komunitare dhe pa u vënë në pikëpyetje vetë baza ligjore e Komunitetit. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve që burojnë prej Traktatit, që Shtetet

e kanë bërë nga sistemi i tyre i brendshëm juridik në sistemin juridik të Komunitetit, mbart me vete një kufizim të përhershëm të të drejtave sovrane të këtyre shteteve, kundër të cilave një akt i njëanshëm pasues që nuk është në përputhje me konceptin e Komunitetit, nuk mund të ketë përparësi.

Nën dritën e këtyre vendimeve, elementet që së bashku karakterizojnë natyrën e veçantë juridike të BE-së, janë:

- struktura institucionale, e cila garanton që veprimi i BE-së karakterizohet nga interesat e përgjithshëm europianë, pra, reflektohet tek interesat e përgjithshëm të Bashkimit apo ndikohet prej tyre, ashtu siç është parashtruar tek objektivat;
- kalimi i kompetencave tek institucionet e Bashkimit në një masë më të madhe se sa tek organizmat e tjerë ndërkombëtarë dhe shtetërorë e tyre tek ato fusha tek të cilat Shtetet normalisht ruajnë të drejtat e tyre sovrane;
- krijimi i një rendi juridik, i cili është i pavarur nga rendet juridike të Shteteve Anëtare;
- zbatimi i drejtpërdrejtë i së drejtës komunitare, që garanton zbatimin në mënyrë të plotë dhe uniforme në të gjitha Shtetet Anëtare të dispozitave komunitare, të cilat parashikojnë të drejta dhe vendosin detyrime si për Shtetet Anëtare ashtu edhe për shtetasit e tyre.
- epërsia e së drejtës së Bashkimit, e cila garanton se e drejta komunitare nuk mund të revokohet apo të ndryshohet prej të drejtës së brendshme dhe se në rast konflikti, ajo ka epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm.

Për rrjedhojë, BE-ja është një entitet autonom me të drejta e veta sovrane dhe një rend juridik të pavarur nga Shtetet Anëtare, subjekt i të cilit janë si Shtetet Anëtare ashtu edhe shtetasit e tyre, për sa u takon fushave të kompetencës së BE-së.

Vetë natyra e BE-së mbart disa tipare të përbashkëta me organizmat e zakonshme ndërkombëtare apo strukturat e llojit federal, por edhe një sërë dallimesh.

BE-ja në vetvete nuk është ende një ‘produkt përfundimtar’; ajo është në proces evolucionar dhe forma që ajo do të marrë përfundimisht, aktualisht nuk mund të parashikohet.

I vetmi tipar që BE-ja ka të përbashkët me organizmat tradicionalë ndërkombëtarë, është se edhe ajo erdhi në jetë si pasojë e një traktati ndërkombëtar. Por sidoqoftë, BE-ja ka bërë shumë përpara që prej kësaj fillese. Kjo, për arsyen se edhe pse Traktatet themeluese të BE-së ishin të bazuara në traktate ndërkombëtare, ato çuan në krijimin e një Bashkimi të pavarur, me të drejtat sovrane dhe përgjegjësitë e veta. Shtetet Anëtare kanë hequr dorë prej disa prej kompetencave të tyre sovrane në favor të Bashkimit. Veç kësaj, detyrat që i janë caktuar BE-së janë shumë të ndryshme nga ato të organizmave të tjerë ndërkombëtarë. Ndërsa këto të fundit kanë detyra të mirëpërcaktuara të një natyre teknike, BE-ja ka fusha përgjegjësie, që së bashku përbëjnë tiparet themelore të një shteti.

Nëpërmjet këtyre dallimeve mes BE-së dhe organizatave tipikë ndërkombëtarë, BE-ja është duke përfutur një status që është i ngjashëm me atë të një shteti të veçantë. Kalimi i pjesshëm i të drejtave të sovranitetit nga ana e Shteteve Anëtare, u mor veçanërisht si një shenjë që BE-ja ishte strukturuar tashmë në radhët e një shteti federal. Por, ky këndvështrim, nuk merr parasysh që institucionet e BE-së, për të zbatuar qëllimet e specifikuar në Traktate, kanë kompetenca vetëm në disa fusha të caktuara. Kjo nënkupton se ato nuk janë të lira as që t'i përzgjedhin objektivat e veta në të njëjtën mënyrë si një shtet sovran dhe as në pozitë që të përballen me sfidat, me të cilat hasen shtetet e sotme moderne. BE-ja nuk ka juridiksion gjithëpërfshirës si ai i shteteve sovrane dhe as kompetencën për të vendosur fusha të reja përgjegjësie ('juridiksion mbi juridiksionin').

Për pasojë, BE-ja nuk është as një organizatë ndërkombëtare në kuptimin e përgjithshëm dhe as një bashkim shtetesh, por një entitet autonom diku ndërmjet këtyre të dyjave. Në qarqet juridike, tani po përdoret termi 'organizatë supranacionale'.

### **DETYRAT E BE-së**

Lista e detyrave që i janë besuar BE-së përngjet me rendin kushtetues të një shteti. Nuk bëhet fjalë për detyra teknike të përcaktuara ngushtësisht, ashtu siç

supozohet shpesh nga organizatat ndërkombëtarë, por për fusha kompetence që nëse merren së bashku, formojnë tiparet thelbësore të një shteti.

Lista e detyrave që i besohen BE-së përfshin një gamë të gjerë dhe mbulon veprimin ekonomik, social dhe politik.

Detyrat ekonomike kanë në qendër krijimin e një tregu të përbashkët, i cili shkrin tregjet e brendshme të Shteteve Anëtare, e në të cilin të gjitha mallrat dhe shërbimet mund të ofrohen dhe të shiten me të njëjtat kushte ashtu si në tregun e brendshëm, duke bërë që të gjithë shtetasit e Bashkimit të kenë tek ky treg të njëjtin akses të lirë.

Plani për krijimin e një tregu të përbashkët është përmbushur para së gjithash me anë të programit që synonte krijimin e tregut të brendshëm deri në vitin 1992, nismëtar i të cilit ishte asokohe Presidenti i Komisionit Jacques Delors dhe që u miratua më pas nga Krerët e Shteteve ose Qeverive. Institucionet arritën me sukses që të krijojnë një kuadër ligjor për funksionimin e rregullt të tregut unik. Tashmë, ky kuadër është shtjelluar në mënyrë shumë të detajuar nga masat e transpozimit të brendshëm dhe, për pasojë, tregu unik është bërë realitet. Ky treg unik ndihet edhe në jetën e përditshme, sidomos kur udhëton brenda BE-së, ku kontrolli në kufijtë kombëtarë është hequr prej kohësh.

Tregu i brendshëm mbështetet prej bashkimit ekonomik dhe monetar.

Por megjithatë, detyra e BE-së në lidhje me politikën ekonomike nuk është që të hartojë dhe të verë në funksionim një politikë ekonomike europiane, por që të bashkërendojë politikat ekonomike kombëtare, në mënyrë që vendimet mbi këto politika të një apo më shumë Shteteve Anëtare të mos kenë pasojë negative për funksionimin e tregut të brendshëm. Me qëllim që Shteteve Anëtare t'u jepeshin kritere të hollësishme, të cilat duhej të plotësoheshin nga vendimet e tyre mbi politikat buxhetore, u miratua Pakti i Stabilitetit dhe i Rritjes Ekonomike. Nëse Shtetet Anëtare nuk veprojnë në përputhje me të, Komisioni European mund të bëjë paralajmërime dhe, në rast se deficitit buxhetor vazhdon mbi nivelin e lejuar, Këshilli mund të vendosë edhe penalitete.

Lidhur me politikën monetare, detyra e BE-së ishte futja e një monedhe të vetme të BE-së dhe kontrolli në mënyrë të centralizuar i çështjeve monetare. Në këtë fushë, tashmë është arritur njëfarë

suksesi. Në 1 Janar 1999, euroja u fut si monedha e vetme europiane në ato Shtete Anëtare që e kishin përmbushur tashmë kriterin e konvergencës, i vendosur për këtë qëllim. Këto vende ishin Belgjika, Gjermania, Irlanda, Spanja, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda, Austria, Portugalia dhe Finlanda. Në 1 janar 2002, monedhat kombëtare të këtyre shteteve u zëvendësuan me Euro. Që prej asaj kohe, pagesat e përditshme dhe transaksionet financiare bëhen vetëm me një monedhë – pra me Euro. Fillimisht, Greqia dhe Suedia nuk e përmbushën kriterin e konvergencës. Greqia e realizoi këtë objektiv në 1 janar 2001. Suedia, e cila nuk mund ta përmbushte kriterin kryesisht për shkak se nuk ishte pjesë e mekanizmit të kursit të këmbimit të Sistemit Europian Monetar ('salla e pritjes' për Euron), është subjekt i një përjashtimi sipas të cilit Komisioni dhe Banka Qendrore Europiane duhet të paraqesin raporte konvergjence për Suedinë të paktën çdo dy vjet, në të cilat ato mund të rekomandojnë pjesëmarrjen e Suedisë në Këshill. Nëse një rekomandim i tillë formulohet dhe miratohet nga Këshilli, Suedia nuk mund ta refuzojë pjesëmarrjen. Sidoqoftë, tashmë populli suedez e mbështet shumë pak pjesëmarrjen e Suedisë në eurozonë. Në një referendum në vitin 2003, 55.9% ishin kundër futjes së euros. Në një sondazh në dhjetor 2005, 49% ishin kundër përdorimit të euros, ndërsa 36% ishin pro saj. Në Danimarkë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, situata është e ndryshme. Këto Shtete Anëtare përfituan nga klauzola e mospjesëmarrjes, e cila i lejon që ata vetë të vendosin nëse dhe kur do të nisin procedurën për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret për t'u bashkuar me monedhën europiane. Ndërkaq Shtetet e reja Anëtare janë të detyruara që ta miratojnë euron si monedhën e tyre kombëtare sapo të përmbushin kriteret e konvergencës. Për asnjë nga Shtetet e reja Anëtare nuk parashikohet klauzola e mospërfshirjes në sistemin e Euro-s. Përkundrazi, shumica e tyre dëshirojnë ta fusin Euron sa më shpejt të jetë e mundur. Tashmë, këtë e kanë arritur Sllovenia (1 janar 2007), Qiproja (1 janar 2008), Malta (1 janar 2008) dhe Sllovakia (1 janar 2009), duke e zgjeruar 'Eurozonën' - vendet që kanë Euron si monedhë të tyre - në një numër prej 16 Shtetesh Anëtare.



6 dhjetor 1977, Bruksel.

Demonstratë pro zgjedhjeve të përgjithshme për Parlamentin Europian dhe monedhën e vetme, gjatë takimit të Këshillit Europian më 5 dhe 6 dhjetor 1977.

Përveç fushës së politikave ekonomike dhe monetare, ka shumë fusha të tjera të politikave ekonomike, për të cilat BE-ja ka përgjegjësi. Këto përfshijnë veçanërisht politikën për bujqësinë dhe peshkimin, politikën për transportin, politikën për konsumatorin, politikën strukturore dhe të kohezionit, politikën për kërkim dhe zhvillim, politikën për hapësirën, politikën për mjedisin, politikën për shëndetësinë, politikën për tregtinë dhe politikën për energjinë.

Për sa i takon politikës sociale, BE-ja ka detyrë të garantojë që përfitimet e integritimit ekonomik nuk shkojnë vetëm tek ata që janë aktivë në ekonomi, por që ato i japin njëkohësisht formë dimensionit social të tregut unik. Një prej hapave të parë në këtë drejtim, ka qenë futja e një sistemi sigurimesh shoqërore për punëtorët emigrantë. Sipas këtij sistemi, ata punëtorë që kanë punuar në më shumë se një Shtet Anëtar dhe, për pasojë kanë qenë pjesë e skemave të ndryshme të sigurimeve, nuk do të kenë disavantazhe për sa u takon sigurimeve shoqërore (pensioni i pleqërise, pensioni i invaliditetit, kujdesi shëndetësor, përfitime familjare, asistencë papunësie). Një tjetër detyrë parësore e politikës sociale, duke marrë parasysh situatën e papunësisë në BE, që ka qenë një burim shqetësimi për vite me radhë, është nevoja për të hartuar një strategji Europiane punësimi. Nevojitet që Shtetet Anëtare dhe BE-ja të hartojnë një strategji për punësim e të promovojnë veçanërisht një forcë pune të aftë, të trajnuar dhe me aftësi për tu përshtatur; veç kësaj, tregjet e punës duhet të bëhen gjithashtu të përshtatshme me lehtësi ndaj ndryshimit ekonomik. Promovimi i punësimit konsiderohet si një shqetësim i përbashkët dhe kërkon që Shtetet Anëtare t'i bashkërendojnë masat e tyre kombëtare brenda Këshillit. BE-ja do të kontribuojë për një nivel të lartë punësimi, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, do të plotësojë përpjekjet e tyre duke respektuar kompetencat që ato kanë.

Në lidhje me fushat prioritare të politikës, aktualisht i mbetet të angazhohet veçanërisht në çështjet e shtetësisë të Bashkimit, politikat për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, si edhe në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit. Shtetësia e Bashkimit i ka forcuar akoma më tej të drejtat dhe interesat e popujve të Shteteve Anëtare brenda BE-së. Shtetasit kanë të drejtën të lëvizin lirisht brenda Bashkimit (neni 21 TFBE), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet vendore (neni 22 TFBE), të drejtën për t'u mbrojtur nga autoritetet diplomatike dhe konsullore të secilit Shtet Anëtar (neni 23 TFBE), të drejtën për t'i bërë peticion Parlamentit Europian (neni

24 TFBE) dhe, në kontekstin e ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit, të drejtën që të trajtohen në secilin prej Shteteve Anëtare, sikur të ishin shtetas të atij shteti (neni 20(2) së bashku me nenin 18 TFBE). Lidhur me politikën e përbashkët për punët e jashtme dhe sigurise, BE-ja ka kryesisht detyrat e mëposhtme:

- mbrojtjen e vlerave të përbashkëta, interesave themelore dhe pavarësinë e BE-së;
- forcimin e sigurisë së BE-së dhe Shteteve të saj Anëtare;
- sigurimin e paqes në botë dhe rritjen e sigurisë ndërkombëtare;
- nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- promovimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtes, si edhe garantimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
- vendosjen e një mbrojtjeje të përbashkët

Meqenëse BE-ja nuk është një shtet individual, këto detyra nuk mund të përmbushen hap pas hapi. Tradicionalisht, politika e punëve të jashtme dhe sidomos ajo e sigurimit, janë fusha në të cilat Shtetet Anëtare janë veçanërisht të interesuara që të ruajnë sovranitetin e tyre (kombëtar). Një tjetër arsye përse është e vështirë të përcaktohen interesat e përbashkët në këtë fushë, është se vetëm Franca dhe Britania e Madhe kanë armë bërthamore. Një tjetër problem është se disa prej Shteteve Anëtare, nuk bëjnë pjesë në NATO apo në BEP. Për pasojë, pjesa më e madhe e vendimeve ‘për politikën e përbashkët për punët e jashtme dhe sigurimit’, aktualisht ende merren mbi bazën e bashkëpunimit ndërmjet shteteve. Sakaq, një sërë instrumentesh janë zhvilluar duke i dhënë bashkëpunimit ndërmjet shteteve në këtë fushë një kuadër të fortë ligjor.

Në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet penale, roli kryesor i BE-së është që të përmbushë detyrat që janë në interes të Europës si një e tërë. Këto përfshijnë, sidomos, luftën kundër krimit të organizuar, parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe ndjekjen penale. Duke qenë se krimi i organizuar nuk mund të luftohet më në mënyrë të efektshme vetëm në nivel shtetëror, nevojitet një përgjigje e përbashkët dhe në nivel të BE-se. Tashmë janë hedhur dy hapa shumë pozitivë me direktivën për pastrimin e parave dhe me krijimin e një autoriteti policor evropian, Europoli, i cili



ka nisur nga puna që prej vitit 1998 (Neni 88 i TFBE). Ky bashkëpunim ka të bëjë gjithashtu edhe me lehtësimin dhe përsheptimin e bashkëpunimit për sa i takon gjykimin penal si edhe zbatimin të vendimeve, lehtësimin të ekstradimit ndërmjet Shteteve Anëtare, përcaktimit të rregullave minimale që kanë të bëjnë me elementet përbërëse të veprave kriminale dhe ndëshkimet në fushën e krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit seksual të femrave dhe fëmijëve, trafikimit të paligjshëm të drogës, trafikimit të paligjshëm të armëve, pastrimit të parave dhe korrupsionit (Neni 83 TFBE). Një prej hapave më të rëndësishëm të hedhur nga BE-ja për sa i takon bashkëpunimit gjyqësor, ishte edhe krijimi i Eurojust në prillin e vitit 2003 (Neni 85 TFBE). Eurojust, me seli në Hagë, është një ekip gjyqtarësh dhe prokurorësh nga të gjitha vendet e BE-së. Puna e Eurojust-it është që të ndihmojë në koordinimin e hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të rënda ndërkuftare. Prej Eurojust-it, Këshilli mund të ngrejë Prokurorinë Publike Europiane, në mënyrë që të luftojë krimet që bien ndesh me interesat financiarë të Bashkimit (Neni 86 TFBE). Progres është shënuar gjithashtu edhe për sa i përket Urdhrit të Arrestit European, i cili, që prej janarit 2004, është i vlefshëm në të gjithë BE-në. Urdhri lëshohet për këdo që akuzohet për një shkelje, masa minimale e dënimit për të cilën është më shumë se një vit burg. Urdhri i Arrestit European është krijuar për të zëvendësuar procedurat e stërzgjatura të ekstradimit.

## KOMPETENCAT E BE-së

Traktatet themeluese të BE-së nuk u japin institucioneve të Bashkimit kompetenca të përgjithshme për të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të arrihen objektivat e Traktatit, por ama parashtrajnë në çdo kapitull masën e kompetencave për veprim. Si parim themelor, BE-ja dhe institucionet e saj nuk kanë autoritetin që të vendosin vetë mbi kompetencat dhe bazën ligjore të tyre; parimi i dhënies specifike të kompetencave (Neni 2 TFBE) vazhdon të jetë i zbatueshëm. Kjo metodë është përzgjedhur nga Shtetet Anëtare në mënyrë që ato të garantohen se transferimi i kompetencave, do të jetë lehtësisht i monitorueshëm dhe i kontrolluar. Gama e çështjeve që mbulohen nga kompetencat e delegimit është në varësi të natyrës së detyrave që i janë ngarkuar BE-së.

Kompetencat që nuk i janë transferuar BE-së, mbeten kompetenca ekskluzive të Shteteve Anëtare. Traktati i BE-së shprehet qartësisht se çështjet e sigurisë kombëtare mbeten nën autoritetin ekskluziv të Shteteve Anëtare. Për pasojë, natyrshëm lind pyetja se ku është vija ndarëse ndërmjet kompetencave të BE-së dhe atyre të Shteteve Anëtare. Kjo vijë ndarëse hiqet bazuar në tre kategori kompetencash:

- Kompetenca ekskluzive e BE-së (Neni 3 TFBE) për ato fusha ku supozohet se një masë në nivelin e BE-së do të jetë më e efektshme se sa një masë e pakoordinuar në një Shtet Anëtar. Këto fusha janë parashtruar qartësisht dhe përfshijnë bashkimin doganor, vendosjen e rregullave të konkurrencës që janë të nevojshme për funksionimin e tregut të brendshëm, politikën monetare të Shteteve të Eurozonës, politikën e përbashkët tregtare dhe politikën e përbashkët të peshkimit. Në fushat e sipërpërmendura të politikave, vetëm Bashkimi European mund të nxjerrë akte ligjore me fuqi detyruese, kurse Shtetet Anëtare mund ta bëjnë këtë vetëm nëse lejohen nga Bashkimi European, ose në zbatim të akteve të Bashkimit (Neni 2(1) TFBE);
- Kompetenca të përbashkëta ndërmjet BE- së dhe Shteteve Anëtare (Neni 4 TFBE) në ato fusha ku veprimet në nivel europian do t'ua shtojnë vlerat veprimeve nga Shtetet Anëtare. Ka kompetenca të përbashkëta për rregullat e tregut të brendshëm, ato ekonomike, sociale dhe të kohezionit territorial, bujqësinë dhe peshkimin, mjedisin, transportin, rrjetet trans-europiane, furnizimin me energji, hapësirën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë si edhe për çështjet e përbashkëta të sigurisë lidhur me shëndetin publik, kërkimin dhe zhvillimin teknologjik, hapësirën, bashkëpunimin për zhvillim si edhe ndihmën humanitare. Në të gjitha këto fusha, fillimisht vetë BE-ja duhet të ushtrojë kompetencat e saj, por vetëm për ato çështje që janë parashtruar në instrumentin përkatës të Bashkimit, dhe jo për gjithë politikat e asaj fushe. Shtetet Anëtare ushtrojnë kompetencat e tyre deri në atë masë në të cilën BE-ja nuk i ka ushtruar kompetencat e veta apo ka vendosur që të mos vazhdojë t'i ushtrojë më ato (Neni 2(2) TFBE). Situata e fundit lind kur institucionet përkatëse të BE-së vendosin që të shfuqizojnë një akt ligjor, duke respektuar në veçanti parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit. Këshilli, me nismën e

një ose më shumë anëtarëve të tij, mund t'i kërkojë Komisionit që të paraqesë propozimet për shfuqizimin e një akti ligjor.

- **Kompetenca për të ndërmarrë veprime mbështetëse (Neni 6 TFBE).** Kompetenca e BE-së për të ndërmarrë veprime mbështetëse kufizohet në koordinimin apo plotësimin e veprimeve të Shteteve Anëtare; BE-ja nuk mund ta harmonizojë të drejtën kombëtare në fushat e përmendura (Neni 2(5) TFBE). Për pasojë, përgjegjësia për hartimin e legjislacionit vazhdon të jetë e Shteteve Anëtare, të cilave u është lënë një liri e konsiderueshme veprimi. Fushat që mbulohen nga kjo kategori kompetencash janë mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njeriut, industria, kultura, turizmi, arsimiti, rinia, sporti, formimi profesional, mbrojtja civile dhe bashkëpunimi administrativ. Në fushat e arsimit dhe të politikës ekonomike, Shtetet Anëtare pranojnë haptazi nevojën për të koordinuar masat kombëtare brenda BE-së.

Duhet të theksohet se kompetencat e BE-së në fushën e bashkërendimit ekonomik dhe politikës së punësimit, si edhe në fushën e bashkëpunimit për politikën e jashtme dhe të sigurimit, nuk bëjnë pjesë në asnjë prej këtyre tre kategorive, dhe për pasojë, nuk i përkasin këtij grupi kompetencash. Megjithatë, është bërë një deklaratë në të cilën thuhet se politika e përbashkët për punët e jashtme dhe sigurimit të BE-së, nuk do të cenojë kompetencat e shteteve Anëtare për politikën e tyre të jashtme si edhe qëndrimet kombëtare për çështje të ndryshme të politikës botërore. Përveç këtyre kompetencave të veçanta të veprimit, Traktatet e Bashkimit u japin institucioneve edhe kompetencat për veprim, kur kjo është e nevojshme për funksionimin e tregut unik apo për të siguruar konkurrencën e lirë (shih Nenin 352 TFBE — kompetencat rregulluese apo klauzola e fleksibilitetit). Sidoqoftë, këto nene nuk u japin institucioneve ndonjë kompetencë të përgjithshme që u mundëson atyre realizimin e detyrave që janë jashtë objektivave të përcaktuar në Traktate, prandaj institucionet e Bashkimit nuk mund ti zgjerojnë kompetencat e tyre, duke tkurrur kompetencat e Shteteve Anëtare. Në praktikë, mundësitë që jepen nga kjo kompetencë janë përdorur shumë shpesh në të shkuarën, meqë

hera herës BE-ja është përballur me detyra të reja, të cilat nuk ishin parashikuar në kohën kur u nënshkruan Traktatet themelues, e që rrjedhimisht, për to nuk ishin parashikuar kompetenca specifike në Traktate. Si shembuj sjellim mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorëve ose ngritjen e Fondit European për Zhvillim Rajonal, si një mënyrë për zvogëlimin e dallimit ndërmjet rajoneve të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara në BE. Megjithatë, tani janë dhënë kompetenca specifike për fushat e sipërpërmendura. Këto dispozita specifike tregojnë se është ulur ndjeshëm rëndësia praktike e kompetencave rregulluese të BE-së.

Për të ushtruar këto kompetenca, nevojitet miratimi i Parlamentit European. Gjithashtu, ka kompetenca të tjera për marrjen e atyre masave që janë të domosdoshme për zbatimin e efektshëm dhe kuptimplotë të kompetencave që janë dhënë në mënyrë të qartë (kompetencat e nënkuptuara). Këto kompetenca kanë fituar një rëndësi të veçantë për sa u takon marrëdhënieve me jashtë. Ato i mundësojnë BE-së që të marrë përsipër detyrime të caktuara ndaj vendeve jo anëtare apo organizatave të tjera ndërkombëtare në fushat që mbulohen nga lista e detyrave që i janë besuar BE-së. Një shembull i qartë është ai i çështjes Kramer, për të cilën ka marrë vendim Gjykata e Drejtësisë. Kjo çështje kishte të bënte me kapacitetin e BE-së për të bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare në caktimin e kufizimeve të peshkimit, dhe, sa herë që konsiderohej e përshtatshme, në marrjen përsipër të detyrimeve sipas të drejtës ndërkombëtare. Meqë në Traktat nuk kishte ndonjë dispozitë të veçantë, Gjykata arriti në përfundimin se kompetencat e nevojshme për punët e jashtme të BE-së burojnë nga kompetenca e saj e brendshme për politikën e peshkimit, në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore.

Megjithatë, në ushtrimin e këtyre kompetencave, BE-ja udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit, i huazuar nga doktrina sociale e katolicizmit romak, e cila ka fituar një status pothuajse kushtetues, pasi është mishëruar në Traktatin e BE-së (Neni 5(3)). Një parim i tillë mbart dy elemente: Elementin pohues sipas të cilës BE-ja duhet të veprojë atëherë kur objektivat që duhet të përmbushen mund të arrihen më mirë në nivel Bashkimi, gjë që rrit kompetencat e këtij të fundit; dhe elementin mohues sipas të cilit Bashkimi nuk duhet të veprojë kur objektivat mund të arrihen në mënyrë

të kënaqshme nga Shtetet Anëtare në mënyrë individuale, gjë e cila i tkurr kompetencat e BE-së.

Në praktikë, kjo do të thotë se të gjitha institucionet e Bashkimit, por sidomos Komisioni, duhet të argumentojnë se rregullat dhe veprimet e përbashkëta janë me të vërtetë të nevojshme. Për të përfrazuar Montesquienë (Montesquieu), atëherë kur nuk është e nevojshme që BE-ja të ndërmarrë ndojnë veprim, është e nevojshme që ajo të mos e bëjë një gjë të tillë. Nëse shfaqet nevoja për rregulla të Bashkimit, atëherë pyetja tjetër që lind ka të bëjë me intensitetin dhe formën që duhet të marrin ato. Përgjigja rrjedh prej parimit të proporcionalitetit, që është bërë pjesë e së drejtës së Bashkimit nëpërmjet vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European dhe është mishëruar në Traktatin European së bashku me dispozitat për kompetencat (Neni 5(4)). Kjo nënkupton që nevoja për një instrument specifik ligjor duhet të vlerësohet në detaje, për të parë nëse ka ndonjë mjet tjetër më pak shtrëngues për të arritur të njëjtin rezultat. Në përgjithësi, konkluzioni që duhet të arrihet është se legjislacioni kuadër, standardet minimale, si edhe njohja e ndërsjellë e standardeve ekzistuese ndërmjet Shteteve Anëtare, duhet të jetë më e parapëlqyeshme se sa dispozitat ligjore tejet të hollësishme.

Parlamentet kombëtare mund të kontrollojnë gjithashtu zbatimin në nivel kombëtar të parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit. Për këtë qëllim, është prezantuar një sistem alarmi parandalues, i cili i lejon parlamentet kombëtare që të dalin me një qëndrim të arsyetuar brenda tetë javëve pas marrjes së propozimit ligjor, në të cilin parashtrohet se përse propozimi ligjor në fjalë nuk i përmbush kërkesat e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit. Nëse ky qëndrim i arsyetuar mbështetet nga e pakta një e treta e votave që kanë parlamentet kombëtare (ku çdo parlament kombëtar ka dy vota, ose në rast të sistemeve me dhoma, një votë për secilën dhomë), propozimi legjislativ duhet të rishikohet përsëri nga institucioni që e ka nxjerrë atë (zakonisht nga Komisioni). Pas këtij rishikimi, propozimi i bërë mund të ruhet, të ndryshohet apo të tërhiqet. Nëse Komisioni European vendos që ta mbajë po atë projektpropozim, atëherë ai duhet të nxjerrë një opinion të arsyetuar, në të cilin të shprehë se përse mendon se ky projekt është në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Ky opinion i arsyetuar i dërgohet ligjvënësit të BE, së bashku me opinionet

e arsyetuara të parlamenteve kombëtare, në mënyrë që ato të merren parasysh gjatë procedurës legislative. Nëse me anë të një shumice prej 55% të Anëtarëve të Këshillit të BE-së, ose me anë të shumicave të votave të hedhura në Parlamentin Europian, ligjvënësi i BE-së është i mendimit se propozimi nuk është në përputhje me parimin e subsidiaritetit, atëherë propozimi ligjor nuk shqyrtohet më tej.

## INSTITUCIONET E BE-SË

### ***Neni 13 i TBE (kuadri institucional)***

1. Bashkimi ka një kuadër institucional që synon të promovojë vlerat e tij, të çojë përpara objektivat e tij, t'u shërbejë interesave të tij, të shtetasve të tij dhe të Shteteve Anëtare dhe të sigurojë qëndrueshmëri, efektivitet dhe vijimësi të politikave dhe veprimeve të tij.

Institucionet e Bashkimit janë:

- Parlamenti Europian,
- Këshilli Europian,
- Këshilli,
- Komisioni Europian (më tej 'Komisioni'),
- Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian,
- Banka Qendrore Europiane,
- Gjykata e Audituesve.

2. Secili institucion vepron brenda caqeve të kompetencave që i japin Traktatet dhe në pajtim me procedurat, kushtet dhe objektivat që parashikohen në to. Institucionet duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin.

3. Dispozita të lidhura me Bankën Qendrore Europiane, Gjykatën e Audituesve dhe dispozita të hollësishme për institucionet e tjera, parashikohen në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Europian.

4. Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni ndihmohen nga Komiteti Ekonomik dhe Social dhe një Komitet i Rajoneve, të cilët kanë cilësinë e organeve këshillimore.

## PAMJE E INSTITUCIONEVE TË BE-së, SIPAS TFBE-së



<sup>(2)</sup> Kur Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009, numri i Anëtarëve u rrit përkohësisht në 754. Megjithatë, në zgjedhjet e ardhshme të 2014 duhet të rivendoset numri maksimal prej 751 anëtarësh.

SHTETI ANËTAR	VOTAT NË KËSHILL	VENDET NË PARLAMENTIN EUROPIAN
GJERMANIA	29	99
FRANCA	29	78
ITALA	29	78
MBRETËRIA E BASHKUAR	29	78
SPANJA	27	54
POLONIA	27	54
RUMANIA	14	35
HOLLANDA	13	27
BELGIKA	12	24
REPUBLIKA ÇEKE	12	24
GREQIA	12	24
HUNGARIA	12	24
PORTUGALIA	12	24
SUEDIA	10	19
BULLGARIA	10	18
AUSTRIA	10	18
DANIMARKA	7	14
SLLOVAKIA	7	14
FINLANDA	7	14
IRLANDA	7	13
LITUANIA	7	13
LETONIA	4	9
SLLOVENIA	4	7
ESTONIA	4	6
QIPROJA	4	6
LUKSEMBURGU	4	6
MALTA	3	5

Një tjetër pyetje që shtrohet në lidhje me Kushtetutën e Bashkimit European, ka të bëjë me organizimin e tij. Cilat janë institucionet e Bashkimit? Meqë BE ushtron funksione që normalisht janë të rezervuara për Shtetet, a ka qeveri,



parlament, autoritete administrative dhe gjykata, si ato që veprojnë në Shtetet Anëtare? Ndërmarrja e veprimeve për detyrat që i janë ngarkuar BE-së si edhe vetë drejtimi i procesit të integritimit, qëllimisht nuk iu lanë Shteteve Anëtare, apo në dorë të bashkëpunimit ndërkombëtar. BE ka një sistem institucional që i jep asaj mundësimundësinë për t'i dhënë shtysë dhe për të përcaktuar objektiva të reja në procesin e unifikimit të Europës dhe për të krijuar kuadrin e nevojshëm ligjor, i cili është uniforme dhe njëloj i detyrueshem në të gjithë Shtetet Anëtare, për çështjet që janë në sferën e përgjegjësisë së saj.

Aktorët kryesorë në sistemin institucional të BE-së, janë institucionet e BE-së - Parlamenti Europian, Këshilli Europian, Këshilli, Komisioni Europian, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, Banka Qendrore Europiane dhe Gjykata e Audituesve. Organet ndihmëse në sistemin institucional të BE-së janë Banka Europiane e Investimeve, Komiteti Europian Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve.

## INSTITUCIONET

### *Parlamenti Europian (Neni 14 TFBE)*

Parlamenti Europian përfaqëson popujt e Shteteve Anëtare të BE-së. Është një shkrirje e Asamblesë së Përbashkët të KEQC, Asamblesë së KEE-së dhe Asamblesë së Euroatomit që u kombinuan për të krijuar një 'asamble' sipas Konventës së vitit 1957 për Disa Institucione të Përbashkëta për Komunitetet Europiane ('Traktati i parë i bashkimit'). Emri nuk u ndryshua zyrtarisht në 'Parlament Europian' deri kur Traktati i KE-së u ndryshua me Traktatin për Bashkimin Europian, edhe pse në jetën e përditshme ndryshimi i emrit të Asamblesë në 'Parlament Europian' ishte bërë tashmë që në vitin 1958.

### **Përbërja dhe zgjedhja**

Që me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor 2009, Parlamenti Europian ka 754 deputetë. Ky numër tejkalon numrin maksimal prej 751 vendesh të përcaktuar në TBE (Neni 14(2), por duhet patur parasysh se numri aktual do të jetë vetëm për periudhën legislative 2009-14, pasi deputetët e zgjedhur në qershor 2009 nuk mund të humbisnin mandatet e tyre. Megjithatë,

numri maksimal i Anëtarëve duhet të respektohet në zgjedhjet e ardhshme të vitit 2014. Këto vende u janë caktuar Shteteve Anëtare në mënyrë të tillë që edhe pse çdo Anëtar nga një Shtet Anëtar me popullsi të madhe përfaqëson më shumë shtetas sesa çdo Anëtar nga një Shtet me më pak popullsi, asnjë Shtet me më pak popullsi të mos ketë më shumë vende sesa një Shtet me më shumë popullsi. Si rregull i përgjithshëm, numri minimal i vendeve për çdo Shtet Anëtar është gjashtë dhe numri maksimal është 96, por për shkak të datës së hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, është bërë një përjashtim për Gjermaninë në periudhën legjislativë 2009–14, duke e lejuar të ketë 99 deputetë (Deputetët e zgjedhur në qershor 2009 nuk mund të humbin vendin e tyre për shkak të hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës).

Përbërja e saktë mbetet për t'u përcaktuar nga Këshilli. Kjo duhej të ishte bërë në kohë për zgjedhjet e drejtpërdrejta të Parlamentit Europian në qershor 2009. Megjithatë, meqë Traktati i Lisbonës nuk hyri në fuqi përpara zgjedhjeve të qershorit 2009, rregullat e reja për përbërjen e Parlamentit Europian nuk mund të zbatoheshin për periudhën legjislativë 2009-14. Megjithatë, shpërndarja e vendeve që rezultoi nga anëtarësimi i Bullgarisë dhe Rumanisë, u zbatua në zgjedhjet e vitit 2009. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor 2009, numri i deputetëve u rrit nga 736 në 754 deputetë, duke pasur deputetë të rinj nga 12 Shtetet e reja Anëtare.

Përbërja e Parlamentit Europian tregohet në formë grafike si më poshtë; kjo është situata në periudhën legjislativë 2009-14. Tregohen gjithashtu ndryshimet e bëra me Traktatin e Lisbonës.

### **PRESIDENTI**

**14 Zëvendës Presidentë**

**5 Kuestorë (këshilltarë)**

Kryetari, zëvendëskryetarët dhe kuestorët krijojnë Byronë, që zgjidhet nga Parlamenti me mandat dy vjet e gjysmë. Një organ tjetër, Konferenca e Kryetarëve, përfshin gjithashtu krerët e grupeve politike. Ajo është përgjegjëse për organizimin e punës së Parlamentit dhe marrëdhënieve me institucionet e tjera të BE-së dhe me institucionet që nuk janë pjesë e Bashkimit.

## SEANCA PLENARE PARLAMENTARE ME 754 ANËTARË

SHTETI ANËTAR	VENDE NË PARLAMENTIN EUROPIAN
GJERMANIA	99
FRANCA	72+2
ITALIA	72+1
MRETËRIA E BASHKUAR	72+1
SPANJA	50+4
POLONIA	50+1
RUMANIA	33
HOLANDA	25+1
BELGJIKA	22
REPUBLIKA ÇEKE	22
GREQIA	22
HUNGARIA	22
PORTUGALIA	22
SUEDIA	18+2
BULGARIA	17+1
AUSTRIA	17+2
DANIMARKA	13
SLLOVAKIA	13
FINLANDA	13
IRLANDA	12
LITUANIA	12
LETONIA	8+1
SLLOVENIA	7+1
ESTONIA	6
QIPROJA	6
LUKSEMBURGU	6
MALTA	5+1

Deri më 1979, përfaqësuesit në Parlamentin Europian zgjidheshin nga anëtarësia në parlamente kombëtare dhe delegoheshin prej tyre në Parlamentin Europian. Zgjedhjet e drejtpërdrejta të përgjithshme të deputetëve nga popullsia e Shteteve Anëtare u parashikuan nga vetë

Traktatet, por zgjedhjet e para të drejtpërdrejta u zhvilluan vetëm në qershor 1979, pas dështimit të disa nismave të mëparshme. Tani, zgjedhjet zhvillohen një herë në çdo pesë vjet dhe kjo përputhet me kohëzgjatjen e ‘periudhës legislative’. Pas dekadash përpjekje, më në fund u zbatua një procedurë zgjedhore unike përmes aktit të datës 20 shtator 1976, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të 25 qershorit dhe 23 shtatorit 2002 (i njohur si Direktiva e Zgjedhjeve të Drejtpërdrejta) në lidhje me zgjedhjen e përfaqësuesve të Parlamentit European, nëpërmjet të drejtës së përgjithshme për të votuar. Sipas këtij akti, çdo Shtet Anëtar përcakton procedurën e vet zgjedhore, por duke zbatuar të njëjtat rregulla bazë demokratike: zgjedhje të drejtpërdrejta të përgjithshme, përfaqësim proporcional, votim i lirë dhe i fshehtë, moshë minimale (e drejta për të votuar është 18 në të gjitha Shtetet Anëtare përveç Austrisë, ku mosha minimale është 16 vjeç), mandat 5-vjeçar i përsëritshëm, papajtueshmëri (Deputetët e parlamentit European nuk mund të mbajnë dy detyra në të njëjtën kohë, p.sh., detyrën e gjyqtari, prokurorit, Ministrit; ata gjithashtu u nënshtrohen ligjeve të vendeve të tyre, që mund të kufizojnë më tej aftësinë e tyre për të mbajtur më shumë sesa një post ose pozicion), datë e zgjedhjeve dhe barazi ndërmjet burrave dhe grave. Në disa vende (Belgjikë, Greqi dhe Luksemburg) votimi është i detyrueshëm. Përveç këtyre, statuti për Deputetët e Parlamentit European hyri në fuqi më 14 korrik 2009. Ky statut i ri i bën më transparent mandatet dhe kushtet e punës të Deputetëve të Parlamentit dhe përmban rregulla të qarta. Gjithashtu ai përcakton për të gjithë deputetët e Parlamentit pagesë të njëjtë, e cila mbulohet nga buxheti i BE-së.

Tani që zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, Parlamenti gëzon legjitimitet demokratik dhe mund të thuhet vërtet se përfaqëson shtetasit e Shteteve Anëtare të BE-së. Por vetëm ekzistenca e një Parlamenti të zgjedhur drejtpërdrejt nuk mund të përmbushë kërkesën thelbësore të një kushtetute demokratike, sipas të cilës autoriteti publik duhet të burojë prej popullit. Kjo nuk do të thotë vetëm që procesi i vendimmarrjes të jetë transparent dhe institucionet vendimmarrëse të jenë përfaqësuese; kërkohet kontroll parlamentar dhe Parlamenti duhet t’u japë legjitimitet institucioneve të Bashkimit të përfshira në procesin e vendimmarrjes. Në këtë drejtim, së fundmi është arritur shumë progres. Të drejtat e Parlamentit jo vetëm që janë shtrirë në vazhdimësi, por Traktati i Lisbonës ka krijuar qartazi detyrime

për veprim nga ana e BE-së, që të respektohen parimet e demokracisë përfaqësuese. Për rrjedhojë, të gjithë shtetasit e Bashkimit përfaqësohen drejtpërdrejt në Parlament dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën demokratike të BE-së. Objektivi kryesor është që vendimet në nivel të BE-së të merren sa më hapur dhe sa më pranë shtetasve. Partitë politike në nivel të BE-së duhet të kontribuojnë që t'i japin trajtë identitetit evropian dhe të artikulojnë vullnetin e shtetasve të Bashkimit. Nëse flasim për ndonjë deficit të modelit aktual demokratik të BE-së, ky deficit ka të bëjë me faktin që Parlamenti Europian, ndryshe nga parlamentet e mirëfillta në një demokraci parlamentare, nuk zgjedh një qeveri që përgjigjet përpara tij.

### ***Neni 10 i TBE (demokraci përfaqësuese)***

1. Funksionimi i Bashkimit i ka themelet te demokracia përfaqësuese.

2. Shtetasit përfaqësohen drejtpërdrejt në nivel të Bashkimit, në Parlamentin Europian.

Shtetet Anëtare përfaqësohen në Këshillin Europian nga Kreu i Shtetit ose i Qeverisë dhe në Këshill nga qeveritë, të cilat në vetvete përgjigjen në mënyrë demokratike përpara parlamenteve të tyre ose përpara shtetasve të tyre.

3. Çdo shtetas ka të drejtën e pjesëmarrjes në jetën demokratike të Bashkimit.

Vendimet merren sa më hapur dhe sa më pranë shtetasve.

4. Partitë politike në nivel evropian kontribuojnë në formimin e ndërgjegjësimit politik evropian dhe në shprehjen e vullnetit të shtetasve të Bashkimit.

Megjithatë, arsyeja për këtë deficit është që në nivel të BE-së nuk ka qeveri në kuptimin e zakonshëm të fjalës. Në vend të kësaj, funksionet e ngjashme me qeverinë, të parashikuara në Traktatet e Bashkimit, kryhen nga Këshilli dhe Komisioni Europian, sipas një ndarjeje të caktuar të punës. Pavarësisht prej kësaj, Traktati i Lisbonës i dha Parlamentit kompetenca të gjera në lidhje me emërimet në Komision, që variojnë nga zgjedhja e Presidentit të Komisionit nga Parlamenti me rekomandim të Këshillit Europian, deri tek votimi i Parlamentit për emërimin e të gjithë trupës së Komisionerëve (e drejta e emërimit).

Megjithatë, Parlamenti nuk e ka mundësinë e një ndikimi të tillë mbi anëtarësinë e Këshillit, e cila i nënshtrohet kontrollit parlamentar vetëm në masën që çdo anëtar i tij, si Ministër kombëtar, përgjigjet përpara parlamentit kombëtar.

Roli i Parlamentit European në procesin legjislativ është rritur ndjeshëm. Ngritja e procedurës së vendimmarrjes në nivel të procedurës të zakonshme legislative, në fakt, e ka shndërruar Parlamentin European në 'bashkë-ligjvënës', së bashku me Këshillin.

Në procedurën e zakonshme legislative, Parlamenti jo vetëm që mund të parashtojë ndryshime të legjislacionit në lexime të ndryshme por dhe, brenda disa caqeve, mund të sigurojë që ato ndryshime të pranohen nga Këshilli. Legjislacioni i Bashkimit nuk mund të miratohet pa marrëveshje ndërmjet Këshillit dhe Parlamentit European.

Tradicionalisht, Parlamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në procedurën e miratimit të buxhetit. Traktati i Lisbonës i shtriu më tej kompetencat buxhetore të Parlamentit European, duke përcaktuar që Parlamenti duhet të miratojë planin financiar shumëvjeçar dhe duke i dhënë atij kompetenca bashkë vendimmarrjeje për të gjitha shpenzimet (nuk ka më dallim ndërmjet shpenzimeve të detyrueshme dhe jo të detyrueshme).

Parlamenti ka të drejtë të japë pëlqimin për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të rëndësishme në lidhje me fushën që kërkon bashkë-vendimmarrje, si edhe për Traktatet e Anëtarësimit, të lidhura me Shtetet e reja Anëtare, në të cilat përcaktohen kushtet e anëtarësimit.

Kompetencat mbikëqyrëse të Parlamentit European gjithashtu janë rritur ndjeshëm me kalimin e kohës. Ato janë ushtruar kryesisht me faktin që Komisioni duhet të raportojë përpara Parlamentit, të mbrojë propozimet e tij përpara tij dhe t'i paraqesë për debat një raport vjetor për veprimtaritë e BE-së. Me dy të tretat e anëtarëve të tij, Parlamenti, mund të miratojë një mocion mosbesimi, dhe kështu ta detyrojë Komisionin si i tërë të japë dorëheqjen (Neni 234 TFBE). Disa mocione të tilla i janë paraqitur Parlamentit, por asnjë ende nuk i është afruar arritjes së shumicës së kërkuar. Dorëheqja e Komisionit Santer më 1999 u nxit nga refuzimi i Parlamentit për ta shkarkuar atë në lidhje me çështjen e menaxhimit financiar. Mocioni i mosbesimit që u paraqit në këte rast, ishte gjithashtu i pasuksesshëm, edhe


pse vetëm për pak vota. Meqë në praktikë Këshilli gjithashtu u përgjigjet pyetjeve parlamentare, Parlamenti ka mundësinë për debat të drejtpërdrejtë politik me dy institucione kryesore. Këto kompetenca mbikëqyrëse të Parlamentit janë përforcuar. Tani ai është autorizuar edhe të krijojë Komisione Hetimore të veçanta për të shqyrtuar në mënyrë specifike raste të mundshme të shkeljes së të drejtës komunitare apo keqadministrimit. Një komision i tillë u përdor, për shembull, për të trajtuar përgjegjësinë e Komisionit për vonesën e reagimit për ‘sëmundjen e lopës së çmendur’ në Mbretërinë e Bashkuar, që përbënte kërcënim për jetën dhe shëndetin e njeriut. Gjithashtu, Traktatet parashikojnë të drejtën e çdo përoni fizik apo juridik për t’i drejtuar Parlamentit peticione, të cilat më pas trajtohen nga një Komision i përhershëm i Peticioneve. Për ta mbyllur, Parlamenti ka përdorur gjithashtu kompetencën e tij për të emëruar një Avokat Popullit, të cilit mund t’i drejtohen ankesat për keqadministrim ne veprimtarine e institucioneve ose organeve të Bashkimit, me përjashtim të Gjykatës së Drejtësisë. Avokati i Popullit mund bëjë hetime dhe duhet ta informojë institucionin ose organin e interesuar për këtë gjë. Ai duhet gjithashtu t’i paraqesë Parlamentit një raport mbi rezultatet e hetimeve të bëra.

### **Procedurat e punës**

Normat bazë që rregullojnë punimet e Parlamentit përcaktohen qartë në rregulloren e tij të brendshme.

Deputetët krijojnë grupe politike. Nisur nga statusi i Parlamentit si një institucion i Bashkimit, këto janë grupe politike partiake, që tejkalojnë kufijtë kombëtar.

Parlamenti zhvillon çdo muaj (me përjashtim të gushtit) seancat e tij plenare njëjavore në Strasburg. Mund të zhvillohen gjithashtu seanca shtesë, sidomos në lidhje me çështjet e buxhetit. Seanca më të shkurtra (që zgjasin një ose dy ditë) zhvillohen në Bruksel. Së fundi, mund të mbahen edhe seanca të jashtëzakonshme për të trajtuar çështje shumë të rëndësishme dhe më aktualitet të mprehtë (siç janë çështjet e Bashkimit, çështjet ndërkombëtare, shkelje e të drejtave të njeriut), të cilat bëjnë të mundur që Parlamenti të përcaktojë pa vonesë pozicionin e tij. Të gjitha seancat plenare janë të hapura për publikun.

GRUPIMET POLITIKE NË PARLAMENTIN EUROPIAN <sup>(3)</sup>

<sup>(3)</sup> 18 anëtarë shtesë iu shpërndanë grupimeve politike me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, emërimet për shtatë anëtarë nga Franca, Italia, Polonia dhe Mbretëria e Bashkuar nuk janë bërë ende.

## Procedura të vendimmarrjes

Zakonisht, shumica absolute e votave është e mjaftueshme që të merret një vendim. Megjithatë, ndërsa rëndësia e Parlamentit rritet, kërkesa gjithnjë e më të rrepta vendosen në lidhje me pjesëmarrjen e deputetëve. Një gamë e gjerë vendimesh mund të miratohet vetëm nëse merren me shumicë absolute të të gjithë deputetëve. Së fundi, çdo mocion mosbesimi kundër Komisionit European jo vetëm që duhet të mbështetet fillimisht nga shumica e anëtarëve të Parlamentit, por në votimin që do të bëhet duhet të marrë mbështetjen e jo më pak se dy të tretat e votave të tyre.



**KOMISIONET E PËRHERSHME TË PARLAMENTIT EUROPIAN**

Komisioni i Punëve të Jashtme (me nënkomisionet 'Të drejtat e njeriut' dhe 'Sigurimin dhe Mbrojtjen')

Komisioni i Zhvillimit

Komisioni i Tregtisë Ndërkombëtare

Komisioni i Buxhetit

Komisioni i Kontrollit Buxhetor

Komisioni i Çështjeve Ekonomike dhe Monetare

Komisioni i Çështjeve të Sociale dhe të Punësimit

Komisioni i Mjedisit, Shëndetit Publik dhe Sigurisë Ushqimore

Komisioni i Industrisë, Kërkimit dhe Energjisë

Komisioni i Tregut të Brendshëm dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Komisioni i Transportit dhe Turizmit

Komisioni i Zhvillimit Rajonal

Komisioni i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Komisioni i Peshkimit

Komisioni i Kulturës dhe Arsimimit

Komisioni i Çështjeve Ligjore

Komisioni i Lirive Civile, Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme

Komisioni i Çështjeve Kushtetuese

Komisioni i të Drejtave të Grave dhe Barazisë Gjinore

Komisioni i Peticioneve

**Selia**

Këshilli European vendosi që selia e Parlamentit të ishte në Strasburg dhe kështu iu dha fund gjendjes së përkohshme që funksiononte prej 30 vjetësh. Është bërë praktikë që seancat plenare të mbahen në Strasburg dhe në Bruksel, takimet e grupeve politike dhe komisioneve të mbahen në Bruksel, gjatë javëve kur Parlamenti nuk është mbledhur, dhe që Sekretariati i Përgjithshëm i Parlamentit të jetë në Luksemburg. Vendimi i Këshillit për vendndodhjen e selive të institucioneve konfirmoi vlefshmërinë e këtyre rregulimeve, me kushtin që 12 periudhat e seancave plenare mujore të mbahen në Strasburg. Rezultati i pakënaqshëm i këtij vendimi është që deputetët dhe disa zyrtarë

dhe punonjës të Parlamentit duhet të udhëtojnë në Strasburg, Bruksel dhe Luksemburg- një kosto shumë e lartë kjo për BE-në.

### ***Këshilli European (Neni 15 TBE)***

Këshilli European u krijua nga konferenca e përfaqësuesve të nivelit të lartë të Krerëve të Shtetit ose Qeverisë në BE. Në takimin e nivelit të lartë në dhjetor 1974 u vendos që takimet duhet të mbaheshin tri herë në vit dhe të njiheshin me emrin Këshilli European. Që atëherë, Këshilli European është bërë një organ i pavarur i Bashkimit European (Neni 13 TBE).


Krerët e Shtetit ose Qeverisë dhe Presidenti i Komisionit European takohen të paktën dy herë çdo gjashtë muaj në këtë formacion. Kur e kërkon rendi i ditës, Anëtarët e Këshillit European mund të vendosin të kërkojnë mbështetjen e një Ministri, dhe në rastin e Presidentit të Komisionit, mbështetjen e një Anëtari të Komisionit European, për t'i ndihmuar në punën e tyre (Neni 15(3) TBE).

Traktati i Lisbonës krijoi zyrën e Presidentit të Këshillit European.<sup>4</sup> Presidenti i Këshillit European, ndryshe nga Presidenca deri tani, ka një mandat european, jokombëtar, që zgjat dy vjet e gjysmë me kohë të plotë. Personi i emëruar President duhet të jetë personalitet i shquar, i zgjedhur me votim me shumicë të cilësuar të Anëtarëve të Këshillit European. Rizgjedhja është e mundshme vetëm një herë. Detyrat e Presidentit përfshijnë përgatitjen dhe ndjekjen e takimeve të Këshillit European dhe përfaqësimin e BE-së në takime të nivelit të lartë ndërkombëtar në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurimit.

Funksioni aktual i vetë Këshillit European është të përcaktojë orientimet e politikave të përgjithshme për veprim të BE-së. Ai e kryen këtë funksion duke marrë vendime mbi politikat kryesore dhe duke nxjerrë udhëzime dhe orientime për Këshillin ose Komisionin European. Këshilli European në këtë mënyrë ka drejtuar punën për bashkimin ekonomik dhe monetar, Sistemin European Monetar, zgjedhjet e drejtpërdrejta në Parlament dhe një sërë çështjesh për problemet e anëtarësimit.

<sup>4</sup> *Herman van Rompuy, në atë kohë Kryeministër i Belgjikës, u emërua si Presidenti i parë i Këshillit European dhe mori detyrën më 1 dhjetor 2009.*

*Këshilli (Neni 16 TBE)*



**Përbërja dhe Presidenca**

Këshilli përbëhet nga përfaqësues të qeverive të Shteteve Anëtare. Të 27 Shtetet Anëtare dërgojnë një përfaqësues, si rregull, por jo domosdoshmërisht, ministrin ose zëvendësministrin përgjegjës për çështjen në shqyrtim. Është e

rëndësishme që këta përfaqësues të kenë mandat për të marrë vendime, të cilat kanë efekte detyruese për qeverite e tyre. Vetë fakti që qeveritë mund të përfaqësohen në mënyra të ndryshme, nënkupton që nuk ka anëtarë të përhershëm të Këshillit; përkundrazi, përfaqësuesit e Këshillit mbledhen në nëntë konfigurime të ndryshme, në varësi të çështjes në shqyrtim.

Këto janë: (1) Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme dhe të Jashtme si: Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme që bashkërendon punën e Këshillit në konfigurimet e tij të ndryshme, dhe, bashkë me Kryetarin e Këshillit Europian dhe Komisionin Europian përgatit mbledhjet e Këshillit Europian; Këshilli i çështjeve të Jashtme që merret me veprimet e jashtme të BE-së në përputhje me udhëzimet strategjike të Këshillit Europian dhe garanton që veprimet e BE-së të kenë qëndrueshmëri dhe koherence. Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme dhe të Jashtme përbëhet nga Ministrat e Jashtëm; mbledhjet e tij për çështje të përgjithshme kryesohen nga Presidenca e radhës, ndërsa ato për çështje të jashtme kryesohen nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit. Ekzistojnë edhe tetë formacione të tjera të Këshillit, ku marrin pjesë Ministra të Shteteve Anëtare përgjegjës për çështjen në fjalë: (2) ‘Çështjet Ekonomike dhe Financiare’ (i njohur gjerësisht si Këshilli Ecofin), (3) Bashkëpunimi në fushën e ‘Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme’, (4) ‘Punësimi, Politika Sociale, Shëndetësia dhe Çështjet e Konsumatorit’, (5) ‘Konkurrenca’, (6) ‘Transporti, Telekomunikacioni dhe Energjia’, (7) ‘Bujqësia dhe Peshkimi’, (8) ‘Mjedisi’ dhe (9) ‘Arsimi, Rinia dhe Kultura’.

Presidenca e Këshillit - me përjashtim të Këshillit të Ministrave të Jashtëm, që mbahet nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit – mbahet nga secili Shtet Anëtar me rotacion çdo gjashtë muaj. Rendi i mbajtjes së postit të Kryetarit vendoset unanimisht nga Këshilli. Presidenca “ndërron shef” më 1 janar dhe më 1 korrik të çdo viti (2008: Sllovenia dhe Franca; 2009: Republika Çeke dhe Suedia; 2010: Spanja dhe Belgjika; 2011: Hungaria dhe Polonia; 2012: Danimarka dhe Qiproja; 2013: Irlanda dhe Lituania etj.). Për shkak të rotacionit “të shpejtë”, Presidenca i bazon veprimet e saj mbi një program pune, për të cilin është rënë dakord me dy Presidencat e radhës dhe që është i vlefshëm për 18 muaj (“ekipi i Presidencës”). Presidenca është kryesisht përgjegjëse për bashkërendimin e përgjithshëm të punës së Këshillit dhe të komiteteve. Kjo është e rëndësishme edhe në aspektin politik, pasi Shteti Anëtar që mban Presidencën e BE-së, ka rol më të madh në arenën ndërkombëtare, duke u dhënë kështu Shteteve Anëtare të vogla mundësinë që të qëndrojnë krah më krah me “lojtarët me peshë” dhe të lënë gjurmën e tyre në politikën europiane.

Këshilli e ka selinë në Bruksel.



20 korrik 1979, Strasburg.  
Simone Veil bëhet Presidente e  
Parlamentit të Parë European pas zgjedhjeve  
të përgjithshme.

## Detyrat

Prioriteti kryesor i Këshillit është legjislacioni, të cilin e realizon bashkë me Parlamentin në procesin e bashkë-vendimmarrjes. Këshilli është përgjegjës edhe për bashkërendimin e politikave ekonomike të Shteteve Anëtare. Gjithashtu, Këshilli përcakton buxhetin mbi bazën e një projekti paraprak që i dorëzon Komisioni, por që duhet miratuar nga Parlamenti. Përveç kësaj, Këshilli mund të bëjë një rekomandim Parlamentit që t'i japë të drejta Komisionit në lidhje me zbatimin e buxhetit. Këshilli është përgjegjës edhe për emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Audituesve, Komitetit Ekonomik dhe Social European dhe Komitetit të Rajoneve. Ai mund të përfundojë gjithashtu marrëveshje ndërmjet BE-së dhe vendeve jo anëtare apo organizatave ndërkombëtare.

## Procedurat e punës

Procedurat e punës të Këshillit janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të tij. Konkretisht, veprimtaritë e Këshillit artikullohen kryesisht në këto tri faza:

### *Përgatitja e mbledhjeve të Këshillit*

Me punët përgatitore merren dy organe të përhershme, që janë pjesë tërësore e strukturës organizative të Këshillit: Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm dhe Sekretariati i Përgjithshëm.

Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm që njihet si Coreper (nga emërtimi në frëngjisht i Comité des représentants permanents), ka për detyrë të përgatisë punën e Këshillit dhe të kryejë detyrat që i ka ngarkuar Këshilli. Për të siguruar funksionim optimal, Komiteti është i ndarë në: Coreper I (i përbërë nga zv.Përfaqësues të Përhershëm të Shteteve Anëtare dhe që është përgjegjës kryesisht për punën përgatitore për çështjet më teknike, me të cilat merren Këshillat e ndryshëm) dhe Coreper II (i përbërë nga vetë Përfaqësuesit e Përhershëm të Shteteve Anëtare, dhe që është përgjegjës kryesisht për të gjitha çështjet e politikave). Bujqësia është e vetmja fushë që nuk është objekt i kësaj ndarjeje të detyrave; një Komitet i Posaçëm për Bujqësinë (KPB, i njohur edhe me shkurtimin francez CSA - Comité spécial de l'Agriculture) u krijua më 1960 dhe mori përsipër detyrat e Coreper-it në lidhje me çështjet bujqësore.

Coreper-i dhe CSA përgatisin mbledhjet e Këshillit sipas dy procedurave: Së pari, bëjnë përpjekje të gjejnë një marrëveshje brenda komitetit, për të cilën

komitetet mund të kërkojnë ndihmën e rreth 100 grupeve sektoriale të punës që punojnë brenda Këshillit. Gjithashtu, mund t'i drejtohen për ndihmë “grupeve ad hoc”, të ngarkuar me një problem specifik brenda një harku kohor të caktuar. Së dyti, puna përgatitore sqaron paraprakisht çështjet që do të diskutohen dhe miratohen në mbledhjen e Këshillit, dhe informon siç duhet anëtarët e Këshillit. Këto dy qasje pasqyrohen në agjendën e mbledhjeve: çështjet për të cilat është arritur marrëveshje figurojnë në agjendë si “pika A”, ndërsa çështjet ende të hapura që kanë ende nevojë për diskutime të mëtejshme, figurojnë si “pika B”.

Sekretariati i Përgjithshëm i jep ndihmë administrative Këshillit (si edhe Corepër-it dhe CSA-së). Ai merret sidomos me përgatitjen teknike të mbledhjeve të Këshillit, organizon shërbimin e përkthimit (përfaqësuesit e Shteteve Anëtare flasin në gjuhën e tyre amtare), siguron përkthimet e nevojshme të dokumenteve, i jep ndihmë juridike Këshillit dhe komiteteve, si edhe administron buxhetin e Këshillit.

### *Mbledhjet e Këshillit*

Këshilli mbledhet me nismën e kryetarit të vet (përfaqësuesi i Shtetit Anëtar që mban Presidencën e Këshillit ose Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit), pas kërkesës së një prej anëtarëve të tij ose me kërkesë të Komisionit Europian. Kryetari harton agjendën e përkohshme për çdo mbledhje, të përbërë nga një pjesë me Pika A dhe një pjesë me Pika B.

Këshilli diskuton dhe merr vendime vetëm mbi bazën e dokumenteve apo projekteve të disponueshme në 23 gjuhë zyrtare (bullgarisht, çekisht, danisht, holandisht, anglisht, estonisht, finlandisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, hungarisht, irlandisht, italisht, letonisht, lituanisht, maltisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, sllovakisht, slovenisht, spanjisht dhe suedisht). Kur çështja është urgjente, parashikohet derogimi unanim i zbatimit të këtij rregulli. Kjo vlen edhe për propozimet për ndryshime, të paraqitura dhe të diskutuara gjatë mbledhjes.

Mbledhjet gjatë të cilave Këshilli diskuton apo voton propozime legjislativë, janë të hapura për publikun. Praktikisht, kjo do të thotë se mbledhjet transmetohen në salla me pamje të drejtpërdrejta audio-vizuale në ndërtesën e Këshillit.

Këshilli diskuton duke mbajtur parasysh në mënyrë të barabartë interesat e Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit. Edhe pse Shtetet Anëtare kryesisht mbrojnë interesat e tyre në Këshill, anëtarët e tij janë të detyruar të respektojnë objektivat dhe

nevojat e Bashkimit në tërësinë e vet. Këshilli është institucion i Bashkimit dhe jo konferencë ndërqeveritare. Rrjedhimisht, diskutimet nuk kanë për qëllim të arrijnë mirëkuptimin minimal të përbashkët ndërmjet Shteteve Anëtare, por ekuilibrin e përshtatshëm mes interesave të Bashkimit dhe atyre të Shteteve Anëtare.

### *Procedura e vendimmarrjes*

Në kuadër të traktateve të BE-së, si rregull, votimi në Këshill bëhet me shumicë të cilësuar, (neni 16, pika 3 e TBE-së). Shumica e thjeshtë, ku çdo anëtar Këshilli ka të drejtën e një vote, zbatohet vetëm për çështje individuale dhe për fusha më pak të ndjeshme (shumica e thjeshtë aktualisht arrihet me 14 vota).

Metodat për llogaritjen e shumicës së cilësuar ndryshojnë sipas fazave të ndryshme.

Deri më 1 nëntor 2014 do të përdoret sistemi i votimit të ponderuar, i futur nga Traktatit i Nisës, që u jep Shteteve Anëtare të mëdha më shumë peshë. Me këtë sistem, shumica e cilësuar arrihet kur ka një shumicë të Shteteve Anëtare me të paktën 255 vota nga 345, edhe pse një Shtet Anëtar mund të kërkojë që këto Shtete Anëtare të përfaqësojnë të paktën 62% të popullsisë së BE-së.

Që më 1 janar 2007, numri i votave që ka secili Shtet Anëtar, është si vijon:

<b>PONDERIMI I VOTAVE</b>			
<b>GJERMANIA</b>	<b>29</b>	<b>AUSTRIA</b>	<b>10</b>
<b>FRANCA</b>	<b>29</b>	<b>SUEDIA</b>	<b>10</b>
<b>ITALIA</b>	<b>29</b>	<b>DANIMARKA</b>	<b>7</b>
<b>MBRETËRIA E BASHKUAR</b>	<b>29</b>	<b>IRLANDA</b>	<b>7</b>
<b>SPANJA</b>	<b>27</b>	<b>LITUANIA</b>	<b>7</b>
<b>POLONIA</b>	<b>27</b>	<b>SLLOVAKIA</b>	<b>7</b>
<b>RUMANIA</b>	<b>14</b>	<b>FINLANDA</b>	<b>7</b>
<b>HOLANDA</b>	<b>13</b>	<b>ESTONIA</b>	<b>4</b>
<b>BELGJIKA</b>	<b>12</b>	<b>QIPROJA</b>	<b>4</b>
<b>REPUBLIKA ÇEKE</b>	<b>12</b>	<b>LETONIA</b>	<b>4</b>
<b>GREQIA</b>	<b>12</b>	<b>LUKSEMBURGU</b>	<b>4</b>
<b>HUNGARIA</b>	<b>12</b>	<b>SLLOVENIA</b>	<b>4</b>
<b>PORTUGALIA</b>	<b>12</b>	<b>MALTA</b>	<b>3</b>
<b>BULLGARIA</b>	<b>10</b>		



Më 1 nëntor 2014 hyn në fuqi sistemi i shumicës së dyfishtë, sipas të cilit shumica e cilësuar arrihet kur të paktën 55% të Shteteve Anëtare që përfaqësojnë 65% të popullsisë së BE-së votojnë pro një propozimi legjislativ. Për të mos lejuar Shtetet Anëtare me popullsi të vogël që të bllokojnë miratimin e një vendimi, pakica bllokuese duhet të konsistojë nga të paktën katër Shtete Anëtare, dhe, nëse ky numër nuk arrihet, atëherë shumica e cilësuar konsiderohet e arritur edhe kur nuk përmbushet kriteri i popullsisë. Sistemi plotësohet nga një mekanizëm shumë i ngjashëm me “Kompromisin e Janinës”: kur nuk arrihet pakica bllokuese, procedura e vendimmarrjes mund të pezullohet. Në këtë rast, Këshilli nuk procedon me votimin, por vazhdon negociatat për një hark kohor të arsyeshëm, nëse kjo kërkohet nga Anëtarë të Këshillit që përfaqësojnë së paku 75% të popullsisë ose së paku 75% të numrit të Shteteve Anëtare, të detyrueshëm për të përbërë një pakicë bllokuese.

I njëjti mekanizëm do të zbatohet duke filluar nga 1 prilli 2017, por përqindjet për krijimin e një pakice bllokuese do të ndryshojnë deri në së paku 55% të popullsisë ose së paku 55% e Shteteve Anëtare. Këshilli mund ta ndryshojë këtë sistem de jure me shumicë të thjeshtë. Megjithatë, një nga protokollet parashikon që më parë duhet të zhvillohen bisedime në Këshillin Europian, dhe se çdo vendim që mund të merret për këtë problem, duhet të jetë unanim.

Votimi me shumicë është i rëndësishëm jo aq shumë për faktin se i privon Shtetet e vogla nga mundësia që të bllokojnë vendime të rëndësishme, por sepse mundëson shmangien e bllokimit nga ndonjë Shtet Anëtar “i madh”. Megjithatë, “Marrëveshja e Luksemburgut” mbetet një faktor politik madhor, sidomos për sa i përket praktikës së votimit. Ajo jep të drejtën për të vënë veton për një masë Komunitare, në rastet kur një Shtet Anëtar gjykon se i cenohen interesa jetikë kombëtarë; kjo e drejtë është përdorur për të zgjidhur krizën e vitit 1965 kur Franca, duke gjykuar se interesat e saj kombëtarë në financimin e politikës së përbashkët bujqësore po kërcënoheshin, bllooi vendimmarrjen e Këshillit për më tepër se gjashtë muaj përmes së ashtuquajturës “politikë e karriges bosh”.

Për miratimin e vendimeve në fusha politike mjaft të ndjeshme, Traktatet parashikojnë unanimitetin. Por, miratimi i një vendimi nuk mund të bllokohet përmes abstenimeve. Unanimiteti kërkohet edhe për vendime të tilla si për taksat, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësve, ndryshimet në dispozitat për shtetësinë, kur gjykohet nëse një Shtet Anëtar ka shkelur parimet kushtetuese, si dhe për përcaktimin e parimeve dhe rregullave në fushat e politikës së përbashkët për punët e jashtme dhe sigurimit apo në bashkëpunimin policor dhe gjyqësor për çështjet penale.

## **Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit (neni 18 i TBE-së)**

Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit nuk është bërë ministri i Jashtëm i BE-së, siç parashikohej në projektin kushtetues; megjithatë, pozitat e tij/saj brenda strukturës institucionale janë forcuar dhe zgjeruar ndjeshëm. Si fillim, zyra e Përfaqësuesit të Lartë do të shkrihet me atë të Komisionerit për Çështjet e Jashtme. Kjo i siguron Përfaqësuesit të Lartë praninë si në Këshill, ku mban presidencën e Këshillit të Çështjeve të Jashtme, ashtu edhe në Komision, ku është zv.Kryetar i ngarkuar me çështjet e jashtme. Përfaqësuesi i Lartë emërohet nga Këshilli European me votim me shumicë të cilësuar, dhe me pëlqimin e Kryetarit të Komisionit. Ai/Ajo ndihmohet nga një shërbim i jashtëm i krijuar rishtas, i përbërë nga zyrtarë të Komisionit European<sup>5</sup>, nga Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, si dhe nga përfaqësues të atashuar të shërbimeve diplomatike të Shteteve Anëtare.

### ***Komisioni European (Neni 17 TBE)***

#### **PËRBËRJA**

**27 Anëtarë**  
**përfshirë Presidentin**  
**Zëvendës Presidentin e Parë: Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit**  
**për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit**  
**6 Zëvendës Presidentë**

Fillimisht ishte rënë dakord që duke filluar nga viti 2014 e në vijim, në Komisionin European nuk do të kishte nga një përfaqësues për çdo Shtet Anëtar, por një numër Anëtarësh të barabartë me 2/3 të numrit të Shteteve Anëtare; domethënë, po të kemi parasysh numrin aktual prej 27 Shteteve Anëtare, numri i Anëtarëve të Komisionit në 2014-ën do të jetë 18. Për këtë qëllim, do të realizohet një sistem rotacioni për të garantuar që të ketë një

<sup>5</sup> Në këtë post është emëruar baronesha Catherine Ashton, ish-Komisionere për Tregtinë

Komisioner nga çdo Shtet Anëtar në dy nga çdo tre mandate të njëpasnjëshme të Komisionit. Megjithatë, Këshillit European iu dha kompetenca që me votim unanim të mund ta ndryshojë këtë përbërje, gjë që ai e bëri në takimin e 18-19 korrikut 2009 në Bruksel. Në këtë takim, Këshilli European ra dakord të marrë një vendim pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, dhe në përputhje me procedurat respektive, u ra dakord që Komisioni të vazhdojë të ketë një shtetas nga secili Shtet Anëtar. Kjo përmbushi një nga kërkesat bazë të vendosura nga Irlanda, kur kjo e fundit organizoi referendumin e dytë për Traktatin e Lisbonës.

### **Përbërja**

Komisioni drejtohet nga një President i ndihmuar nga shtatë zv.Presidentë, përfshi Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit si zv.President i parë i këtij institucioni. Me kalimin e kohës, pozita e Presidentit në Komision është forcuar ndjeshëm. Ai/ajo nuk është më “i pari mes të barabartëve”, por gëzon pozitë të privilegjuar, pasi Komisioni duhet të veprojë “në kuadrin e orientimit politik” të Presidentit të tij (neni 17 i TBE-së). Kështu, Presidenti ka “kompetencën e përcaktimit të orientimit”. Ai vendos për organizimin e brendshëm të Komisionit, me qëllim që të garantojë funksionimin sistematik dhe efektiv të tij. Ai/Ajo gjithashtu ngarkon me përgjegjësi disa komisionerë dhe mund të riorganizojë shpërndarjen e përgjegjësive gjatë mandatit. Presidenti emëron zëvendëspresidentët dhe mund të detyrojë një Anëtar të Komisionit të japë dorëheqjen. Pozita e rëndësishme e Presidentit pasqyrohet edhe nga fakti që ai/ajo është edhe anëtar i Këshillit European.

Presidenti dhe anëtarët e Komisionit emërohen me mandat 5-vjeçar, me këtë procedurë emërimi: Këshilli European, me shumicë të cilësuar, propozon kandidatin për President të Komisionit, i cili votohet më pas nga Parlamenti European me shumicën e votave të anëtarëve të tij. Nëse kandidati nuk merr shumicën e nevojshme në Parlament, Këshilli European, brenda një muaji, i propozon Parlamentit një kandidaturë tjetër. Më pas, Shtetet Anëtare hartojnë një listë të kandidatëve për anëtarë të Komisionit, listë e cila miratohet nga Këshilli me shumicë të cilësuar dhe në marrëveshje me Presidentin. Pasi Presidenti i Komisionit zgjidhet nga Parlamenti European, anëtarët e tjerë të Komisionit i nënshtrohen një votimi për miratim në Parlament. Pas miratimit nga Parlamenti, anëtarët e Komisionit, përveç Presidentit, emërohen zyrtarisht nga Këshilli i BE-së me shumicë të cilësuar.

Anëtarët e Komisionit zgjidhen mbi bazën e “aftësisë së tyre të përgjithshme”, dhe “ushtrojnë funksionet e tyre në pavarësi të plotë” (neni 17, paragrafi 3 i TBE-së). Ata nuk kërkojnë dhe nuk mund të marrin udhëzime nga asnjë qeveri.

Komisioni European e ka selinë në Bruksel.

## Detyrat

Detyrat	
<b>Merr initiative për hartimin e legjislacionit të Bashkimit</b>	<b>Monitoron respektimin dhe zbatimin e duhur të së drejtës së Bashkimit</b>
<b>Administrojnë dhe zbaton legjislacionin e Bashkimit</b>	<b>Përfaqëson BE-në në organizatat ndërkombëtare</b>

Komisioni është mbi të gjitha “motori” i politikës së Bashkimit. Është pikënisja e çdo veprimi të Bashkimit, pasi Komisioni duhet t’i paraqesë Këshillit propozimet dhe projektligjet e Bashkimit (e ashtuquajtura “e drejtë e nismës” e Komisionit). Komisioni nuk gëzon liri të zgjedhë veprimtaritë e veta, pasi është detyruar të veprojë kur e kërkon interesi i Bashkimit. Këshilli, (neni 241 i TBE-së), Parlamenti European (neni 225 i TBE-së) dhe një grup shtetasish të BE-së që veprojnë në emër të një nisme të shtetasve (neni 11, paragrafi 4 i TBE-së), mund t’i kërkojnë Komisionit të hartojë një projekt- ligj. Që nga Traktati i Lisbonës, në raste specifike të përcaktuara nga Traktatet, aktet legjislative mund të miratohen me nismën e një grupi Shtetesh Anëtare ose të Parlamentit European, me rekomandimin e Bankës Qendrore Europiane ose me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë apo Bankës Europiane të Investimeve.

Komisioni ka kompetenca parësore për të propozuar legjislacion në fusha të caktuara (si buxheti i Bashkimit, Fondet Strukturore, masat kundër diskriminimit tatimor, financimi dhe klauzolat mbrojtëse). Edhe më të gjera janë kompetencat për zbatimin e normave të Bashkimit European, të cilat i jepen Komisionit nga Këshilli dhe Parlamenti (neni 290 i TBE-së).

Komisioni është njëkohësisht “garanti i të drejtës së Bashkimit”, sepse monitoron respektimin dhe zbatimin e legjislacionit parësor dhe dytësor të Bashkimit nga ana e Shteteve Anëtare, nis procedimin në rast shkeljeje të së drejtës së Bashkimit (neni 258 i TBE-së) dhe kur është nevoja, ia referon çështjen Gjykatës së Drejtësisë. Gjithashtu, Komisioni ndërhyr kur e drejta e Bashkimit shkelet nga persona fizikë apo juridikë dhe me këtë rast mund të vendosë sanksione të rënda. Lufta kundër shkeljes së normave të Bashkimit është bërë vitet e fundit një nga veprimtaritë kryesore të Komisionit.

Përfaqësimi i interesave të Bashkimit është i lidhur ngushtë me rolin e Komisionit si garant i së drejtës së Bashkimit. Në parim, Komisioni duhet të ndjekë vetëm interesat e Bashkimit. Ai duhet të përpiqet vazhdimisht, edhe pse shpesh rezulton në negociata të vështira brenda Këshillit, që të garantojë mbizotërimin e interesit të Bashkimit dhe të gjejë zgjidhje kompromisi që marrin parasysh këtë interes. Në këtë kontekst, Komisioni luan edhe rolin e ndërmjetësit mes Shteteve Anëtare, rol që i përshtatet dhe për të cilin ka kompetencë të plotë, duke ditur faktin që Komisioni është i paanshëm.

Së fundi, Komisioni, edhe pse në masë të kufizuar, është organ ekzekutiv. Këtë funksion e kryen sidomos në fushën e së drejtës së konkurrencës, ku vepron si autoritet administrativ klasik: shqyrton faktet, jep autorizimin ose formulon ndalime, dhe nëse është nevoja, vendos edhe sanksione. Po kaq të gjera janë kompetencat e Komisionit edhe në fushën e Fondeve Strukturore dhe Buxhetit të BE-së. Megjithatë, si rregull, u takon vetë Shteteve Anëtare që të garantojnë se normat e Bashkimit European zbatohen në çdo rast të veçante. Ky modalitet i zgjedhur nga Traktatet e Bashkimit ka një përparësi: afron shtetasit me realitetin juridik European, që për ta është përgjithësisht “i panjohur”, duke i vënë përballë autoriteteve dhe aspekteve të rendit juridik të brendshëm që për shtetasit janë të njohura.

Komisioni përfaqëson Bashkimin në organizata ndërkombëtare dhe garanton veprimtarinë e përditshme të misioneve diplomatike të Bashkimit brenda dhe jashtë BE-së. Mbi bazën e të drejtave që ia ka deleguar Këshilli, Komisioni është përgjegjës për të negociuar marrëveshjet me organizatat ndërkombëtare dhe vendet jo anëtare, përfshi Traktatet e Anëtarësimit me Shtetet e reja Anëtare. Komisioni përfaqëson Bashkimin në gjykatat e Shteteve Anëtare, dhe kur është e nevojshme, bashkë me Këshillin, përfaqëson Bashkimin përpara Gjykatës së Drejtësisë.

## STRUKTURA ADMINISTRATIVE E KOMISIONIT EUROPIAN

Komisioni  
(27 anëtarë)  
(Kabinetet)  
Sekretari i Përgjithshëm  
Shërbimi Juridik  
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikimin  
Byroja e Këshilltarëve të Politikës Europiane

Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Ekonomike dhe Financiare

Drejtoria e Përgjithshme për Ndërmarrjet dhe Industrinë

Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën

Drejtoria e Përgjithshme për Punësimin, Çështjet Sociale dhe Mundësitë e Barabarta

Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural

Drejtoria e Përgjithshme për Energjinë

Drejtoria e Përgjithshme për Lëvizshmërinë dhe Transportin

Drejtoria e Përgjithshme për Mjedisin

Drejtoria e Përgjithshme për Veprimet e Klimës

Drejtoria e Përgjithshme për Kërkimin Shkencor

Qendra e Përbashkët Kërkimore

Drejtoria e Përgjithshme për Shoqërinë e Informacionit dhe Median

Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Detare dhe Peshkimin

Drejtoria e Përgjithshme për Tregun e Brendshëm dhe Shërbimet

Drejtoria e Përgjithshme për Shoqërinë e Informacionit dhe Median

Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Detare dhe Peshkimin

Drejtoria e Përgjithshme për Tregun e Brendshëm dhe Shërbimet

Drejtoria e Përgjithshme për Politikën Rajonale

Drejtoria e Përgjithshme për Tatimet dhe Bashkimin Doganor

Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin dhe Kulturën

Drejtoria e Përgjithshme për Shëndetin dhe Konsumatorët

Drejtoria e Përgjithshme për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë

Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Jashtë

Drejtoria e Përgjithshme për Tregtinë

<b>Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin</b>
<b>Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin</b>
<b>Zyra e Bashkëpunimit për Ndhimën e Europës</b>
<b>Drejtoria e Përgjithshme për Ndhimën Humanitare (ECHO)</b>
<b>Eurostat</b>
<b>Drejtoria e Përgjithshme për Burimet Njerëzore dhe Sigurimin</b>
<b>Drejtoria e Përgjithshme për Informatikën</b>
<b>Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin</b>
<b>Zyra e Auditit të Brendshëm</b>
<b>Zyra Evropiane Anti-Mashtrim</b>
<b>Drejtoria e Përgjithshme për Përkthimin me Gojë</b>
<b>Drejtoria e Përgjithshme për Përkthimin me Shkrim</b>
<b>Zyra e Publikimeve</b>
<b>Zyra për Infrastrukturën dhe Logjistikën në Bruksel</b>
<b>Zyra për Infrastrukturën dhe Logjistikën në Luksemburg</b>
<b>Zyra për Administrimin dhe Pagimin e Shpërblimeve Individuale</b>
<b>Zyra Evropiane e Përzgjedhjes së Personelit</b>

### ***Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European (Neni 19 TBE)***

Çdo sistem ka vazhdimësi vetëm nëse rregullat e tij mbikëqyren nga një autoritet i pavarur. Për më tepër, në një bashkim shtetesh, rregullat e përbashkëta- nëse i nënshtrohen kontrollit nga gjykatat kombëtare- interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të ndryshme nga një shtet në tjetrin. Po të veprohej në këtë mënyrë, do të rrezikohej zbatimi uniform i të drejtës së Bashkimit në të gjitha Shtetet Anëtare. Këto konsiderata çuan në krijimin në vitin 1952 të Gjykatës Komunitare të Drejtësisë, menjëherë pas krijimit të Komunitetit të parë (KEQC). Më 1957, kjo Gjykatë u bë gjithashtu organ gjyqësor për dy Komunitetet e tjera, (K(E)E dhe Euroatom). Sot Gjykata Evropiane e Drejtësisë është organi gjyqësor i BE-së.

Veprimtaria gjyqësore tani realizohet në tre nivele nga:

- Gjykata e Drejtësisë si shkalla më e lartë në rendin juridik të Komunitetit (Neni 253 TFBE)
- Gjykata e Përgjithshme (Neni 254 TFBE);
- Gjykatat e specializuara, që mund të caktohen në Gjykatën e Përgjithshme për të vendosur për çështje në fusha të veçanta (neni 257 TFBE).



1 nëntor 1992.

Fotoja e kësaj valixheje mbi hartën e Europës, ilustron lëvizjen e lirë  
Fotoja e kësaj valixheje mbi hartën e Europës, ilustron lëvizjen e lirë



## Gjykata e Drejtësisë

<b>PËRBËRJA E GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EUROPIAN</b>	
<b>27 gjyqtarë dhe 8 Avokatë të Përgjithshëm</b>	
<b>Llojet e çështjeve</b>	
<b>Padi për mospërmbushje të detyrimeve sipas Traktateve: Shtet Anëtar kundër Shtetit Anëtar Shtet Anëtar kundër Shtetit Anëtar (Neni 259 TFBE)</b>	<b>Padi për anulim dhe padi për arsye të mosveprimit të ngritura nga një institucion i Bashkimit ose prej një Shteti Anëtar në lidhje me një veprim të paligjshëm ose mosveprim (Nenet 263 dhe 265 TFBE)</b>
<b>Çështjet e referuara nga gjykatat kombëtare për vendime paragjykimore për të qartësuar interpretimin dhe vlefshmërinë e së Drejtës së Bashkimit (Neni 267 TFBE)</b>	<b>Apelime kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme (Neni 256 TFBE)</b>

Gjykata e Drejtësisë aktualisht përbëhet nga 27 gjyqtarë dhe tetë Avokatë të Përgjithshëm që janë emëruar me ‘marrëveshje të përbashkët të Qeverive të Shteteve Anëtare’ për një mandat gjashtëvjeçar. Çdo Shtet Anëtar dërgon një gjyqtar. Për të siguruar vijimësi, zëvendësimi i pjesshëm i gjysmës së gjyqtarëve dhe Avokatëve të Përgjithshëm, bëhet çdo tre vjet, në fillim të vitit gjyqësor, që është 6 tetori. Gjyqtaret mund të rizgjidhen.

Gjykata ndihmohet nga tetë Avokatë të Përgjithshëm, mandati në detyrë i të cilëve përputhet me atë të gjyqtarëve; ata gëzojnë pavarësi gjyqësore. Katër nga tetë Avokatët e Përgjithshëm janë gjithnjë nga Shtetet Anëtare ‘të mëdha’ (Gjermani, Francë, Itali dhe Mbretëri e Bashkuar) dhe katër të tjerët nga pjesa tjetër e 23

Shteteve Anëtare, por me rotacion. Funkzioni i Avokatit të Përgjithshëm bazohet në funksionin e Komisarit të Qeverisë (Commissaire du gouvernement) në Këshillin e Shtetit (Conseil d'État) dhe gjykatat administrative në Francë. Ai nuk duhet ngatërruar me pozicionin e prokurorit ose me ndonjë funksion të ngjashëm që ekziston në shumë vende. Avokatët e Përgjithshëm u futën në Gjykatë për të vendosur në ekuilibër natyrën fillestare 'me një nivel' të procedimeve gjyqësore, pra për shkak të mungesës së procedurave të apelit. Detyra e tyre është të paraqesin 'opinionet' në Gjykatë në formën e propozimeve (jo të detyrueshme) për një vendim Gjykate bazuar në një studim tërësisht të pavarur dhe jopartiak të çështjeve të së drejtës të ngritura për rastin në gjykim. Opinionet janë pjesë e pandarë e procedurës me gojë dhe botohen në Raportet e Gjykatës, së bashku me vendimin. Avokatët e Përgjithshëm vetëm mund të ndikojnë në vendimi nëpërmjet forcës së argumenteve në opinionet e tyre; ata nuk përfshihen në diskutime ose votimin për vendimin.

### *Përzgjedhja e gjyqtarëve dhe Avokatëve të Përgjithshëm*

Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë zgjidhen mes personave që vlerësohen për pavarësinë dhe të cilët përmbushin kushtet e nevojshme për të mbajtur postet më të larta gjyqësore në vendet e tyre përkatëse ose të cilët janë juristë me kualifikim të njohur. (Neni 253 TFBE). Kjo do të thotë që mund të emërohen gjyqtarët, zyrtarët, politikanët, avokatët ose lektorët e universiteteve të Shteteve Anëtare. Larmia e formimit profesional dhe përvojës, krijojnë përparësi për Gjykatën, sepse ata ndihmojnë për të siguruar një vlerësim sa më të plotë të mundshëm të aspekteve si teorike, ashtu dhe praktike të fakteve dhe çështjeve të së drejtës që duhet të merren në shqyrtim. Në të gjitha Shtetet Anëtare, zgjedhja e atyre që duhet të propozohen nga qeveria për t'u emëruar si gjyqtarë apo Avokat të Përgjithshëm dhe procedura për këtë përzgjedhje, është çështje që i takon ekzekutivit. Procedurat ndryshojnë shumë dhe variojnë nga procedura jo shumë transparente në procedura krejtësisht të ndërlukuara.

Për të dhënë mendimin e tij në lidhje me përshtatshmërinë e kandidatëve për kryerjen e detyrave të Gjyqarit dhe Avokatit të Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme krijohet një panel, përpara se qeveritë e Shteteve Anëtare të bëjnë emërimet (Neni 255 TFBE). Paneli përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur mes ish-anëtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, anëtarëve të gjykatave të larta kombëtare dhe juristëve që njihen për kualifikimin e duhur, njërin prej të cilëve e propozon Parlamenti Europian.

### *Procedura*

Gjykata mbliidhet në këto formacione të mundshme si më poshtë:

- Seanca plenare me 27 gjyqtarë; vendimi i seancës plenare kërkohet vetëm në çështje fajësimi dhe procedime disiplinore kundër anëtarëve të organeve të Bashkimit. Çështjet mund t'i referohen gjithashtu seancës plenare nga vetë Gjykata e Drejtësisë, por vetëm kur bëhet fjalë për procedime tepër të rëndësishme apo për çështje që kërkojnë vlerësimin e precedentëve të mëparshëm;
- Dhoma e Madhe Gjyqësore me 13 gjyqtarë;
- Dhomat me pesë dhe tre gjyqtarë.

### *Detyrat*

Gjykata e Drejtësisë është autoriteti më i lartë dhe njëkohësisht i vetëm në çështje të së drejtës së Bashkimit. Në terma të përgjithshëm, detyra e saj është 'të sigurojë respektimin e ligjit në interpretimin e Traktatit'.

Ky përsëkrim i përgjithshëm i përgjegjësisë përfshin tri fusha kryesore:

- monitorimi i zbatimit të së drejtës së Bashkimit, si nga institucionet e BE-së kur zbatojnë Traktatet, ashtu dhe nga Shtetet Anëtare dhe individët në lidhje me detyrimet e tyre sipas së drejtës së Bashkimit;
- interpretimi i të drejtës së Bashkimit;
- unifikimi i mëtejshëm i të drejtës së Bashkimit.

Në kryerjen e këtyre detyrave, puna e Gjykatës përfshin si këshillimin ligjor, ashtu dhe gjykimin. Këshillim ligjor sigurohet në formën e opinioneve të detyrueshme për marrëveshjet që BE dëshiron të lidhë me vendet jo anëtare ose organizatat ndërkombëtare. Megjithatë, funksionimi i saj si një organ për administrimin e drejtësisë, është më i rëndësishmi. Në ushtrimin e këtij funksioni, Gjykata trajton çështje që në Shtetet Anëtare do t'u caktoheshin llojeve të ndryshme të gjykatave, në varësi të sistemeve të tyre kombëtare. Gjykata vepron si gjykatë kushtetuese kur ajo duhet të zgjidhë mosmarrëveshjet ndërmjet institucioneve të Bashkimit ose kur kontrollon ligjshmërinë e akteve ligjore të Bashkimit; si gjykatë administrative kur shqyrton akte administrative të Komisionit ose të autoriteteve kombëtare që zbatojnë legjislacionin e Bashkimit; si gjykatë për çështjet e punës ose si tribunal për çështje industriale, kur trajton lirinë e lëvizjes, sigurimet shoqërore dhe mundësitë e barabarta; si

gjykatë për çështje fiskale kur trajton çështje në lidhje me vlefshmërinë dhe interpretimin e direktivave në fushën e taksave dhe legjislacionin doganor; si gjykatë penale kur shqyrton vendime të Komisionit për vendosjen e gjobave; dhe si gjykatë civile kur shqyrton padi për dëmshpërblim ose interpretim të dispozitave për zbatimin e vendimeve në çështje civile dhe tregtare dhe në debate për të drejtat e pronësisë intelektuale europiane, për të cilat janë dhënë kriteret e kompetencave nga ana e Gjykatës së Drejtësisë (Neni 262 TFBE).

## Gjykata e Përgjithshme

Ashtu si të gjitha gjykatat, Gjykata e Drejtësisë është e mbingarkuar. Numri i çështjeve që i drejtohen asaj është rritur ndjeshëm dhe do të vazhdojë të rritet nisur nga mundësia e kundërshtive që është krijuar nga numri i madh i direktivave që janë miratuar në kontekstin e tregut të vetëm dhe që janë transpozuar në të drejtë kombëtare të Shteteve Anëtare. Ka tashmë sinjale që Traktati për Bashkimin Europian ka krijuar probleme, të cilat në fund të fundit duhet të zgjidhen nga Gjykata. Kjo është arsyeja pse në 1988 u krijua një Gjykatë e Përgjithshme për të lehtësuar ngarkesën e Gjykatës së Drejtësisë.

### PËRBËRJA E GJYKATËS SË PËRGJITHSHME

27 gjyqtarë  
të emëruar nga Qeveritë e Shteteve Anëtare  
me marrëveshje të përbashkët  
për një mandat gjashtëvjeçar

#### Llojet e çështjeve

Padi për anulim dhe ankesa për mosveprim nga persona fizikë dhe juridikë për arsye të paligjshmërisë ose mungesës së akteve ligjore të Bashkimit (Nenet 263 dhe 265 TFBE)

Padi për dëmshpërblim për arsye të përgjegjësisë kontraktuale ose jokontraktuale (Nenet 268 dhe 340 (1) dhe (2) TFBE)

Apelime kundër vendimeve që jepen nga panelet gjyqësore (Neni 256(2) TFBE)

Gjykata e Përgjithshme nuk është një institucion i ri i Bashkimit, por një element përbërës i Gjykatës së Drejtësisë. Pavarësisht nga ky fakt, është organ autonom i veçuar nga Gjykata e Drejtësisë, për sa i përket organizimit. Ajo ka regjistrin dhe rregulloren e saj të brendshme. Çështjet e trajtuara nga Gjykata e Drejtësisë identifikohen me anë të gremës ‘T’ (=Tribunal) (p.sh. T-1/99), ndërsa çështjet që i drejtohen Gjykatës së Drejtësisë kodohen me gremën ‘C’ (=Court (Gjykatë) p.sh. C-1/99).

Gjykata e Përgjithshme përbëhet nga 27 ‘anëtarë’, kualifikimi, emërimi dhe statusi ligjor i të cilëve u nënshtrohet të njëjtave kërkesa dhe kushte si ato për gjyqtarët në Gjykatën e Drejtësisë. Edhe pse funksioni i tyre kryesor është të veprojnë si ‘gjyqtarë’, ata mund të emërohen gjithashtu si ‘Avokatë të Përgjithshëm’, në raste ad hoc për çështje përpara seancës plenare, ose për çështje që do të shtrohen përpara njëjës prej Dhomave, nëse këtë e diktojnë faktet e çështjes ose ndërlikimet e saj ligjore. Kjo mundësi deri tani është përdorur shumë rrallë.

Gjykata e Përgjithshme mbledhet në Dhoma të përbëra nga pesë ose tre gjyqtarë, ose në disa çështje, nga një gjyqtar i vetëm. Mund të mbledhet gjithashtu si një Dhoma e Madhe Gjyqësore (13 gjyqtarë) ose si një seancë plenare (27 gjyqtarë) në varësi të rëndësisë së çështjes apo kompleksitetit ligjor që ajo mbart. Mbi 80% e çështjeve përpara Gjykatës gjykohen nga Dhoma me tre gjyqtarë.

Edhe pse Gjykata e Përgjithshme fillimisht ishte përgjegjëse vetëm për një gamë të kufizuar çështjesh, tani ka detyrat e mëposhtme:

- Në shkallë të parë, pra sipas mbikëqyrjes ligjore të Gjykatës së Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme ka kompetencë të vendosë për padi për anulim dhe padi për mosveprim, të ngritura nga persona fizikë dhe juridikë kundër një organi të Bashkimit; për një klauzolë arbitrazhi që parashikohet në një kontratë të përfunduar nga BE ose në emër të saj dhe për padi dëmshpërblimi të ngritura kundër BE-së.
- Gjykata e Përgjithshme vepron si gjykatë apeli për çështjet e gjykuara nga trupat gjyqësore.
- Në raste të caktara është parashikuar gjithashtu mundësia e delegimit të juridiksionit në Gjykatën e Përgjithshme kur kërkohet që ajo të shprehet me titull paragjykimor; megjithatë, ende kjo mundësi nuk është arritur të shfrytëzohet.

## Gjykatat e specializuara

Në 2004, për të lehtësuar ngarkesën e Gjykatës së Drejtësisë dhe për të ndihmuar mbrojtjen ligjore në BE, Këshilli i BE-së krijoi në Gjykatën e Përgjithshme një gjykatë të specializuar për çështje të shërbimit civil.

Kjo gjykatë e specializuar ka marrë përsipër kompetenca nga Gjykata e Përgjithshme për gjykimin e çështjeve në shkallë të parë mbi mosmarrëveshjet në shërbimin civil evropian.

Gjykata përbëhet nga shtatë gjyqtarë që gëzojnë status të njëjtë me anëtarët e Gjykatës së Përgjithshme dhe që emërohen për një mandat gjashtëvjeçar. Ata duhet të kenë aftësinë e nevojshme për t'u emëruar në këtë detyrë. Gjykata e specializuar zakonisht mbledhet si trupë gjyqësore me tre gjyqtarë, por mund të vendosë edhe si trupë e plotë ose si trupe gjyqësore edhe me pesë gjyqtarë ose me një gjyqtar të vetëm. Vendimet e gjykatës së specializuar mund të ankimohen në Gjykatën e Përgjithshme vetëm për çështje të interpretimit të ligjit. Nga ana e tij, Avokati i Parë i Përgjithshëm (dhe jo palët në konflikt) mund të propozojë rishikimin e vendimit të dhënë nga Gjykata e Përgjithshme, nëse vihen në rrezik vetëvetë subjekti juridik ose qëndrueshmëria e jurisprudencës.

## *Banka Qendrore Europiane (Nenet 129 dhe 130 TFBE)*

Banka Qendrore Europiane (BQE) me seli në Frankfurt mbi Main është motorri i bashkimit ekonomik dhe monetar. Detyra e saj është të ruajë stabilitetin e monedhës europiane, Euros, dhe të kontrollojë sasinë e monedhës në qarkullim (Neni 128 TFBE).

Për të kryer këtë detyrë, pavarësia e BQE garantohet nga disa dispozita ligjore. Në ushtrimin e kompetencave ose kryerjen e detyrave dhe detyrimeve të tyre, as BQE as ndonjë bankë qendrore kombëtare nuk mund të marrë udhëzime nga institucione të Bashkimit, qeveritë e Shteteve Anëtare apo ndonjë organ tjetër. Institucionet e BE-së dhe qeveritë e Shteteve Anëtare nuk mund të ndikojnë tek BQE (Neni 130 TFBE).

BQE ka një Këshill Drejtues dhe Bord Ekzekutiv. Këshilli Drejtues përfshin guvernatorët e bankave qendrore të 16 Shteteve Anëtare në zonën euro dhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv të BQE-së. Bordi Ekzekutiv që përbëhet nga Presidenti, Zëvendës-presidenti dhe katër anëtarë të tjerë, është përgjegjës për funksionimin e BQE. Presidenti i saj dhe anëtarët emërohen mes

përsonave me pozitë të shquar dhe përvojë në çështje monetare ose bankare, me marrëveshje të përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare, bazuar në rekomandimin e Këshillit, pas konsultimit të tij me Parlamentin Europian. Mandati i tyre në detyrë është tetë vjet që, në interes të sigurimit të pavarësisë së anëtarëve të Bordit Ekzekutiv, është i papërsëritshëm (Neni 283 TFBE).

Sistemi Europian i Bankave Qendrore (SEBQ) përbëhet nga BQE dhe bankat qendrore të Shteteve Anëtare (Neni 129 TFBE)). Ai ka për detyrë përcaktimin dhe zbatimin e politikave monetare të Bashkimit dhe ka të drejtë ekskluzive për të autorizuar emetimin e kartëmonedhave dhe monedhave brenda Bashkimit. Ai administron gjithashtu rezervat në monedhë të huaj të Shteteve Anëtare dhe siguron funksionimin sa më normal të sistemit të pagesave (Neni 127(2) TFBE).

### ***Gjykata e Audituesve (Nenet 285 dhe 286 TFBE)***

Gjykata e Audituesve u krijua në 22 korrik 1975 dhe filloi punën në Luksemburg në tetor 1977. Që nga ajo kohë konsiderohet si institucion i Bashkimit (neni 13 TBE). Përbëhet nga 27 anëtarë, që i korrespondojnë numrit të Shteteve Anëtare. Ata emërohen për gjashtë vjet nga Këshilli që miraton, me shumicë të cilësuar dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian, një listë të anëtarëve, të hartuar në përputhje me propozimet e Shteteve Anëtare (neni 286(2) TFBE). Anëtarët zgjedhin Kryetarin e Gjykatës së Audituesve nga radhët e tyre, për një mandat trevjeçar; Kryetari mund të rizgjidhet.

Detyra e Gjykatës së Audituesve është të kontrollojë ligjshmërinë e të ardhurave dhe shpenzimeve të BE-së si edhe menaxhimin e burimeve financiare. Në ndryshim nga gjykatat e audituesve o mekanizmat ngjashëm në disa Shtete Anëtare, ajo nuk ka kompetencë të imponojë zbatimin e masave të saj të kontrollit apo të hetojë dyshimet parregullive që mund të konstatojë gjatë veprimtarisë së saj. Megjithatë, ajo është tërësisht autonome në vendimet që merr lidhur me problemet qëshqyrton. Për shembull, kjo Gjykatë mund të shqyrtojë nëse përdorimi i mbështetjes financiare të Bashkimit nga individë privatë është në përputhje me të drejtën Komunitare.

Arma kryesore që kjo Gjykatë është mundësia për të bërë publike konstatimet e saj. Rezultatet e hetimeve të saj përmbledhen në një raport vjetor në fund të çdo viti financiar, të cilat botohen në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian dhe kështu sillen në vëmendje të publikut. Gjithashtu, në çdo kohë, ajo mund të bëjë raporte të veçanta për fusha specifike të menaxhimit financiar, të cilat mund të botohen gjithashtu në Fletoren Zyrtare.

## MEKANIZMA KËSHILLIMOR

### *Komiteti European Ekonomik dhe Social (Neni 301 TFBE)*

Qëllimi i Komitetit European Ekonomik dhe Social (KEES) është të përfaqësojë në një mekanizëm të BE-së grupet e ndryshme ekonomike dhe sociale (sidomos punëdhënësit dhe punëmarrësit, fermerët, transportuesit, tregtarët, artizanët, profesionet dhe drejtuesit e bizneseve të vogla dhe të mesme). Ofron gjithashtu një forum për konsumatorët, grupet mjedisore dhe shoqatat.

KEES përbëhet nga e shumta 350 anëtarë (këshilltarë), që përbëhet nga organizatat më përfaqësuese në secilin nga Shtetet Anëtare. Ata emërohen për pesë vjet nga Këshilli, i cili me unanimitet miraton një listë të anëtarëve, e hartuar sipas propozimeve të bëra nga çdo Shtet Anëtar.

Caktimi i vendeve është si më poshtë.<sup>6</sup>

<b>GERMANIA</b>	24
<b>FRANCA</b>	24
<b>ITALIA</b>	24
<b>MBRETËRIA E BASHKUAR</b>	24
<b>SPANJA</b>	21
<b>POLONIA</b>	21
<b>RUMANIA</b>	15
<b>BELGJIKA</b>	12
<b>BULLGARIA</b>	12
<b>REPUBLIKA ÇEKE</b>	12
<b>GREQIA</b>	12
<b>HUNGARIA</b>	12
<b>HOLANDA</b>	12
<b>AUSTRIA</b>	12
<b>PORTUGALIA</b>	12
<b>SUEDIA</b>	12
<b>DANIMARKA</b>	9
<b>IRLANDA</b>	9

<sup>6</sup> Burimi: faqja e internetit të Komitetit European Social Ekonomik, 344 anëtarë në mars 2010.



LITUANIA	9
SLLOVAKIA	9
FINLANDA	9
ESTONIA	7
LETONIA	7
SLLOVENIA	7
QIPROJA	6
LUKSEMBURGU	6
MALTA	5

Anëtarët ndahen në tre grupe (punëdhënës, punëmarrës dhe përfaqësues të palëve të tjera të shoqërisë civile). Opinionet që duhen miratuar në seanca plenare hartohen nga ‘grupe studimi’, që përbëhen nga anëtarët e KEES (në të cilat zëvendësit e tyre mund të marrin pjesë në cilësinë e ekspertit). KEES punon gjithashtu ngushtësisht me komisionet e Parlamentit Europian.

Këshilli, me propozim të Komisionit, duhet që në rrethana të caktuara të marrëvendimin e KEES, i cili është krijuar me Traktatet e Romës. KEES mund të japë mendime edhe me nismë të tij. Këto mendime shpesh përfaqësojnë një sintezë të pikëpamjeve krejt të ndryshme, të cilat janë shumë të dobishme për Komisionin dhe Këshillin, sepse përmes tyre evidentohet se cilat janë ndryshimet që do të donin të shikonin grupet e ndryshme të prekura në menyrë të drejtpërdrejt nga propozimi konkret. Mendimet që jep me nismë të vet, në mjaft kanë implikime politike të konsiderueshme. I tillë është për shembull mendimi i KEES i shfaqur më 22 shkurt 1989 për të drejtat sociale themelore në BE, mbi bazën e të cilit u hodhën themelet e ‘Kartës Sociale’ që u propozua më pas nga Komisioni (dhe u miratua nga 11 Shtete Anëtare).

### ***Komiteti i Rajoneve (Neni 305 TFBE)***

Përveç KEES, një mekanizëm i ri këshillimor u krijua me Traktatin e Bashkimit Europian (Traktati i Mastrohrit): Komiteti i Rajoneve (KiR). Ashtu si KEES, edhe KiR nuk është një institucion i mirëfilltë i BE-së, pasi funksioni i tij është krejtësisht këshillimor dhe nuk ka kompetencë të nxjerrë vendime të detyrueshme, si institucionet e BE-së (Parlamenti Europian, Këshilli, Komisioni Europian, Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Audituesve, Banka Qendrore Europiane).

Ashtu si KEES, Komiteti i Rajoneve përbëhet nga e shumta 350 anëtarë.<sup>7</sup> Anëtarët janë përfaqësues të autoriteteve rajonale dhe vendore në Shtetet Anëtare, të cilët duhet të kenë mandat bazuar në zgjedhjet nga autoritetet që përfaqësojnë, ose që politikisht duhet të japin llogari përpara tyre. 350 vendet janë caktuar për Shtetet Anëtare duke përdorur të njëjtën shpërndarje si për KEES. Anëtarët emërohen për pesë vjet nga Këshilli, i cili njëzëri miraton listën e anëtarëve, të hartuar në përputhje me propozimet e bëra nga çdo Shtet Anëtar. Anëtarët e Komitetit zgjedhin një kryetar mes radhëve të tyre, për një mandat dyvjeçar.

Ka një sërë fushash për të cilat i kërkohet Këshillit të BE-së ose Komisionit Europian që të marrë mendimin e KiR ('konsultim i detyrueshëm'). Këto fusha janë: arsimi; kultura; shëndeti publik; rrjetet trans-europiane; transporti; telekomunikacioni dhe infrastruktura e energjise; kohezioni ekonomik dhe social; politika e punësimit dhe legjislacioni social. Këshilli gjithashtu merr rregullisht mendimin e Komitetit të Rajoneve edhe pa patur ndonjë detyrim ligjor, kur shqyrton një game të gjerë projektligjesh ('konsultimi jo i detyrueshëm').

## **BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE (NENI 308 TFBE)**

Bashkimi si agjenci financimi për 'një zhvillim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm' të BE-së ka në dispozicion Bankën Europiane të Investimeve (BEI) me seli në Luksemburg. BEI ofron kredi dhe garanci në të gjithë sektorët ekonomikë, sidomos për nxitjen e zhvillimit në rajone më pak të zhvilluara, për të modernizuar ose shndërruar sipërmarrjet, ose për të krijuar vende të reja pune dhe për të ndihmuar projektet me interes të përbashkët për disa Shtete Anëtare.

BEI ka një strukturë tripalëshe: kryesohet nga Bordi i Guvernatorëve, i përbërë nga ministrat e Financës të Shteteve Anëtare, i cili përcakton orientimet për politikat e kreditimit dhe autorizon veprimtaritë e BEI-së jashtë BE-së. Përveç Bordit të Guvernatorëve, është edhe Bordi i Drejtorëve, i cili ka në varësi 28 anëtarë me kohë të plotë (një përfaqësues nga çdo Shtet Anëtar dhe një nga Komisioni Europian) dhe 18 anëtarë zëvendësues. Anëtarët zakonisht janë zyrtarë të lartë të ministrive të financave ose çështjeve ekonomike në vendet e tyre. Bordi i Drejtorëve merr vendime për dhënie e kredive dhe garancive si dhe lidhur me rritjen e kredive. Ai siguron funksionimin e bankës në përputhje me udhëzimet e Bordit të Guvernatorëve. Veprimtaritë e përditshme të BEI-së drejtohen nga Komiteti i Menaxhimit, një mekanizëm ekzekutiv i përbërë nga nëntë persona, të emëruar për një periudhë gjashtëvjeçare.

<sup>7</sup> *Burimi: faqja e internetit të Komitetit të Rajoneve; 344 anëtarë në mars 2010.*

## Rendi juridik i BE-së

Kushtetuta e BE-së e përshkruar më lart dhe veçanërisht vlerat themelore që mishëron, mund të vihen në jetë dhe të përforcohen më tej vetëm përmes së Drejtës së Bashkimit. Për këtë arsye, BE-ja është realitet juridik në dy kuptime të ndryshme: është krijim i së Drejtës dhe komunitet i bazuar në të Drejtën.

### **BE-JA SI KRIJIM I SË DREJTËS DHE KOMUNITET QË BAZOHET TEK E DREJTA**

Kjo është risia kryesore e BE-së dhe çka e dallon atë prej përpjekjeve të mëparshme për të unifikuar Europën, pasi ajo funksionon jo bazuar në detyrimin apo shtrëngimin, por thjesht përmes forcës së ligjit. E Drejta duhet të krijojë atë që “gjaku i derdhur dhe armët” nuk arritën ta realizojnë në shekuj. Vetëm uniteti me vullnet të lirë mund të ketë jetëgjatësi, për sa kohë që bazohet në vlerat themelore, si liria e barazia, dhe nëse garantohet e realizohet nga e Drejta. Pikërisht mbi këtë koncept bazohen edhe traktatet që krijuan Bashkimin European.

BE-ja nuk është thjesht krijim i së Drejtës, por i ndjek objektivat e saj vetëm përmes të Drejtës. Pra, është një komunitet i bazuar tek e Drejta. Jetën ekonomike dhe sociale të popujve të Shteteve Anëtare nuk e disiplinon kërcënimi i forcës, por e Drejta e Bashkimit. Kjo e Drejtë është baza e sistemit institucional, ajo përcakton procedurat e vendimmarrjes të institucioneve të Bashkimit dhe rregullon marrëdhëniet mes tyre. E Drejta u jep këtyre institucioneve mjetet – të tipit rregullore, direktiva e vendime – për të miratuar instrumente ligjore, të cilat janë të detyrueshme për Shtetet Anëtare dhe shtetasit e tyre. Për rrjedhojë, vetë individët bëhen fokusi kryesor i Bashkimit, rendi juridik i të cilit ndikon gjithnjë e më drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme. Ky rend juridik jep të drejta dhe u vendos detyrime në mënyrë që si shtetasit e Shtetit Anëtar, por edhe të Bashkimit, t’i nënshtrohen një hierarkie rendesh juridike, siç ndodh edhe në sistemet kushtetuese federale. Si çdo rend juridik, edhe rendi juridik i BE-së përbën një sistem të pavarur të mbrojtjes juridike, i cili shërben për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe për zbatimin e të Drejtës së Bashkimit. Gjithashtu, e Drejta e Bashkimit përcakton marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shteteve Anëtare. Këta të fundit duhet të miratojnë të gjitha masat e duhura për të garantuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet

apo nga veprimet e institucioneve të Bashkimit. Detyra e tyre është të lehtësojnë funksionimin e BE-së dhe të shmangin çfarëdo veprimi që mund të vërë në rrezik arritjen e objektivave të Traktateve. Shtetet Anëtare mbajnë përgjegjësi për çdo dëm që shtetasit e BE-së mund të pësojnë nga shkëlja e së Drejtës së Bashkimit.

## BURIMET E SË DREJTËS SË BASHKIMIT EUROPIAN

Termi “burim i së drejtës” ka dy kuptime: në kuptimin e parë, i referohet arsyes për nxjerrjen e një dispozite ligjore, domethënë motivit që qëndron pas krijimit të një norme juridike. Sipas këtij përkufizimi, “burim i së drejtës” i së Drejtës së Bashkimit është vullneti për të ruajtur paqen dhe për të krijuar një Europë më të mirë, duke forcuar lidhjet ekonomike; këto janë dy gurët e themelit të KE-së. Në terminologjinë juridike, termi “burim i së drejtës” i referohet origjinës dhe mishërimit të vetë së Drejtës.

### BURIMET E SË DREJTËS SË BASHKIMIT

#### 1. LEGJISLACIONI PARËSOR

Traktatet e Bashkimit — Parimet e përgjithshme të së Drejtës

#### 2. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TË BE-së

#### 3. LEGJISLACIONI DYTËSOR

##### Aktet Legjislative

Rregulloret — Direktivat — Vendimet

##### Aktet jolegjislative

Aktet e deleguara — Aktet zbatuese

##### Akte të tjera

Rekomandime dhe opinione — marrëveshje ndërinstitucionale  
Rezoluta, deklarata dhe programe veprimi

#### 4. PARIMET E PËRGJITHSHME TË SË DREJTËS

#### 5. KONVENTAT NDËRMJET SHTETEVE ANËTARE

Vendimet e Coreper-it — Marrëveshjet ndërkombëtare

## **TRAKTATET THEMELUESE TË BE-së SI BURIM PARËSOR I SË DREJTËS SË BASHKIMIT**

Në këtë kuptim, si burim primar i së Drejtës së Bashkimit janë Traktatet themeluese të BE-së, përfshirë anekset, shtojcat e protokollet e tyre, si edhe shtesat dhe ndryshimet e mëvonshme. Këto Traktate themeluese, bashkë me instrumentet që kanë realizuar shtesat dhe i kanë ndryshuar ato (kryesisht Traktatet e Matrihtit, Amsterdimit, Nisës dhe Lisbonës) dhe Traktatet e ndryshme të Anëtarësimit, përmbajnë dispozitat bazë në lidhje me objektivat, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të BE-së, si edhe pjesë të së Drejtës ekonomike të BE-së. Kështu, Traktatet përbëjnë kuadrin juridik kushtetues për ekzistencën e BE-së, i cili plotësohet më pas, në interes të Bashkimit, përmes masave të tij legislative dhe administrative. Traktatet janë instrumente juridike të krijuara drejtpërdrejt nga Shtetet Anëtare dhe njihen në qarqet juridike si e Drejta parësore e Bashkimit.

## **INSTRUMENTET JURIDIKE TË BE-së SI BURIM DYTËSOR I SË DREJTËS SË BASHKIMIT**

Legjislacioni dytësor, burimi i dytë më i rëndësishëm i së Drejtës së BE-së, quhet e Drejta e krijuar përmes vendimmarrjes së institucioneve të BE-së, në përmbushje të kompetencave që u janë dhënë nga Traktatet.

Legjislacioni dytësor përbëhet nga aktet legislative, aktet e deleguara, aktet zbatuese dhe aktet e tjera ligjore. “Aktet legislative” janë akte juridike të miratuara me procedurë të zakonshme ose të posaçme legislative (neni 289 i TFBE-së). “Aktet e deleguara” janë akte jolegislative me zbatim të përgjithshëm dhe të detyrueshëm, për të plotësuar ose ndryshuar disa elemente jothelbësore të akteve legislative. Ato miratohen nga Komisioni; akti legjislativ duhet të përcaktojë shprehimisht delegimin e kompetencave të Komisioni. Objektivat, përmbajtja, fusha e zbatimit dhe kohëzgjatja e delegimit të kompetencave përcaktohen qartë në aktet legislative përkatëse. Këshilli ose Parlamenti Europian mund ta revokojë në çdo moment këtë delegim kompetencash. Akti i deleguar hyn në fuqi vetëm nëse Parlamenti Europian apo Këshilli nuk e kundërshtojnë atë brenda periudhës së përcaktuar në vetë aktin legjislativ (neni 290 i TFBE-së). “Aktet zbatuese” përbëjnë përjashtim nga ky parim, pasi të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e akteve juridike detyruese të BE-së, merren nga Shtetet Anëtare, në pajtim me dispozitat e

tyre të brendshme. Kur janë të nevojshme kushte uniforme për zbatimin e akteve juridikisht të detyrueshme të BE-së, nxirren akte zbatuese që zakonisht i miraton Komisioni, dhe, në raste të jashtëzakonshme, i miraton Këshilli. Megjithatë, Parlamenti Europian dhe Këshilli përcaktojnë paraprakisht rregullat dhe parimet e përgjithshme për mekanizmat e kontrollit, që u mundësojnë Shteteve Anëtare të kontrollojnë ushtrimin e kompetencave zbatuese nga ana e Komisionit (neni 291 TFBE-së). Gjithashtu, institucionet e BE-së nxjerrin edhe “akte juridike të tjera”, për të miratuar masa jodetyruese dhe deklarata, ose për të rregulluar funksionimin e brendshëm të BE-së apo të institucioneve të tij, siç janë marrëveshjet e arritura ndërmjet institucioneve apo rregulloret e brendshme.

Këto akte juridike kanë forma të ndryshme; më kryesoret janë renditur dhe përkufizuar në nenin 288 të TFBE-së. Si akte juridike detyruese, ato përfshijnë si dispozita juridike të përgjithshme dhe abstrakte, ashtu edhe masa specifike individuale. Aktet juridike janë baza për nxjerrjen e deklaratave jodetyruese nga ana e institucioneve të Bashkimit. Kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse, sepse shumë akte të tjera juridike nuk hyjnë në ndonjë kategori specifike. Fjala është për rezolutat, deklaratat, programet e veprimit ose Librat e Bardhë dhe Librat e Gjelbër. Ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme mes akteve të ndryshme, për sa u përket procedurave, efekteve të tyre juridike dhe autoriteteve që iu drejtohen; këto dallime do t'i shtjellojmë më hollësisht në pjesën për “mënyrat e veprimit”.

Krijimi i legjislacionit dytësor të Bashkimit është proces gradual, që i jep vitalitet legjislacionit parësor që rrjedh nga Traktatet e Bashkimit dhe që vazhdimisht ndërton dhe plotëson rendin juridik europian.

## **MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TË BE-së**

Burimi i tretë i së Drejtës së Bashkimit ka të bëjë me rolin e BE-së në nivel ndërkombëtar. Duke qenë si një nga qendrat më të rëndësishme në botë, Europa nuk mund të kufizohet thjesht në administrimin e punëve të brendshme të saj, por ajo duhet të merret edhe me marrëdhëniet ekonomike, sociale dhe politike me pjesën tjetër të globit. Për këtë qëllim, sipas së Drejtës ndërkombëtare, BE-ja lidh marrëveshje me shtete jo anëtare (“shtete të treta”) dhe me organizata ndërkombëtare, që variojnë nga traktatet për bashkëpunim në fushën tregtare, industriale, teknike dhe sociale, deri te marrëveshjet për tregtimin e produkteve të caktuara.

Vlen të përmenden tri lloje marrëveshjesh ndërmjet BE-së dhe shteteve jo anëtare:

### ***Marrëveshjet e asociimit***

Asociimi nuk është thjesht rregullim i politikës tregtare. Ai mundëson bashkëpunim të ngushtë ekonomik dhe ndihmë financiare të gjerë të BE-së për vendet në fjalë (neni 217 i TFBE-së). Ekzistojnë tri lloje marrëveshjesh asociimi.

#### **Marrëveshjet për mbajtjen e lidhjeve të veçanta ndërmjet Shteteve Anëtare dhe vendeve jo anëtare**

Shkak kryesor për krijimin e marrëveshjeve të asociimit ishte ekzistenca e disa vendeve dhe territoreve jashtë Europës, të cilat për shkak të së kaluarës të tyre koloniale, kishin lidhje shumë të ngushta ekonomike me Belgjikën, Danimarkën, Francën, Italinë, Hollandën dhe Mbretërinë e Bashkuar. Vendosija në BE e tarifës së jashtme doganore do të sillte pasoja të rënda në tregtinë me këto vende, kështu që duheshin marrë disa masa specifike. Pra, qëllimi i asociimit është të nxisë zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve dhe territoreve jashtë Europës dhe të vendosë marrëdhënie të ngushta ekonomike ndërmjet tyre dhe Bashkimit si një i tërë (neni 198 i TFBE-së). Si rezultat, ekzistojnë një sërë marrëveshjesh preferenciale që mundësojnë importimin e mallrave prej këtyre vendeve me tarifa doganore zero. Ndihma financiare dhe teknike e BE-së është kanalizuar në Fondin European për Zhvillim. Marrëveshja më e rëndësishme në praktikë është Marrëveshja e Partneritetit BE-AKP, pra ndërmjet BE-së dhe rreth 70 shteteve të Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit (AKP). Kohët e fundit, kjo marrëveshje është shndërruar në disa marrëveshje partneriteti, të cilat u japin gradualisht vendeve të AKP-së akses të lirë në tregun e brendshëm evropian.

#### **Marrëveshje për përgatitjen e anëtarësimit në Bashkim ose për vendosjen e një bashkimi doganor**

Marrëveshjet e asociimit përdoren edhe për të përgatitur anëtarësimin e mundshëm të një vendi në BE. Kjo shërben si fazë paraprake e anëtarësimit, gjatë të cilës vendi aspirues punon për harmonizimin e kushteve ekonomike me ato të BE-së.

#### **Marrëveshja për Zonën Ekonomike Europiane (ZEE)**

Marrëveshja për ZEE-në përfshin vendet (e mbetura) të Marrëveshjes së Zonës së Tregtisë së Lirë (MZTL-EFTA- European Free Trade Association) (Islandë, Lihtenshtajn, Norvegji) në tregun e brendshëm të BE-së dhe duke

u kërkuar atyre që të transpozojnë pothuaj 2/3 e legjislacionit të BE-së, krijon një bazë të qëndrueshme për anëtarësimin e ardhshëm të këtyre vendeve. Sipas *acquis communautaire* (tërësia e legjislacionit parësor dhe dytësor të Bashkimit), brenda ZEE-së duhet të ketë lëvizje të lirë të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitalit, rregulla unike për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, si dhe bashkëpunim më të ngushtë për politikat horizontale dhe shoqëruese (mjedisi, kërkimi shkencor dhe zhvillimi, arsimi).

### ***Marrëveshjet e bashkëpunimit***

Marrëveshjet e bashkëpunimit nuk kanë fushë veprimi aq të gjerë sa marrëveshjet e asociimit, pasi synojnë vetëm forcimin e bashkëpunimit ekonomik. Marrëveshje të tilla BE-ja ka lidhur për shembull me Shtetet e Magrebit (Algjeri, Marok dhe Tunizi), me Shtetet e Mashrekut (Egjypt, Jordani, Liban dhe Siri), si dhe me Izraelin.

### ***Marrëveshjet tregtare***

Bashkimi ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh tregtare me vende jo-anëtare, me grupime të këtyre vendeve apo në kuadrin e organizatave tregtare ndërkombëtare për sa u përket tarifave dhe politikës tregtare. Marrëveshjet ndërkombëtare tregtare më të rëndësishme janë: Marrëveshja për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë (Marrëveshja e OBT-së) dhe marrëveshjet tregtare shumëpalëshe që rrjedhin prej saj, përfshi sidomos Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (GATT 1994); Kodi Antidumping dhe i Subvencioneve; Marrëveshja e Përgjithshme për Tregtinë në Shërbimet (GATS); Marrëveshja për Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPS); dhe Marrëveshja e Mirëkuptimit për Rregullat dhe Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve.

## **BURIMET E SË DREJTËS SË PASHKRUAR**

Burimet e së Drejtës së Bashkimit të përshkruara deri tani kanë një karakteristikë të përbashkët. Të gjitha krijojnë të Drejtë të shkruar. Por, si të gjitha rendet juridike, edhe rendi juridik i BE-së nuk mund të përbëhet vetëm nga rregulla të shkruara, pasi gjithnjë do të ketë boshllëqe që duhet të plotësohen nga e drejta e pashkruar.



### *Parimet e përgjithshme të së Drejtës*

Burime të pashkruara të së Drejtës së BE-së janë edhe parimet e përgjithshme të së Drejtës. Këtu hyjnë rregullat që shprehin konceptet themelore të së Drejtës dhe të drejtësisë që duhen respektuar nga çdo sistem juridik. E Drejta e shkruar e Bashkimit rregullon kryesisht çështjet ekonomike dhe sociale, por arrin ta përmbushë këtë detyrim vetëm pjesërisht, çka i bën parimet e përgjithshme të së Drejtës një nga burimet më të rëndësishme të së Drejtës së Bashkimit. Ato mundësojnë mbushjen e boshllëqeve ligjore dhe interpretimin e dispozitave ekzistuese në mënyrën më të drejtë. Këto parime fitojnë efektet kur zbatohet e drejta, sidomos përmes vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë, e cila ka përgjegjësinë që “të garantojë respektimin e së Drejtës në interpretimin dhe zbatimin e Traktatit”. Pikat e referimit për të përcaktuar parimet e përgjithshme të së Drejtës janë kryesisht parimet e përbashkëta të rrezeve juridike të Shteteve Anëtare. Ato përbëjnë bazën mbi të cilën zhvillohen rregullat e BE-së, të nevojshme për zgjidhjen e një problemi të caktuar. Përkrah parimeve të autonomisë, zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë dhe përparësisë të së Drejtës së Bashkimit, tek parimet e tjera juridike përfshihet garantimi i të drejtave bazë, parimi i proporcionalitetit, mbrojtja e pritshmërive të ligjshme, e drejta për proces të rregullt dhe parimi që Shtetet Anëtare janë përgjegjëse për shkelje të së Drejtës së Bashkimit.

### *E Drejta zakonore*

E Drejta e pashkruar e Bashkimit përfshin edhe të Drejtën zakonore. Kjo nënkupton praktikën e përbashkët, e cila rrjedhimisht është bërë juridikisht e pranueshme dhe që plotëson ose ndryshon legjislacionin parësor ose dytësor. Pasqyrimi i mundshëm i së Drejtës zakonore në të Drejtën e Bashkimit pranohet në parim, por megjithatë, futja e saj në kuadrin e së Drejtës së Bashkimit mbart një sërë pengesash. Pengesa e parë është ekzistenca e një procedure të veçantë për ndryshimin e Traktateve (neni 54 i TBE-së). Kjo dispozitë nuk përjashton mundësinë e pasqyrit të së Drejtës zakonore, por e bën të vështirë përmbushjen e kriterëve, sipas të cilave një praktikë konsiderohet e përbashkët dhe pranuar, nëse është zbatuar për një kohe të gjatë. Një tjetër pengesë për krijimin e së Drejtës zakonore në institucionet e Bashkimit konsiston në faktin se ligjshmëria e çdo veprimi të një institucioni buron nga Traktatet, jo nga sjellja reale apo vullneti i institucionit për të krijuar norma juridike. Për rrjedhojë, e Drejta zakonore nuk mund të krijohet në asnjë rast nga institucionet

e Bashkimit, në nivelin e Traktateve, por vetëm nga Shtetet Anëtare dhe vetëm sipas kushteve rigorozë të përmendura më lart. Procedurat dhe praktikat e ndjekura dhe të pranura juridikisht nga institucionet e Bashkimit mund të përdoren vetëm në kuadrin e interpretimit të legjislacionit të krijuar nga vetë ato, që mund të ndryshojë detyrimet ligjore dhe fushën e veprimit të aktit ligjor në fjalë. Megjithatë, edhe në këtë rast duhen respektuar kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në legjislacionin primar të Bashkimit.

### ***Marrëveshjet ndërmjet Shteteve Anëtare***

Burimi i fundit i së Drejtës së BE-së janë marrëveshjet ndërmjet Shteteve Anëtare. Marrëveshje të tilla mund të përfundohen për të zgjidhur çështje që lidhen ngushtë me veprimtaritë e BE-së, por pa u transferuar kompetenca institucioneve të Bashkimit; ekzistojnë edhe marrëveshje ndërkombëtare në ‘shkallë të gjerë’ (traktate dhe konventa) ndërmjet Shteteve Anëtare, që synojnë kryesisht të kapërcejnë efikasitetin e kufizuar territorial të masave kombëtare dhe të krijojnë të Drejtë unike në mbarë BE-në. Ato kanë rëndësi sidomos në fushën e së Drejtës ndërkombëtare private. Këto marrëveshje përfshijnë: Konventën për Juridiksionin dhe Zbatimin e Vendimeve në Çështje Civile dhe Tregtare (1968), që është zëvendësuar me një Rregullore të Këshillit të vitit 2001, dhe është bërë tashmë pjesë e legjislacionit dytësor të Bashkimit (kjo rregullore nuk zbatohet në Danimarkë); Konventën për Njohjen e Ndërsjellë të Shoqërive Tregtare dhe Personave Juridikë (1968); Konventën për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë në lidhje me Rregullimin e Transfertave të Fitimit mes Ndërmarrjeve të Asociuara (1990) dhe Konventën për Legjislacionin e Zbatueshëm për Detyrimet Kontraktore (1980).

### **INSTRUMENTET E VEPRIMIT TË BE-SË**

Themelimi i BE-së imponoi nevojën për të “konceptuar” sërish sistemin e akteve legjislative. Si fillim, duhej përcaktuar natyra dhe efektet e legjislacionit të Bashkimit. Institucionet duhej të ishin në gjendje të harmonizonin në mënyrë efektive, domethënë të pavarur nga vullneti i mirë i Shteteve Anëtare, kushtet e ndryshme ekonomike, sociale dhe madje mjedisore në shumë Shtete Anëtare, me qëllimin për t’iu ofruar të gjithë shtetasve të Bashkimit kushtet më të mira të mundshme për jetesë.



Nga ana tjetër, ato nuk mund të ndërhyjnë në sistemet juridike të brendshme të Shteteve, më shumë se ishte e nevojshme. Pra, i tërë sistemi normativ i BE-së bazohet në parimin se kur një masë duhet të jetë e zbatueshme, qoftë edhe në detaje, në të gjitha Shtetet Anëtare, atëherë masat kombëtare duhet të zëvendësohen me akte ligjore të Bashkimit; kur kjo nuk është e nevojshme, duhen marrë parasysh rendet juridike ekzistuese të Shteteve Anëtare. Në këtë kontekst është zhvilluar një mori instrumentesh që i mundësojnë institucioneve të Bashkimit të ndërhyjnë me masa të ndryshme në rendet juridike të brendshme. Rasti më drastik është zëvendësimi i normave të brendshme me norma të Bashkimit. Bashkimi disponon edhe rregulla në bazë të të cilave institucionet e tij ndikojnë indirekt mbi rendet juridike të Shteteve Anëtare. Për të disiplinuar një rast konkret, mund të merren edhe masa ndaj një subjekti të përcaktuar nominalisht ose të identifikueshëm. Në fund, ekzistojnë edhe akte jodetyruese për Shtetet Anëtare apo për shtetasit e Bashkimit.

Instrumentet juridike të BE-së, në këndvështrimin të subjekteve që u adresohen dhe efekteve praktike që shkaktojnë te Shtetet Anëtare, ndahen si më poshtë:

	<b>KUJT I DREJTOHET</b>	<b>EFEKTET</b>
<b>RREGULLORE</b>	Të gjitha Shteteve Anëtare, personave juridikë dhe fizikë	Drejtëpërdrejt të zbatueshme dhe detyruese në tërësinë e tyre
<b>DIREKTIVË</b>	Të gjitha Shteteve Anëtare ose disa Shteteve Anëtare specifike	Detyruese për sa i përket rezultatit të synuar. Drejtëpërdrejt e zbatueshme vetëm në rrethana të veçanta
<b>VENDIM</b>	I paspecifikuar Të gjitha Shteteve Anëtare ose Shteteve Anëtare specifike; personave fizikë ose juridikë specifike	Drejtëpërdrejt të zbatueshme dhe detyruese në tërësinë e tyre
<b>REKOMANDIM</b>	Të gjitha Shteteve Anëtare ose Shteteve Anëtare specifike; organeve të tjera të BE-së; individë	Jodetyruese
<b>AVIS</b>	Të gjitha Shteteve Anëtare ose Shteteve Anëtare specifike; organe të tjera të BE-së	Jodetyruese
	I paspecifikuar	Jodetyruese

## RREGULLORET SI “LIGJE” TË BASHKIMIT

Rregulloret janë aktet me të cilat institucionet e Bashkimit mund të ndërhyjnë më shumë në rendet juridike të brendshme. Ato dallohen në dy drejtime krejt të pazakonta për të Drejtën ndërkombëtare.

- I pari është karakteri i tyre Komunitar, pra pavarësisht kufijve kombëtarë, sanksionojnë të njëjtën të Drejtë në mbarë Bashkimin dhe janë tërësisht të zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare. Shteteve Anëtare u ndalohet të zbatojnë një rregullore në mënyrë të paplotë apo të përzgjedhin vetëm disa dispozita, me qëllim që t’u shmangen normave ndaj të cilave kanë qenë kundër në procedurën e miratimit, apo që bien ndesh me interesa kombëtarë. Gjithashtu, asnjë Shtet Anëtar nuk mund të mos respektojë natyrën detyruese të një rregulloreje, duke përdorur dispozita apo praktika të së Drejtës së vet të brendshme.
- I dyti është zbatueshmëria e drejtpërdrejtë, domethënë aktet juridike nuk kanë pse të transpozohen në të Drejtën e brendshme, por u japin të drejta ose u vënë detyrime shtetasve të Bashkimit në të njëjtën mënyrë si e Drejta e brendshme. E Drejta e Bashkimit është drejtpërdrejt detyruese për Shtetet Anëtare dhe institucionet e gjykatat e tyre, ashtu si e Drejta e brendshme.

Pavarësisht prej ngjashmërive, këto akte juridike janë lehtësisht të dallueshme nga ligjet e miratuara nga Shtete Anëtare individuale. Nëse miratohen me përfshirjen e Parlamentit European (me procedurën e bashkë-vendimmarrjes – shih kapitullin pasardhës), ato konsiderohen “akte legjislativ”. Parlamenti nuk ka përgjegjësi për rregulloret, pasi ato nxirren nga Këshilli dhe Komisioni European dhe kështu, të paktën thjesht nga pikëpamja procedurale, nuk përmbajnë karakteristikat thelbësore të një ligji.

## DIREKTIVAT

Përkrah rregullores, direktiva është instrumenti më i rëndësishëm legjislativ. Qëllimi i saj është të rakordojë dy objektiva: të garantojë standardizimin e nevojshëm të legjislacionit të Bashkimit dhe të mbrojë larminë e strukturave dhe traditave kombëtare. Synimi parësor i direktivës nuk është njësimi i së Drejtës, qëllim që duhet të përmbushet nga rregullorja, por harmonizimi i saj. Direktiva eliminon mospërputhshmëritë dhe konfliktet ndërmjet legjislacioneve të brendshme dhe rregulloreve, ose sheshon gradualisht mospërputhshmëritë,

në mënyrë që në të gjitha Shtetet Anëtare të krijohen kushte të njëjta materiale. Direktiva është një nga mjetet bazë për konsolidimin e tregut unik .

Direktiva është e detyrueshme për Shtetet Anëtare vetëm për sa i përket objektivit që duhet arritur, por ua lë atyre të zgjedhin format dhe metodat se si ta trupëzojnë këtë objektiv Komunitar të përbashkët në rendin e tyre juridik. Logjika e këtij legjislacioni është se mundëson ndërhyrje më të lehtë në sistemet e brendshme ekonomike dhe juridike. Në këtë mënyrë, Shteteve Anëtare u lejohet të mbajnë parasysh rrethanat specifike kombëtare në momentin e zbatimit të normave Komunitare. Pra, direktiva nuk i zëvendëson normat e brendshme, por i detyron Shtetet Anëtare që të përshtasin legjislacionin e brendshëm sipas dispozitave Komunitare. Kjo kërkon normalisht një procedurë ligjvënëse me dy faza.

Në fazën e parë, fillestare, direktiva sanksionon objektivin që duhet arritur në nivelin e BE-së nga subjekti respektiv, që mund të jenë një apo të gjitha Shtetet Anëtare, brenda një harku kohor të caktuar. Institucionet e BE-së mund ta përcaktojnë objektivin që synohet në mënyrë kaq të detajuar, sa që Shteteve Anëtare nuk u lihet asnjë hapësirë manovrimi. Kjo është bërë për shembull me direktivat për standardet teknike dhe mbrojtjen mjedisore.

Në fazën e dytë, në nivel kombëtar, objektivi i përcaktuar në nivel të BE-së përkthehet në dispozita juridike apo administrative në Shtetet Anëtare. Edhe pse Shtetet Anëtare janë parimisht të lira të zgjedhin format dhe metodat për transpozimin e detyrimit në BE-së në të Drejtën e brendshme, zbatohen kritere të BE-së për të vlerësuar nëse kjo gjë është realizuar në pajtim me të Drejtën e BE-së. Parimi është që duhet të krijohet një situatë juridike, e cila bën të mundur të përcaktohen, në mënyrë mjaft të qartë dhe të saktë, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e një direktive, për t'iu dhënë mundësinë shtetasve të Bashkimit që t'i përdorin apo t'i kundërshtojnë ato dispozita në gjykatat kombëtare. Për këtë qëllim, zakonisht është i nevojshëm miratimi i dispozitave të brendshme detyruese ose shfuqizimi apo ndryshimi i normave juridike ekzistuese. Vetëm praktika administrative nuk mjafton, pasi për shkak të natyrës së vet, mund të ndryshohet sipas vullnetit të autoriteteve të interesuara.

Si rregull, direktivat nuk japin të drejta dhe as vendosin detyrime për shtetasit e Bashkimit, pasi u adresohen qartësisht vetëm Shteteve Anëtare. Të drejtat dhe detyrimet për shtetasit burojnë vetëm nga masat e miratuara prej autoriteteve të Shteteve Anëtare në zbatim të direktivës. Kjo nuk ka shumë rëndësi për shtetasit, për sa kohë Shtetet Anëtare përmbushin detyrimet ndaj Bashkimit. Por shtetasit e

Bashkimit mund të kenë disavantazhe kur një Shtet Anëtar nuk merr masat e duhura zbatuese për të arritur objektivin e përcaktuar në direktivë që u jep atyre avantazhe, apo kur masat e marra janë të paplota. Gjykata e Drejtësisë nuk i toleron këto situata dhe përmes jurisprudentës së saj ka përcaktuar se në këto rrethana, shtetasit e Bashkimit mund t'i kërkojnë gjykatave kombëtare të njohin efektin e drejtpërdrejtë të direktivës apo rekomandimit, për të garantuar kështu të drejtat që u jepen prej tyre.

Sipas Gjykatës, kushtet për efektin e drejtpërdrejtë janë:

- Dispozitat e direktivës duhet të sanksionojnë të drejtat e shtetasit/ndërmarrjes së BE-së në mënyrë të qartë dhe të saktë;
- Ushtrimi i të drejtave nuk është i kushtëzuar;
- Autoritetet legjislative kombëtare nuk duhet të kenë hapësira manovrimi në lidhje me përmbajtjen e dispozitave;
- Afati për zbatimin e direktivës ka mbaruar

Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë për efektin e drejtpërdrejtë bazohen në bindjen e përgjithshme se Shteti Anëtar vepron në mënyrë kontradiktore dhe të paligjshme, nëse zbaton legjislacionin e vet të vjetër, pa e përshtatur me kërkesat e direktivës. Ky quhet abuzim i Shtetit Anëtar me të drejtat dhe njohja e efektit të drejtpërdrejtë të direktivës synon ta luftojë këtë prirje dhe të mos lejojë që Shteti Anëtar të nxjerrë ndonjë përfitim nga shkelja e së Drejtës së BE-së. Kështu, efekti i drejtpërdrejtë ka si pasojë ndëshkimin e Shtetit Anëtar që ka bërë shkeljen. Në këtë kontekst, vlen të përmendet që Gjykata e Drejtësisë e ka zbatuar këtë parim vetëm në çështjet ndërmjet shtetasit dhe Shtetit Anëtar dhe vetëm atëherë kur direktiva ka qenë në favor të shtetasit dhe jo në dëm të tij; pra, vetëm kur pozitat e shtetasit në kuadrin e legjislacionit të ndryshuar sipas direktivës i japin më tepër favore sesa legjislacioni i vjetër (i ashtuquajtur “efekt i drejtpërdrejtë vertikal”). Por zbatimi i parimit të efektit të drejtpërdrejtë vertikal të direktivave nuk parandalon faktin që ky efekt në favor të një individi, të jetë në dëm të një individi tjetër (efekti i dyfishtë i direktivave, që shpesh ndodh në të Drejtën e prokurimit dhe mjedisit). Ky dëm duhet të konsiderohet si efekt juridik negativ, që rrjedh pashmangshmërisht nga detyrimi i Shtetit Anëtar për të rakorduar rendin juridik me objektivat e direktivës deri në fund të periudhës së transpozimit; përveç këtij rasti, njohja e efektit vertikal të direktivave nuk shkakton dëme të tjera.

Nga ana tjetër, Gjykata e Drejtësisë e ka refuzuar efektin e drejtpërdrejtë të direktivave në marrëdhëniet ndërmjet shtetasve (“efekti i drejtpërdrejtë horizontal”). Nga karakteri ndëshkues i efektit të drejtpërdrejtë, Gjykata nxjerr përfundimin që ky

efekt nuk duhet zbatuar mes personave privatë, pasi ata nuk mund të konsiderohen përgjegjës për mosveprimet e Shtetit Anëtar, dhe për më tepër, duhet të mbrohen nga parimet e sigurisë juridike dhe mbrojtjes së pritshmërive të ligjshme. Shtetasi duhet të sigurohet që efekti i direktivës është garantuar prej masave të brendshme zbatuese. Megjithatë, në jurisprudencën e kohëve të fundit, Gjykata e Drejtësisë e ka zbutur mosnjohjen e efektit të drejtpërdrejtë të direktivave në çështjet e së Drejtës private, duke e kufizuar në rastet kur një palë kontraktuese përdor një të drejtë që buron nga direktiva kundrejt të drejtës së palës tjetër që buron nga e Drejta e brendshme. Kjo i hap rrugën zbatimit horizontal të dispozitave drejtpërdrejt të zbatueshme të direktivës në situata, për shembull, të përmbushjes së objektivit të së Drejtës së brendshme (p.sh. kur një ndërmarrje kërkon të detyrojë një konkurrent të respektojë të Drejtën e brendshme, e cila cenon rregullimet e direktivës), apo zbatimit të detyrimeve në kuadrin e të Drejtës së brendshme që bien ndesh me zbatimin e direktivës (p.sh. refuzimi për të përmbushur një kontratë, duke përdorur dispozita ndaluese të brendshme që bien në kundërshtim me rregullimet e direktivës).

Efekti i drejtpërdrejtë i një direktive nuk do të thotë domosdoshmërisht që një dispozitë e direktivës i jep të drejta individit. Dispozitat e një direktive kanë efekt të drejtpërdrejtë për sa kohë që kanë efektin e së drejtës objektive. Të njëjtat kushte vlejnë për njohjen e këtij efekti, ashtu si për njohjen e efektit të drejtpërdrejtë, me përjashtimin e vetëm që në vend të përcaktimit të një ligji të qartë dhe të saktë për shtetasit ose ndërmarrjet e Bashkimit, krijohet një detyrim i qartë dhe i saktë për vetë Shtetet Anëtare.

Nëse ndodh kështu, direktiva është e detyrueshme për të gjitha institucionet, pra legjislatorin, administratën dhe gjykatat e Shteteve Anëtare, të cilët duhet ta respektojnë dhe ta zbatojnë me përparësi si legjislacion të Bashkimit. Më konkretisht, ata kanë gjithashtu detyrimin që të interpretojnë legjislacionin kombëtar në përputhje me direktivat ose t'i japin dispozitës së direktivës në fjalë përparësi zbatimi mbi legjislacion kombëtar, që bie në kundërshtim me të. Direktivat kanë gjithashtu disa efekt kufizues për Shtetet Anëtare- edhe përpara fundit të periudhës së transpozimit. Nisur nga natyra detyruese e direktivës dhe synimit të tyre për të lehtësuar realizimin e detyrave të Bashkimit (Neni 4 TBE), Shtetet Anëtare, përpara fundit të periudhës së transpozimit, duhet të heqin dorë nga marrja e masave që mund të rrezikojnë arritjen e qëllimit të direktivës.

Gjykata e Drejtësisë, në vendimet e saj Francovich dhe Bonifaci në vitin 1991, njohu detyrimin e Shteteve Anëtare për dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar nga mostranspozimi apo transpozimi i pasaktë i direktivës. Të dy



këto padi janë ngritur kundër Italisë për mos transpozim në kohë të Direktivës së Këshillit 80/987/KEE datë 20 tetor 1980 për mbrojtjen e punëtorëve në rast falimentimi të punëdhënësit. Ato synonin shpërblimin e punëtorëve para deklarimit të falimentimit dhe pushimit nga puna për shkak të falimentimit.

Për këtë qëllim, duheshin krijuar fonde garancie, ku nuk do të kishin akses kreditorët; ato duhej të financoheshin nga punëdhënësit apo autoritetet publike ose të dyja së bashku. Gjykata u gjend para një problemi: edhe pse qëllimi i direktivës ishte t'u jepte punëtorëve të drejtën që të vazhdonin të shpërbeheshin nga fondet e garancisë që duhej të krijoheshin, kësaj të drejte nuk mund t'i jepej efekt i drejtpërdrejtë nga gjykatat kombëtare dhe nuk mund të përdorej për shkak të mostranspozimit të direktivës, dhe rrjedhimisht, moskrijimin e fondit të garancisë, duke e bërë të pamundur përcaktimin se kush ishte debitori në lidhje me falimentimin. Gjykata deklaroi në këtë gjykim se Shteti italian, duke mos zbatuar direktivën, i kishte privuar punëtorët në fjalë nga e drejta që u njeh direktiva, dhe rrjedhimisht ishte përgjegjës për dëmshpërblimin e tyre. Sipas Gjykatës, detyrimi i dëmshpërblimit, edhe pse nuk është i shkruar shprehimisht në të Drejtën e Bashkimit, përbën një pjesë tërësore të rendit juridik të BE-së, pasi është shkelle e efikasitetit të këtij rendi dhe kufizim i të drejtave që u jep shtetasve të BE-së, nëse këta nuk kanë mundësinë të përfitojnë dëmshpërblim, kur të drejtat e tyre shkelen nga një veprim i Shteteve Anëtare në kundërshtim me të Drejtën e BE-së.

## VENDIMET

Vendimet janë kategoria e tretë e akteve juridike të BE-së. Në disa rasteve, institucionet e Bashkimit mund të jenë vetë përgjegjëse për zbatimin e Traktateve dhe rregulloreve, dhe kjo është e mundur vetëm nëse janë në gjendje për të marrë masa detyruese ndaj individëve, ndërmarrjeve apo Shteteve të caktuara Anëtare. Kjo situatë paraqitet pothuaj njësoj edhe në sistemet juridike të Shteteve Anëtare; autoritetet e zbatojnë legjislacionin për një çështje individuale, nëpërmjet një vendimi administrativ.

Në rendin juridik të BE-së, ky funksion kryhet nga vendimet; këto përbëjnë aktin juridik tipik me të cilin institucionet e Bashkimit urdhërojnë marrjen e një mase në një çështje individuale. Me një vendim të tillë, institucionet e Bashkimit mund t'i kërkojnë një Shteti Anëtar apo individ që të kryejë apo të mos kryejë një veprim, si dhe mund t'u japë atyre të drejta apo t'u vendosë detyrime.



2 dhe 3 dhjetor 1985, Luksemburg.  
Federalistët europianë demonstrojnë para ndërtesës  
së Këshillit Europian, pro Bashkimit Europian  
dhe heqjes së kufijve, gjë që për disa vende,  
gjeti zbatim vetëm 10 vjet më pas.

Vendimi ka këto karakteristika bazë:

- Dallon nga rregullorja, pasi ka zbatueshmëri individuale: personave të cilëve u drejtohet duhet të emërtohen individualisht dhe është i detyrueshëm vetëm për ta. Kjo kërkesë plotësohet nëse në kohën që del një vendim, mund të identifikohet kategoria e atyre që ju drejtohet vendimi, duke mos lënë shteg që të zgjerohet më vonë. Për këtë arsye, përmbajtja e vendimit është e tillë që të ndikojë në mënyrë individuale dhe të drejtpërdrejtë mbi gjendjen e shtetasit. Në këtë kuptim, vendimi mund t'u imponohet edhe palëve të treta që janë të identifikueshme për shkak të karakteristikave të caktuara individuale apo rrethanave të veçanta që i dallojnë nga të tjerët, dhe i përcakton edhe këta si të adresuar.
- Dallon nga direktiva, pasi është detyruese në tërësinë e saj (ndërsa direktiva thjesht parashtron objektivin që duhet arritur)
- Është drejtpërdrejtë i detyrueshëm për të gjithë ata të cilëve u drejtohet. Ashtu si Direktiva, vendimi që i drejtohet një Shteti Anëtar në fakt mund të ketë efekt të drejtpërdrejtë mbi shtetasin.

## REKOMANDIMET DHE OPINIONET

Rekomandimet dhe opinionet përbëjnë kategorinë e fundit të masave juridike të përcaktuara shprehimisht në Traktate. Ato u bëjnë të mundur institucioneve të Bashkimit t'u transmetojnë një pikëpamje apo qëndrim të caktuar Shteteve Anëtare, e në disa raste edhe qytetarëve të Bashkimit. Por këto pikëpamje apo qëndrime nuk kanë karakter detyrues dhe nuk e ngarkojnë subjektin që i adresohet me ndonjë detyrim juridik.

Rekomandimet i bëjnë thirrje të adresuarit të sillet në një mënyrë të caktuar, pa u imponuar detyrime juridike. Për shembull, në rastet kur miratimi apo ndryshimi i një dispozite juridike apo administrative në një Shtet Anëtar shkakton devijim të konkurrencës në tregun e brendshëm evropian, Komisioni mund t'i rekomandojë Shtetit në fjalë të marrë masat e përshtatshme për të shmangur këtë devijim (neni 117, paragrafi 1, fjalia e dytë e TFBE-së).

Opinionet nxirren nga institucionet e Bashkimit kur japin vlerësim për një situatë të caktuar apo zhvillime brenda Bashkimit ose në një Shtet Anëtar. Në disa raste, opinionet përgatisin kushtet paraprake për aktet e ardhshme

juridike detyruese, ose përbëjnë një parakusht për një padi në Gjykatën e Drejtësisë (nenet 258 dhe 259 të TFBE-së).

Rëndësia thelbësore e rekomandimeve dhe e opinioneve është politike dhe morale. Hartuesit e Traktateve parashikuan njohjen e këtyre akteve me bindjen se të interesuarit - nisur nga prestigji që gëzojnë institucionet e Bashkimit, si edhe njohuritë e thella që kanë në kontekstin ndërkombëtar përtej kuadrit të brendshëm juridik - do t'u binden vullnetarisht rekomandimeve drejtuar atyre ose do të marrin masat e duhura në vijim të vlerësimit që institucionet e Bashkimit i bëjnë një situatë të caktuar. Sidoqoftë, edhe rekomandimet dhe opinionet mund të kenë efekt të tërthortë ligjor, në rastet kur ato vlerësohen se janë paraprakisht të nevojshëm për instrumentet ligjor të detyrueshëm që do të miratohen më pas ose kur institucioni që i miraton e ka marrë përsiper një angazhim të tillë. Në këtë mënyrë përmes këtyre akteve gjenerohen pritshmëri të ligjshme të cilat duhet të përmbushen në të ardhmen.

## **REZOLUTAT, DEKLARATAT DHE PROGRAMET E VEPRIMIT**

Përkrah akteve juridike të parashikuara në Traktate, institucionet e Bashkimit disponojnë edhe një sërë instrumentesh të tjera veprimi për të modeluar rendin juridik të BE-së. Rezolutat, deklaratat dhe programet e veprimit janë instrumentet më të rëndësishme në këtë drejtim.

Rezolutat: mund të nxirren nga Këshilli European, Këshilli i BE-së dhe Parlamenti European. Rezolutat paraqesin qëllime dhe qëndrime të përbashkëta për procesin e përgjithshëm të integritetit dhe për detyrat specifike brenda dhe jashtë BE-së. Rezolutat për funksionimin e brendshëm të BE-së trajtojnë, për shembull, çështjet themelore që lidhen me bashkimin politik, politikën rajonale, politikën për energjinë, si dhe me bashkimin ekonomik e monetar (sidomos për Sistemin Monetar European). Rëndësia parësore e këtyre rezolutave është se kontribuojnë për të orientuar politikisht punën e Këshillit. Si manifestim i vullnetit politik të përbashkët, rezolutat e lehtësojnë arritjen e konsensusit brenda Këshillit; përveç kësaj, garantojnë nivelin minimal të bashkërendimit mes hierarkive vendimmarrëse në Komunitet dhe në Shtetet Anëtare. Çdo vlerësim i rëndësisë së tyre juridike duhet të mbajë parasysh këtë funksion, që do të thotë se rezolutat duhet të vazhdojnë të jenë instrument fleksibël dhe të mos kufizohen me kërkesa dhe detyrime të tepruara juridike.

Deklaratat: paraqiten në dy lloje të ndryshme. Kur deklarata i referohet zhvillimit të mëtejshëm të Bashkimit, për shembull Deklarata për BE-në, Deklarata për Demokracinë dhe Deklarata për të Drejtat dhe Liritë Themelore, ato janë pak a shumë të barasvlershme me rezolutat. Deklarata të tilla përdoren kryesisht për t'iu drejtuar një publiku të gjerë ose një grupi specifik të adresuarish. Lloji tjetër i deklaratës nxirret në kuadrin e procesit vendimmarrës të Këshillit dhe shpreh pikëpamje të përbashkëta apo individuale të anëtarëve të Këshillit në lidhje me interpretimin e vendimeve të Këshillit. Këto deklarata interpretuese përdoren rëndom nga Këshilli dhe përbëjnë një mjet thelbësor për arritjen e kompromisit. Rëndësia e tyre juridike duhet vlerësuar nën dritën e parimeve themelore të interpretimit, sipas të cilave, interpretimi i një dispozite duhet të udhëhiqet në të gjitha rastet nga qëllimi që ka synuar hartuesi i saj. Megjithatë, ky parim zbatohet vetëm në rastet kur deklarata gëzon vëmendjen e nevojshme publike; për shembull, legjislacioni dytësor i Bashkimit që u jep individëve të drejta të drejtpërdrejta, nuk mund të kufizohet nga klauzola dytësore që nuk janë bërë publike.

*Programet e veprimit:* përgatiten nga Këshilli dhe nga Komisioni me nismën e tyre, apo me kërkesë të Këshillit European dhe shërbejnë për të realizuar në praktikë programe normative dhe objektiva të përgjithshëm të sanksionuar në Traktate. Kur këto programe parashikohen shprehimisht në Traktate, institucionet e Bashkimit janë të detyruara të respektojnë këto dispozita kur përgatisin programet e veprimit. Në Bashkimin European, këto programe botohen në formën e Librave të Bardhë. Përkundër tyre, programet e tjera konsiderohen praktikisht si udhëzime të përgjithshme pa efekt juridik detyrues. Megjithatë, ato janë tregues i veprimit të synuar të institucioneve të Bashkimit. Këto programe botohen në Librat e Gjellbër të Bashkimit.

## **BOTIMI DHE KOMUNIKIMI**

Aktet legjislativë në formën e rregulloreve, direktivave drejtuar të gjitha Shteteve Anëtare dhe vendimet që nuk përcaktojnë specifikisht se kujt i drejtohen, botohen në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit European* (Seria L = Legjislacion). Ato hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar në to, ose kur kjo nuk përcaktohet shprehimisht, 20 ditë pas botimit.

Aktet jolegislativë të miratuara në formën e rregulloreve, direktivave apo vendimeve, kur këto të fundit nuk specifikojnë se kujt i drejtohen, nënshkruhen

nga titullari i institucionit që i ka miratuar. Ato botohen ne Gazetën Zyrtare (Seria C = Komunikime).

Direktivat e tjera dhe vendimet në të cilat specifikohet shprehimisht se kujt i drejtohen, u njoftohen subjekteve të përcaktuara dhe hyjnë në fuqi pas marrjes së këtij njoftimi.

Nuk është i detyrueshëm botimi dhe komunikimi i akteve me fuqi jodetyruese. Megjithatë zakonisht edhe ato botohen në Gazetën Zyrtare (“Njoftimet”).

### **PROCESI LEGJISLATIV NË BE**

Në sistemet kombëtare, vullneti i popullit shprehet në parlament, ndërsa vullneti i BE-së prej kohësh shprehet në mbledhjet e Këshillit, përmes përfaqësuesve të qeverive të Shteteve Anëtare. Arsyeja është e thjeshtë: BE-ja nuk përbëhet nga një ‘komb europian’, por ekzistencën dhe strukturën e ka formuar falë kontributit të përbashkët të Shteteve Anëtare. Këto të fundit nuk bëjnë thjesht transferimin e porcioneve të sovranitetit të tyre në drejtëm të BE-së, por në të njëjten kohë angazhohen që në bazë të mirëkuptimit ato mund të bien dakort për ta ushtruar atë gjerësisht së bashkuë. Megjithatë, në vazhden e zhvillimit dhe thellimit të procesit të integritimit në Bashkim, kjo ndarje kompetencash në procedurën vendimmarrëse të BE-së fillimisht u përqendrua në mbrojtjen e interesave kombëtarë të Shteteve Anëtare, pastaj u zhvillua në një sistem më të ekuilibruar, falë forcimit të vazhdueshëm të pozitave të Parlamentit Europian. Si fillim, procedura parashikonte konsultimin e Parlamentit, por më pas u zgjerua dhe përfshiu bashkëpunimin me Këshillin, duke i dhënë kështu Parlamentit kompetenca bashkë-vendimmarrëse në procesin legjislativ të BE-së.

Me Traktatin e Lisbonës, kompetenca bashkë-vendimmarrëse e Parlamentit u bë “procedurë e zakonshme legjislative”, domethënë “normë e përgjithshme”, përmes të cilit forcohet më tej elementi demokratik në procesin legjislativ të BE-së. Procedura e bashkë-vendimmarrjes konsiston në miratimin e përbashkët nga Parlamenti Europian dhe Këshilli të një rregulloreje, direktive apo vendimi, pasi është bërë propozimi nga Komisioni. Vetëm në pak raste të shprehura qartë, miratimi i një rregulloreje, direktive apo vendimi nga Parlamenti Europian me pjesëmarrjen e Këshillit, ose i një vendimi me pjesëmarrjen e Parlamentit Europian, përbën procedurë të veçantë legjislative. Përveç këtyre procedurave legjislative, ekziston edhe “procedura e miratimit” që i lë Parlamentit Europian fjalën e fundit për hyrjen në fuqi të

një instrumenti juridik, si dhe “procedura e thjeshtuar”, e cila përdoret kur instrumente jodetyruese nxirren vetëm nga një institucion i Bashkimit.

### ***Skema e procedurës***

#### **Faza e formulimit**

Në parim, makineria legislative vihet në lëvizje nga Komisioni që harton një propozim për masën që duhet të merret (e ashtuquajtura “e drejta e nismës”), nga Bashkimi. Propozimi përgatitet nga departamenti respektiv i Komisionit që merret me fushën përkatëse. Në këtë fazë, ky departament konsultohet shpesh edhe me ekspertët e Shteteve Anëtare.

Ky konsultim ndodh në komitete të mbledhura posaçërisht; gjithashtu, ekspertëve mund t’u bëhen pyetje nga departamentet përkatëse të Komisionit. Megjithatë, kur harton propozimet e veta, Komisioni nuk është i detyruar të pranojë këshillat e ekspertëve kombëtarë. Projekti i përgatitur në emër të Komisionit, ku janë përcaktuar në detaje përmbajtja dhe forma e masës që do të ndërmerret, paraqitet në mbledhjen e të gjithë anëtarëve të Komisionit, të cilët duhet ta miratojnë projektin me shumicë të thjeshtë. Pastaj i dorëzohet njëkohësisht Këshillit dhe Parlamentit European si “propozim i Komisionit”, ose kur kërkohet konsultim, i dorëzohet edhe Komitetit European Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve, së bashku me shënime të detajuara shpjeguese.

#### **Leximi i parë në Parlament dhe në Këshill**


Kryetari i Parlamentit European ia kalon propozimin për shqyrtim të mëtejshëm një komisioni parlamentar koordinimi. Propozimet e këtij komiteti diskutohen në një seancë plenare të Parlamentit dhe parashtrihen në një opinion që mund të pranojë ose refuzojë projektin ose që propozon ndryshime. Pastaj, Parlamenti ia dërgon qëndrimin e vet Këshillit.

Në leximin e parë, Këshilli mund të veprojë si vijon:

- Nëse është dakort me qëndrimin e Parlamentit, akti miratohet në formën e atij qëndrimi; kjo shënon fundin e procedurës legislative.
- Nëse Këshilli nuk është dakort me qëndrimin e Parlamentit, miraton qëndrimin e vet në leximin e parë dhe ia komunikon atë Parlamentit European.

Këshilli informon Parlamentit European për të gjitha motivet që çuan në miratimin e qëndrimit. Komisioni informon Parlamentin European për qëndrimin e vet.

PROCEDURA E ZAKONSHME LEGJISLATIVE (neni 294 i TFBE-së)





## Leximi i dytë në Parlament dhe në Këshill

Nga dita kur Këshilli i komunikon qëndrimin Parlamentit European, ky i fundit ka tre muaj kohë për të kryer një nga veprimet në vijim:

- (1) të miratojë qëndrimin e Këshillit ose të mos marrë vendim; akti konsiderohet i miratuar me formulimin që i korrespondon qëndrimit të Këshillit;
- (2) të refuzojë, me shumicën e anëtarëve të tij, qëndrimin e Këshillit; akti konsiderohet i pamiratuar dhe procedura legjislative përfundon;
- (3) me shumicën e anëtarëve të bëjë ndryshime në qëndrimin e Këshillit; teksti i ndryshuar i përcillet Këshillit dhe Komisionit, që shprehin një opinion në lidhje me këto ndryshime.

Këshilli diskuton qëndrimin e ndryshuar dhe ka tre muaj kohë, nga data e marrjes së amendimeve nga ana e Parlamentit, për të kryer një nga veprimet në vijim:

- (1) të miratojë të gjitha ndryshimet e Parlamentit; akti në fjalë konsiderohet i miratuar. Mjafton shumica e cilësuar nëse edhe Komisioni është dakord me ndryshimet; nëse jo, Këshilli miraton ndryshimet e Parlamentit vetëm me unanimitet.
- (2) të vendosë të mos miratojë të gjitha ndryshimet e bëra nga Parlamenti, ose kur nuk arrin të sigurojë shumicën e kërkuar, atëherë fillon procedura e pajtimit.

## Procedura e pajtimit

Procedurën e pajtimit e fillon Presidenti i Këshillit në marrëveshje me Kryetarin e Parlamentit European. Në qendër të procedurës është Komiteti i Pajtimit, i përbërë aktualisht nga 27 përfaqësues nga Këshilli dhe 27 përfaqësues nga Parlamenti European. Detyra e Komitetit të Pajtimit është që në leximin e dytë të arrijë miratimin e një teksti të përbashkët me shumicë të cilësuar brenda 6 javësh nga mbledhja e tij, mbi bazën e qëndrimeve të Parlamentit European dhe të Këshillit.

Komisioni është i pranishëm në punimet e Komitetit të Pajtimit dhe mund të bëjë të gjitha propozimet e nevojshme, me qëllim që të mund të arrihet një kompromis ndërmjet të Parlamentit European dhe të Këshillit.

Nëse brenda 6 muajve nga mbledhja e tij, Komiteti i Pajtitimit nuk e miraton tekstin e përbashkët, akti i propozuar konsiderohet i pamiratur.

### **Leximi i tretë në Parlament dhe në Këshill**

Nëse Komiteti i Pajtitimit arrin të miratojë një tekst të përbashkët brenda afatit 6-mujor, Parlamenti European, me shumicën e votave dhe Këshilli, me shumicë të cilësuar, kanë secili 6 javë kohë nga data e miratimit nga Komiteti i Pajtitimit që të miratojnë aktin në fjalë në përputhje me tekstin e përbashkët. Nëse kjo dështon, akti i propozuar konsiderohet i pamiratur dhe procedura legislative përfundon.

### ***Botimi***

Teksti përfundimtar (në 23 gjuhët zyrtare aktuale të Bashkimit: bullgarisht, çekisht, danisht, holandisht, anglisht, estonisht, finlandisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, hungarisht, irlandisht, italisht, letonisht, lituanisht, gjuha malteze, polonisht, portugalisht, rumanisht, sllovakisht, slovenisht, spanjisht dhe suedisht) nënshkruhet nga Kryetari i Parlamentit European dhe Presidenti i Këshillit, e pastaj botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European ose, nëse i adresohet një grupi specifik, u njoftohet të adresuarve.

Procedura e bashkëvendimmarrjes është sa sfidë aq edhe mundësi për Parlamentin. Që procedura të funksionojë me sukses, duhet të ketë marrëveshje në Komitetin e Pajtitimit. Gjithashtu, kjo procedurë ndryshon rrënjësisht marrëdhënien ndërmjet Parlamentit dhe Këshillit. Tashmë këto dy institucione gjenden në nivel hierarkik të barabartë në procedurën legislative dhe i takon Parlamentit dhe Këshillit të demonstrojnë aftësinë e tyre për kompromis, si dhe për të orientuar energjitë e tyre në Komitetin e Pajtitimit, për arritjen në rast nevojë të një marrëveshje mes tyre.

### **PROCEDURA E MIRATIMIT**

Procedura e miratimit është një tjetër formë kryesore e përfshirjes parlamentare në procesin legislative; në bazë të saj, një instrument juridik mund të miratohet vetëm me pëlqimin paraprak të Parlamentit. Por kjo procedurë nuk i jep Parlamentit fushë veprimi për të ndikuar drejtpërsdrejt

në natyrën e dispozitave juridike. Për shembull, Parlamenti nuk mund të propozojë ndryshime apo të sigurojë pranimin e tyre gjatë procedurës së miratimit. Roli i tij kufizohet vetëm me pranimin apo refuzimin e instrumentit juridik që i është dorëzuar.

Kjo procedurë përdoret në rastin e anëtarësimit të Shteteve Anëtare të reja, për lidhjen e marrëveshjeve të asociimit, për marrëveshjet me pasoja të konsiderueshme financiare për BE-në dhe për marrëveshjet me vendet jo anëtare, të përfunduara në fushat e politikave, për të cilat zbatohet procedura e zakonshme legjislativë (neni 218, paragrafi 6 i TFBE-së).

## **PROCEDURA E THJESHTUAR**

Sipas procedurës së thjeshtuar, nuk nevojitet propozim i Komisionit për të filluar procedurën legjislativë.

Kjo procedurë zbatohet për masat brenda kompetencave të Komisionit (p.sh., miratimi i ndihmës shtetërore).

Procedura e thjeshtuar përdoret edhe për miratimin e instrumenteve jodetyruese, sidomos të rekomandimeve dhe opinioneve që miraton Komisioni apo Këshilli. Komisioni nuk kufizohet vetëm në atë që është e shkruar shprehimisht në Traktate, por mund të formulojë rekomandime dhe të japë opinione sa herë që e sheh të nevojshme.

Me procedurën e thjeshtuar, aktet juridike miratohen me shumicë të thjeshtë.

## **SISTEMI I BE-SË PËR MBROJTJEN JURIDIKE**

Bashkimi që aspirojnë të jetë një bashkësi ku sundon shteti i së drejtës, duhet t'iu garantojë shtetasve një sistem të plotë dhe efektiv të mbrojtjes juridike. Sistemi i BE-së për mbrojtjen juridike e përmbush këtë kërkesë. Ky sistem e h të drejtën e individit për mbrojtje të efektshme gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga e drejta e BE-së. Kjo mbrojtje është një nga parimet juridike themelore që rezultojnë nga traditat kushtetuese të përbashkëta të Shteteve Anëtare dhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (nenet 6 dhe 13) dhe garantohet nga sistemi juridik i BE-së (Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme dhe gjykatat e specializuara). Për këtë qëllim, ekzistojnë një sërë procedurash si më poshtë.

## **PROCEDIMET PËR SHKELJE TE TRAKTATIT (NENI 258 I TFBE-së)**

Kjo procedurë shërben për të vendosur nëse një Shtet Anëtar nuk ka përmbushur një detyrim që i është ngarkuar nga e Drejta e Bashkimit. Kjo procedurë drejtohet ekskluzivisht nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian. Nisur nga rëndësia e shkeljes, referimi në Gjykatën e Drejtësisë duhet të paraprihet nga një procedurë paraprake, ku Shtetit Anëtar në fjalë i jepet mundësia për t'iu përgjigjur akuzave që i bëhen. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet deri në këtë fazë, qoftë Komisioni (neni 258 i TFBE-së) apo një Shteti tjetër Anëtar (neni 259 i TFBE-së), mund të ngrenë padi në Gjykatë. Në praktikë, këtë nismë zakonisht e merr Komisioni. Gjykata heton kërkesën dhe vendos nëse ka pasur apo jo shkelje të Traktatit. Në rast se konstatohet shkelja, Shtetit Anëtar që e ka bërë atë i kërkohet të marrë masat e nevojshme korrigjuese. Nëse një Shtet Anëtar nuk respekton vendimin e dhënë kundër tij, atëherë Komisioni mund të ngrejë padi të dytë, përmes së cilës i kërkon Shtetit në fjalë të paguajë një shumë të plotë si gjobë apo i vendos sanksione (neni 260 i TFBE-së). Pra, ndaj një Shteti Anëtar që vazhdon të mos respektojë një vendim të Gjykatës, vendosen sanksione të konsiderueshme financiare.

## **PADI PËR ANULIM (NENI 262 I TFBE-së)**

Paditë për anulim shërbejnë për kontrollin gjyqësor objektiv të veprimeve të institucioneve dhe organeve të BE-së (kontroll gjyqësor abstrakt) dhe i japin shtetasit akses në drejtësinë e BE-së, edhe pse me disa kufizime (garantimi i mbrojtjes juridike individuale).

Paditë mund të kenë si objekt çfarëdo mase të institucioneve dhe organeve të Bashkimit, të cilat kanë prodhuar efekte juridike detyruese që cenojnë interesat e kërkuesit, duke ia ndryshuar ndjeshëm pozitat juridike. Përveç Shteteve Anëtare, padi për anulim mund të paraqesin edhe Parlamenti Europian, Këshilli, Komisioni, Gjykata e Audituesve, Banka Qendrore Europiane dhe Komiteti i Rajoneve, me kusht që të kenë të bëjnë me shkeljen e të drejtave që u janë dhënë.

Shtetasit dhe ndërmarrjet mund të paraqesin padi për anulim vetëm për vendime që u janë adresuar personalisht atyre, ose për vendime adresuar të tjerëve, por me efekt të drejtpërdrejtë individual edhe mbi ta. Sipas Gjykatës

së Drejtësisë, i tillë është rasti kur një person preket në mënyrë kaq specifike saqë ai/ajo dallohet lehtësisht nga personat e tjerë apo ndërmarrjet. Ky kriter i “lidhjes së drejtpërdrejtë” shërben për të garantuar që në Gjykatën e Drejtësisë apo në Gjykatën e Përgjithshme të paraqiten çështje ku janë përcaktuar qartë si pozita juridike e cenuar e paditësit, ashtu si dhe vetë natyra e shkeljeve të pretenduara. Kriteri i “interesit individual” synon gjithashtu të shmangë paraqitjen e të ashtuquajturave “padi popullore”.

Nëse padia është e bazuar, Gjykata e Drejtësisë ose Gjykata e Përgjithshme mund ta deklarojnë aktin nul me efekt prapaveprues. Në rrethana të caktuara, mund ta deklarojë nul vetëm që nga data e shpalljes së vendimit. Megjithatë, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të paditësve, deklarimi i pavlefshmërisë mund të përjashtohet nga këto kufizime.

### **PADIA PËR MOSVEPRIM (NENI 265 I TFBE-së)**

Kjo padi plotëson mbrojtjen juridike përballë Parlamentit Europian, Këshillit Europian, Këshillit, Komisionit dhe Bankës Qendrore Europiane. Në procedurën paraprake, ankimesi fillimisht duhet të njoftojë institucionin që të përmbushë detyrën e tij. Në këtë padi kryesisht pretendohet që institucioni në fjalë ka shkelur Traktatin, duke neglizhuar miratimin e një akti juridik, pra të një vendimi, që është i detyruar ta bëjë. Kur padia paraqitet nga një shtetas apo ndërmarrje, padia pretendon se institucioni ka shkelur Traktatin duke marrë një vendim individual drejtuar shtetasit apo ndërmarrjes në fjalë. Vendimi përfundimtar thjesht konkludon që mosveprimi është i paligjshëm. Gjykata e Drejtësisë/Gjykata e Përgjithshme nuk ka kompetencë të urdhërojë marrjen e një vendimi: palës kundër të cilës jepet vendimi, thjesht i kërkohet të marrë masat që parashikon ekzekutimi i vendimit të Gjykatës (neni 266 i TFBE-së).

### **PADIA PËR DËMSPËRBLIM (NENET 268 DHE 340, PIKA 2 TË TFBE-së)**

Kjo padi u jep mundësinë jo vetëm shtetasve dhe ndërmarrjeve, por edhe Shteteve Anëtare, që kanë pësuar një dëm si pasojë e një gabimi të kryer nga stafi i BE-së, që të ngrej në padi në Gjykatën e Drejtësisë për dëmshpërblim. Këto kushte në lidhje me përgjegjësinë e BE-së nuk përcaktohen tërësisht nga Traktatet, prandaj në këto raste shpesh lind nevoja e zbatimit të parimeve

të përbashkëta të së drejtës që zbatohen në Shtetet Anëtare. Për ngritjen e kësaj padie dhe dhënien e një vendimi për dëmshperblim në këto raste, Gjykata ka kërkuar plotësimin e disa kushteve: (1) institucioni i BE-së ose një anëtar i stafit të tij duhet të ketë kryer një akt të paligjshëm gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj. Akti konsiderohet i paligjshëm kur ekziston një shkelje e rëndë e një norme të Bashkimit që u jep të drejta individëve, ndërmarrjeve apo Shteteve Anëtare, ose është miratuar në mbrojtje të tyre. Ligje që njihen për natyrën e tyre mbrojtëse, janë posacërsiht të drejtat dhe liritë themelore të tregut të brendshëm apo parimet themelore për mbrojtjen e pritsshmëriave të ligjshme dhe të proporcionalitetit. Shkelja konsiderohet mjaftueshmërisht e rëndë nëse institucioni ka tejkaluar ndjeshëm kufijtë e kompetencës së tij. Gjykata priret të kufizojë konstatimet në kategorinë më të vogël të njerëzve të cenuar prej shkeljes dhe në shkallën e dëmit të shkaktuar, i cili duhet të jetë në tejkallim të rrezikut tregtar që mund të parashikohej normalisht në sektorin respektiv të biznesit; (2) prani reale e dëmit; (3) duhet të ketë lidhje shkak-pasojë mes aktit të institucionit të Bashkimit dhe dëmit të pësuar; (4) nuk është e nevojshme të vërtetohet qëllimi apo pakujdesia.

### **PADI NGA STAFI I KOMUNITETIT (NENI 270 I TFBE-së)**

Mosmarrëveshje ndërmjet BE-së dhe punonjësve të saj ose familjarëve të tyre të gjallë në kuadër të marrëdhënieve të punës mund të paraqiten gjithashtu në Gjykatën e Drejtësisë. Kompetencën për këto padi e ka gjykata e specializuar për shërbimin civil, pranë Gjykatës së Përgjithshme.

### **KONFLIKTET LIGJORE PËR PATENTAT E BASHKIMIT (NENET 257 DHE 262 TFBE)**

Traktati i Nisës krijoi bazën ligjore për themelimin e një Gjykate të Bashkimit për Patentat. Kjo Gjykatë ende nuk është krijuar dhe do të ketë vendndodhjen pranë Gjykatës së Drejtësisë. Kompetenca e saj do të fokusohet në mosmarrëveshjet në sistemin e ardhshëm të patentave të Bashkimit. Në mënyrë të veçantë, Gjykata për Patentat do të shqyrtojë shkeljet dhe vlefshmërinë e patentave të Bashkimit. Ngritja e sistemit të patentave të Bashkimit synon ta bëjë më të lirë dhe më të lehtë mbrojtjen e shpikjeve të reja në të gjitha Shtetet Anëtare, përmes zbatimit të një procedure të vetme. Kështu, do të

eliminoheshin ëëdisavantazhet në procesin e konkurrimit, që i kanë vuajtur gjithnjë shpikësit europianë dhe njëkohësisht do të stimuloheshin investimet në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit.

### **PROCEDURA E APELIMIT (NENI 256, PIKA 2 I TFBE-së)**

Marrëdhënia ndërmjet Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme është konceptuar në mënyrë të tillë që të gjitha vendimet e kësaj të fundit të jenë objekt apelimi në Gjykatën e Drejtësisë për sa u përket vetëm çështjeve të interpretimit ligjor. Arsyet e këtij apelimi mund të jenë mungesa e kompetences së Gjykatës së Përgjithshme, parregullsi ëprocedurale që cenojnë interesat e palës apeluese apo shkelja e së Drejtës së Bashkimit nga Gjykata e Përgjithshme. Nëse apelimi është i justifikuar dhe pranohet për shqyrtim nga ana procedurale, Gjykata e Drejtësisë anulon vendimin e Gjykatës së Përgjithshme. Kur çështja është gati për gjykim, Gjykata e Drejtësisë e bën një gjë të tillë, përndryshe ajo ia kthen çështjen Gjykatës së Përgjithshme për të cilën vlerësimi ligjor i bërë nga Gjykata e Drejtësisë është i detyrueshëm.

Një sistem i ngjashëm ekziston mes gjykatave të specializuara dhe Gjykatës së Përgjithshme, ku kjo e fundit shqyrton vendimet e gjykatave të specializuara, duke vepruar në këtë rast si gjykate apeli. Vendimi (apelues) i Gjykatës së Përgjithshme mund të shqyrtohet nga Gjykata e Drejtësisë, por vetëm sipas disa kushteve të caktuara.

### **MBROJTJA JURIDIKE E PËRKOHSHME (NENET 278 DHE 279 TË TFBE-së)**

Paditë e paraqitura në Gjykatën e Drejtësisë apo në Gjykatën e Përgjithshme, si dhe apelimet e vendimeve të tyre, nuk kanë efekt pezullues. Megjithatë, mund të paraqitet kërkesë në Gjykatën e Drejtësisë ose Gjykatën e Përgjithshme për të nxjerre urdhër për pezullimin e aktit në fjalë (neni 278 i TFBE-së) ose për marrjen e masave të përkohshme (neni 279 i TFBE-së).

Gjykatat e vlerësojnë kërkesën për masa të përkohshme, duke patur parasysh tre kriteret: (1) mundësinë e pranimit të kërkesës për themelin e çështjes (fumus boni juris): gjykata e vlerëson këtë mundësi në një shqyrtim paraprak të argumenteve që ka paraqitur apeluesi; (2) natyrën urgjente të masës: kjo

varet nga fakti nëse masa e kërkuar është e nevojshme për të shmangur një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm. Kriteret që zbatohen për një vlerësim të tillë janë natyra dhe rëndësia e shkeljes së kryer, si dhe efektet specifike negative të pakthyeshme që pëson prona apo të mira të tjera të apeluesit; kushti bazë që humbjet financiare të konsiderohen me natyrë të rëndë dhe të pakthyeshme, është pamundësia e rikuperimit të plotë, edhe kur apeluesi e fiton çështjen; (3) ponderimi i interesave: peshohen efektet negative që kërcënojnë apeluesin nga refuzimi i një mase provizore, kundrejt interesit të BE-së për të zbatuar menjëherë masën, si dhe kundrejt dëmeve që miratimi i kësaj mase të përkohshme mund të shkaktojë për palët e treta.

### **VENDIMI PARAGJYKIMOR (NENI 267 I TFBE-së)**

Me këtë procedurë, gjykatat kombëtare i kërkojnë Gjykatës së Drejtësisë orientim për të Drejtën e Bashkimit. Kur në kuadër të një çështjeje, gjykatës kombëtare i kërkohet të zbatojë dispozita të së Drejtës së Bashkimit, ajo mund ta pezullojë procedimin dhe t'i kërkojë Gjykatës së Drejtësisë qartësime për vlefshmërinë e një akti juridik të Bashkimit dhe/ose interpretimin e këtij akti apo të Traktateve. Gjykata e Drejtësisë merr vendim për themelin e çështjes dhe nuk jep vendim këshillimor; kjo shpreh karakterin detyrues të vendimit të saj. Procedura për vendim paragjykimor, ndryshe nga procedurat e tjera të përmendura më sipër, nuk është procedurë e debatueshme, por është thjesht një fazë në procedim që fillon dhe mbaron në gjykatat kombëtare.

Objektivi i kësaj procedure është të garantojë interpretim uniform të së drejtës së Bashkimit, dhe kësaj, uniformitetin e rendit juridik të BE-së. Përveç këtij funksioni të fundit, kjo procedurë është me rëndësi edhe për mbrojtjen e të drejtave vetjake. Gjykatat kombëtare mund të vlerësojnë vetëm përputhshmërinë e së Drejtës së brendshme me të drejtën e Bashkimit, dhe në rast të ndonjë konflikti, të zbatojnë të Drejtën e Bashkimit, e cila ka përparësi dhe është drejtpërdrejt e zbatueshme, me kusht që përmbajtja dhe objekti i dispozitave të Bashkimit të jenë të përcaktuara qartë. Si rregull, vetëm vendimi paragjykimor i Gjykatës së Drejtësisë mund ta garantojë këtë qartësi. Në këtë mënyrë, i jepet edhe shtetasit të Bashkimit mundësia që të padisë Shtetin e vet Anëtar për veprime që bien në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit dhe të arrijë zbatimin e të Drejtës së Bashkimit nga gjykatat kombëtare. Ky funksion i dyfishtë i vendimit paragjykimor kompenson në njëfarë mase mundësitë



e pakta që i ofrohen shtetasit për t'iu drejtuar drejtpërsëdrejti Gjykatës së Drejtësisë, duke fituar kështu një rëndësi themelore për mbrojtjen juridike të individit. Sidoqoftë, suksesi i kësaj procedure varet nga “gatishmëria” e gjyqtarëve dhe gjykatave kombëtare për t'ia përcjellë çështjen një autoriteti më të lartë.

*Objekti:* Gjykata e Drejtësisë vendos në lidhje me interpretimin e akteve juridike të Bashkimit dhe shqyrton vlefshmërinë e akteve me peshë juridike të institucioneve të Bashkimit. Dispozitat e të Drejtës së brendshme nuk mund të jenë objekt i një vendimi paragjykimor. Në procedurën për vendim paragjykimor, Gjykata e Drejtësisë nuk ka kompetencë të interpretojë të Drejtën e brendshme, as të vlerësojë përputhshmërinë e saj me të Drejtën e Bashkimit. Ky aspekt shpesh anashkalohet në kërkesat që i drejtohen Gjykatës së Drejtësisë, kur i kërkohet të shqyrtojë përputhshmërinë e dispozitave të të drejtës së brendshme me të drejtën e Bashkimit, apo zbatueshmërinë e një dispozite specifike të së drejtës së Bashkimit në një çështje që është në shqyrtim nga një gjykatë kombëtare. Edhe pse këto kërkesa janë të papranueshme nga ana procedurale, Gjykata e Drejtësisë nuk ua kthen mbrapsht gjykatave kombëtare; përkundrazi, ajo e interpreton pyetjen drejtuar asaj si një kërkesë nga gjykata që e drejton, me qëllim që Gjykata e Drejtësisë të përcaktojë kriteret bazë apo themelore për interpretimin e dispozitave juridike të Bashkimit, në mënyrë të tillë që t'iu mundësojë gjykatave të vlerësojnë vetë përputhshmërinë mes të drejtës së brendshme me atë të Bashkimit. Gjykata e Drejtësisë ndjek këtë procedurë: shkëput nga tërë dokumentacioni i paraqitur - kryesisht arsyet për referimin e çështjes- ato elemente të të drejtës së Bashkimit që duhen interpretuar në funksion të çështjes gjyqësore në fjalë.

Autoriteti për të filluar procedurën: këtë procedurë mund ta ndjekin të gjitha “gjykatat e Shteteve Anëtare”. Koncepti i gjykatës duhet interpretuar në kuptimin e së Drejtës së Bashkimit dhe përqendrohet jo thjesht tek emri, por tek funksioni dhe pozita e një instance gjyqësore në sistemin e mbrojtjes juridike të Shtetit Anëtar. Mbi këtë bazë, me “gjykatë” kuptohen të gjitha institucionet e pavarura (d.m.th. që nuk marrin udhëzime) të ngarkuara me ligj, që të zgjidhin sipas ligjit mosmarrëveshjet në një shtet kushtetues. Sipas këtij përkufizimi, autoritetin për të referuar kërkesa për vendim paragjykimor e kanë edhe gjykatat kushtetuese në Shtetet Anëtare, si dhe autoritetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që nuk bëjnë pjesë në sistemin gjyqësor shtetëror, me përjashtim të gjykatave private të arbitrazhit. Për të bërë ose jo

kërkesë për vendim paragjykimor në Gjykatën e Drejtësisë, gjykata kombëtare vendos nëse e drejta e Bashkimit ka lidhje me çështjen që ka në gjykim. Palët mundën vetëm t'i propozojnë, dhe jo t'i kërkojnë gjykatës kombëtare që t'i dërgojë çështjen Gjykatës së Drejtësisë. Gjykata e Drejtësisë gjykon rëndësinë e çështjes vetëm për të vendosur nëse kërkesa/referimi është e pranueshme (d.m.th. nëse kërkesa ka të bëjë me interpretimi e Traktateve të Bashkimit apo me ligjshmërinë juridike të një akti të një institucioni të Bashkimit), apo që bëhet fjalë për një problem të qartë me karakter juridik (d.m.th. Gjykata e Drejtësisë sigurohet që çështjet për të cilat duhet të japë opinionin e vet juridik në vendimin paragjykimor, nuk janë hipotetike dhe nuk kanë të bëjnë me dispozita për të cilat është shprehur më parë). Nisur nga rëndësia e veçantë e bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore, rrallë ndodh që Gjykata të refuzojë shqyrtimin e një kërkesë për këto arsye dhe i zbaton këto kritere disi "me dorë të lehtë". Por, vendimet e kohëve të fundit të Gjykatës tregojnë që është bërë më "e shtrënguar" me kriteret e pranimit të kërkesave, duke zbatuar me rigozitet kushtin që kërkesa duhet të përmbajë përshkrim mjaftueshëm të qartë dhe të hollësishëm të sfondit faktik dhe juridik të procedurës fillestare; në mungesë të këtij informacioni, Gjykata deklaron pamundësinë për të bërë interpretimin e duhur të së drejtës së Bashkimit dhe e refuzon kërkesën për vendim paragjykimor si të papranueshme.

*Detyrimi për referim:* çdo gjykatë kombëtare, kundër vendimit të së cilës nuk ka zgjidhje gjyqësore me legjislacionin e brendshëm, është e detyruar të bëjë referim. E drejta e apelimit përfshin të gjitha format e zgjidhjes ligjore me të cilën një vendim gjykatë mund të rishikohet për elementet e faktit apo të së drejtës (apeli) ose vetëm të së drejtës (apelim për çështje të interpretimit ligjor). Por ky koncept nuk përfshin zgjidhje ligjore të zakonshme e efekte të kufizuara e specifike (p.sh. procedim të ri, ankesë kushtetuese). Gjykata e detyruar të referojë një çështje, mund t'i shmangët këtij detyrimi vetëm nëse çështja e kërkesës për vendim paragjykimor nuk ka asnjë rëndësi materiale, sido që të jetë vendimi që mund të jepej; nëse ka pasur vendim të Gjykatës së Drejtësisë për një kërkesë të tillë; nëse pyetja nuk ka rëndësi për rezultatin e çështjes përpara saj; ose nëse pyetja ka marrë tashmë një përgjigje nga Gjykata e Drejtësisë ose nuk ka dyshime të arsyeshme në lidhje me interpretimin e së Drejtës së Bashkimit. Megjithatë, detyrimi për referim është i pakushtëzuar nëse bëhet fjalë për vlefshmërinë e një instrumenti të Bashkimit. Gjykata e Drejtësisë e ka përcaktuar qartë se vetëm ajo ka kompetencë për të shfuqizuar

dispozitat e kundërligjshme të së drejtes së Bashkimit. Për rrjedhojë, gjykatat kombëtare duhet të zbatojnë dhe të respektojnë dispozitat e Bashkimit derisa Gjykata e Drejtësisë të deklarojë pavlefshmërinë e tyre. Përjashtim bëjnë gjykatat që shqyrtojnë dhënien e mbrojtjes së përkohshme juridike. Sipas jurisprudencës më të fundit të Gjykatës, në rrethana të caktuara këto gjykata mund, të pezullojnë zbatimin e një akti administrativ të brendshëm të bazuar në një rregullore të Bashkimit, ose të miratojnë masa të përkohshme me qëllim që të përcaktojnë përkohësisht rregullime të marrëdhënieve juridike, pa marrë në konsideratë një dispozitë të caktuar të së Drejtës së Bashkimit.

Mospërmbushja e detyrimit për referim përbën shkelje të Traktateve të Bashkimit dhe mund të shkaktojë fillimin e një procedure dëmshpërblimi kundër Shtetit Anëtar. Por pasojat praktike të këtij veprimi janë shumë të kufizuara, pasi qeveria e Shtetit Anëtar në fjalë nuk mund të respektojë çdo vendim të Gjykatës së Drejtësisë, sepse nuk mund të urdhërojë gjykatat kombëtare për shkak të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe parimit të ndarjes së pushteteve. Nga momenti kur njihet parimi i përgjegjësisë kontraktuale të Shtetit Anëtar për shkelje të së drejtës së Bashkimit (shih kapitullin pasardhës), individët që ngrenë padi për dëmshpërblim kundër Shtetit Anëtar në fjalë për mospërmbushje të detyrimit për referim, kanë më shumë mundësi për ta fituar çështjen.

*Efekt:* Vendimi paragjykimor, në formën e një urdhri gjykatë, është drejtpërdrejt detyrues për gjykatën referuese dhe të gjitha gjykatat e tjera që shqyrtojnë të njëjtën çështje. Për më tepër, ky vendim paragjykimor në praktikë ka statusin e precedentit.

## **PËRGJEGJËSIA E SHTETIT ANËTAR PËR SHKELJE TË SË DREJTËS SË BASHKIMIT**

Përgjegjësia e një Shteti Anëtar për dëmin e shkaktuar ndaj individëve nga shkelja e së Drejtës së Bashkimit u përcaktua për herë të parë në parim nga Gjykata e Drejtësisë në vendimin e saj të 5 marsit 1996, në Çështjet e bashkuara C-46/93 Brasserie du pêcheur dhe C-48/93 Factortame. Ashtu si vendimet e mëparshme të Gjykatës, ky vendim vendosi precedentin për përparësinë e së Drejtës së Bashkimit, për zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të dispozitave të së Drejtës së Bashkimit dhe për njohjen e të drejtave themelore të Bashkimit. Siç e përcakton edhe vetë Gjykata, e drejta për dëmshpërblim përbën “rezultatit

e nevojshëm të efektit të drejtpërdrejtë të dispozitave Komunitare, shkelja e të cilave shkakton dëmin e pësuar” dhe rrit ndjeshëm mundësitë që i ofrohen individit për të detyruar organet shtetërore (legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin) të respektojnë dhe të zbatojnë të drejtën e Bashkimit. Vendimi në fjalë është zhvillim i mëtejshëm i jurisprudencës së ëësaj të shprehur në çështjet Francovich dhe Bonifaci. Deri atëherë, përgjegjësia e Shteteve Anëtare kufizohej vetëm në rastet ku individët pësonin dëme për shkak të transpozimit të vonuar të një direktive që u jepte të drejta personale, por jo drejtpërdrejt e adresuar ndaj tyre; vendimi i cituar ëvendosi parimin e “përgjegjësisë së përgjithshme”, që përfshin çdo shkelje të së Drejtës së Bashkimit që i ngarkohet Shtetit.

## **PËRGJEGJËSIA E SHTETEVE ANËTARE PËR AKTE JURIDIKE DHE PËR MOSVEPRIM**

Përgjegjësia është e tillë kur janë të pranishëm tre kritere të zbatueshme në Bashkimin Europian për situata të ngjashme:

- (1) qëllimi i dispozitës së Bashkimit që është shkelur, duhet të jetë dhënia e të drejtave individit;
- (2) shkelja duhet të jetë mjaftueshëm e rëndë, d.m.th. duhet të jetë e qartë që Shteti Anëtar ka tejkaluar ndjeshëm kompetencat e tij. Kjo gjë vendoset nga gjykatat kombëtare që janë të vetmet autoritete kompetente për të konstatuar faktet dhe për të vlerësuar sa të rënda janë shkeljet e së Drejtës së Bashkimit. Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë u ofron gjykatave kombëtare një sërë orientimesh bazë:

“ Faktorët që gjykata kompetente mund të marrë në konsideratë përfshijnë shkallën e qartësisë dhe saktësisë së rregullit të shkelur, fushën e kompetencave që ky rregull u rezervon autoriteteve kombëtare apo Komunitare, natyrën e qëllimshme ose të paqëllimshme të shkeljes së kryer apo dëmit të shkaktuar, natyrën e justifikueshme apo jo të një gabimi në ligj, faktin që qëndrimi i një institucioni të Komunitetit mund të ketë kontribuar në mosveprim, si dhe miratimin për vazhdimin e përdorimit të masave apo praktikave kombëtare në kundërshtim me të drejtën Komunitare. Në çdo rast, shkelja e së drejtës Komunitare konsiderohet mjaftueshëm e rëndë

kur vazhdon pavarësisht prej një vendimi që e konstaton shkeljen e kryer, i një vendimi paragjykimor ose i jurisprudencës së Gjykatës për çështjen, nga e cila është e qartë se sjellja në fjalë përbën shkelje.

- (3) duhet të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë rastësore mes shkeljes së detyrimit të Shtetit Anëtar dhe dëmit të shkaktuar për palën e dëmtuar. Nuk është e nevojshme të argumentohet fajë (me paramendim apo nga pakujdesia), por vetëm shkelja mjaft e rëndë e së Drejtës së Bashkimit.

### **PËRGJEGJËSIA E GJYKATAVE PËR SHKELJE TË SË DREJTËS SË BASHKIMIT**

Gjykata e Drejtësisë është shprehur qartë se parimet e përgjegjësisë vlejné edhe për pushtetin e tretë, d.m.th. pushtetin gjyqësor. Vendimet e tij tashmë janë jo vetëm objekt rishikimi në instancat e ndryshme të apelit, por nëse janë marrë duke shpërfillur ose në shkelje të së Drejtës së Bashkimit, ato mund të jenë objekt padie për dëmshpërblim në gjykatat kompetente të Shteteve Anëtare. Verifikimi i fakteve të vendimit gjyqësor që pretendohet se shkel të Drejtën e Bashkimit duhet të marrë parasysh edhe aspektet thelbësore të së Drejtës së Bashkimit. Por gjykata kompetente nuk mund të marrë në konsideratë efektet detyruese të vendimit të gjykatës së specializuar, së cilës i referohet çështja. Gjykatat kombëtare kompetente duhet t'i referojné vetëm Gjykatës së Drejtësisë kërkesa për interpretimin dhe/ose vlefshmërinë e dispozitave të Bashkimit, si dhe për përputhshmërinë e regjimeve kombëtare me të drejtën e Bashkimit, kërkesa të cilat duhet të referohen në kuadrin e procedurës për vendim paragjykimor (neni 267 i TFBE-së).

Megjithatë, përgjegjësia e shkeljes përmes një vendimi gjyqësor mbetet përjashtim. Bazuar në kritere strikte, ëëprania e përgjegjësisë mund të shqyrtohet vetëm nëse gjykata shpërfill me vetëdije të Drejtën e Bashkimit, ose, si në çështjen Köbler, një gjykatë e instancës së fundit, në shkelje të së Drejtës së Bashkimit, i jep fuqi juridike një vendimi që është në dëm të individit, pa i kërkuar paraprakisht Gjykatës së Drejtësisë të interpretojë të Drejtën e Bashkimit që në rastin konkret është me rëndësi për vendimin. Në rastin e fundit, në mbrojtje të të drejtave të shtetasve të Bashkimit që përdorin të drejtën e Bashkimit, është thelbësore që ata të shpërblehen për dëmin e shkaktuar nga një gjykatë e instancës së fundit.

# Vendi i së Drejtës së Bashkimit në raport me rendin juridik në tërësi

Pas gjithë asaj që kemi mësuar për strukturën e BE-së dhe kuadrin e saj ligjor, nuk është e lehtë që së Drejtës së Bashkimit t'i jepet vendi që i takon në rendin juridik në tërësi dhe të përcaktohen kufijtë ndërmjet atij dhe rendeve të tjera juridike. Dy qasje të mundshme për ta klasifikuar atë, duhet të mënjanojnë që në fillim. E drejta e Bashkimit as nuk duhet të konceptohet si një përmbledhje e thjeshtë e marrëveshjeve ndërkombëtare, as nuk mund të shihet si pjesë apo shtesë e sistemeve kombëtare ligjore.

## **AUTONOMIA E RENDIT JURIDIK TË BE-SË**

Shtetet Anëtare, me krijimin e Bashkimit, kanë kufizuar sovranitetin e tyre legjislativ dhe në këtë mënyrë kanë krijuar një tërësi të pavarur të legjislacionit që është i detyrueshëm për ata, për shtetasit e tyre dhe për gjykatat e tyre.

Një nga çështjet më të njohura në Gjykatën e Drejtësisë është Costa kundër ENEL në vitin 1964. Z. Costa depozitoi një padi kundër shtetëzimit të prodhimit, shpërndarjes së energjisë dhe transferimit vijues të biznesit të kompanive të mëparshme të energjisë tek ENEL, që ishte korporata e re publike.

Autonomia e rendit juridik të BE-së ka domethënie thelbësore për natyrën e BE-së, sepse është e vetmja garanci që e Drejta e BE-së nuk do të nënvlerësohet nga ndërveprimi me të Drejtën kombëtare dhe që do të zbatohet njësoj në të gjithë Bashkimin. Kjo është arsyeja pse koncepte të së Drejtës së Bashkimit interpretohen vetëm nga këndvështrimi i qëllimeve të rendit juridik të BE-së dhe të Bashkimit në përgjithësi. Ky interpretim specifik i Bashkimit është i domosdoshëm, sepse të drejta të veçanta sigurohen nga e drejta e Bashkimit, dhe pa atë ato do të rrezikoheshin për shkak se çdo Shtet Anëtar, duke interpretuar dispozitat në mënyra të ndryshme, do të vendoste në mënyrë individuale për thelbin e lirive që supozohet se i garanton e drejta

e Bashkimit. Një shembull për këtë është koncepti i një ‘punonjësi’, mbi të cilin bazohet i gjithë koncepti i lirisë së lëvizjes. Koncepti specifik i Bashkimit për punëtorin ka shumë mundësi që të shmanget nga konceptet që janë të njohura dhe që zbatohen në rendet juridike të Shteteve Anëtare. Gjithashtu, i vetmi standard me të cilin maten instrumentet ligjore të Bashkimit është vetë e drejta e Bashkimit dhe jo e drejta kombëtare apo e drejta kushtetuese.

Kundrejt këtij koncepti të autonomisë së rendit juridike të BE-së, cila është marrëdhënia ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe së Drejtës kombëtare?

Edhe nëse e drejta e Bashkimit përbën një rend juridik që është i pavarur në lidhje me rendet juridike të Shteteve Anëtare, kjo situatë nuk duhet të konsiderohet si e tillë ku rendi juridik i BE-së dhe sisteme juridike të Shteteve Anëtare mbivendosen tek njëri-tjetri. Fakti që janë të zbatueshme për të njëjtët njërëz, të cilët janë njëkohësisht qytetarë të një Shteti dhe të BE-së, bën të pamundur një ndarje të tillë të prerë të këtyre rendeve juridike. Së dyti, kjo qasje nuk merr parasysh faktin që e drejta e Bashkimit mund të bëhet funksionale vetëm nëse është pjesë e rendeve juridike të Shteteve Anëtare. E vërteta është që rendi juridik i BE-së dhe rendet juridike kombëtare janë të ndërthurura dhe të ndërvarura mes tyre.

## **NDËRVEPRIMI NDËRMJET SË DREJTËS SË BASHKIMIT DHE SË DREJTËS KOMBËTARE**

Ky aspekt i marrëdhënies ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe së Drejtës kombëtare mbulon ato fusha ku këto dy sisteme plotësojnë njëri-tjetrin. Neni 4(3) i TBE-së është mjaft i qartë:

“ Në bazë të parimit të bashkëpunimit të sinqertë, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare, në respektim të ndërsjellë, të ndihmojnë njëri tjetrin në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga Traktatet. Shtetet Anëtare marrin masat e duhura, të përgjithshme ose të posaçme, për të siguruar plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet ose nga aktet e institucioneve të Bashkimit. Shtetet Anëtare mundësojnë arritjen e detyrave të Bashkimit dhe heqin dorë nga çdo masë, e cila do të vinte në rrezik arritjen e objektivave të Bashkimit.

Ky parim i përgjithshëm i bashkëpunimit të sinqertë u frymëzua nga ndërgjegjësimi që rendi juridik i BE-së në vetvete, nuk është në gjendje të realizojë objektivat e ndjekur me krijimin e BE-së. Rendi juridik i BE-së,

ndryshe nga rendi juridik kombëtar, nuk është sistem i pavarur, por bazohet në mbështetjen e sistemeve kombëtare për funksionimin e tij. Prandaj të tri degët e qeverisë- legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori- duhet të pranojnë që rendi juridik i BE-së nuk është sistem ‘i huaj’ dhe që Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit kanë krijuar hallka të pazgjidhshme ndërmjet tyre, me qëllim që të arrijnë objektivat e përbashkëta. BE-ja nuk është vetëm një komunitet i interesave; është një komunitet i bazuar në solidaritet. Nga kjo rezulton që autoritetet kombëtare kërkohet jo vetëm të respektojnë traktatet e Bashkimit dhe legjislacionin dytësor; ato duhet gjithashtu që ta zbatojnë atë dhe ta venë në praktikë. Ndërveprimi ndërmjet dy sistemeve është i shumanshëm. Kjo mund të ilustruhet edhe me ëshembujë.

Shembulli i parë, sesi rendi juridik i BE-së dhe ai kombëtar ndërthuren dhe plotësojnë njëri-tjetrin është direktiva e analizuar tashmë në kapitullin për legjislacionin. Gjithçka që vetë direktiva përcakton me terma të detyrueshme, është rezultati që duhet arritur nga Shteti Anëtar; u takon Shteteve Anëtare nëpërmjet autoriteteve kombëtare të vendosin si dhe me çfarë mënyre do të arrihet në fund rezultati. Në fushën e gjyqësorit, dy sistemet ndërthuren përmes procedurës së vendimmarrjes paragjykimore të përmendur në nenin 267 të TFBE, sipas të cilës gjykatat kombëtare mund ose ndonjëherë duhet t'i drejtojnë Gjykatës së Drejtësisë pyetje për interpretimin dhe vlefshmërinë e së Drejtës së Bashkimit; vendimet e gjykatës mund të jenë vendimtare për zgjidhjen e konfliktit. Dy gjëra janë të qarta: së pari, gjykatave në Shtetet Anëtare u kërkohet të respektojnë dhe të zbatojnë të drejtën e Bashkimit; dhe së dyti, interpretimi i së Drejtës së Bashkimit dhe deklarata për vlefshmërinë e saj janë detyrë vetëm e Gjykatës së Drejtësisë. Ndërvarësia e së Drejtës së BE-së dhe të drejtës kombëtare ilustruhet më tej me atë që ndodh kur duhet të plotësohen boshllëqet në të Drejtën e BE-së: E Drejta e BE-së mund të referohet normave ekzistuese të së Drejtës kombëtare për të plotësuar normat që përcakton ajo vetë. Ky parim vlen për të gjithë gamën e detyrimeve sipas së Drejtës së Bashkimit, përveç rasteve kur kjo e fundit ka përcaktuar rregulla për zbatimin e tij. Në çdo rast të tillë, autoritetet kombëtare zbatojnë të Drejtën e Bashkimit me dispozitat e sistemeve të tyre juridike. Por parimi i nënshtrohet një kushti: duhet të ruhet zbatimi uniform i së Drejtës së Bashkimit, sepse do të ishte tërësisht e papranueshme që shtetasit dhe sipërmarrjet të gjykohen bazuar në kritere të ndryshme – duke u trajtuar kështu padrejtësisht.





1 Mars 2004.

Një grua vizaton me shkurtese se si do të duket harta e Europës në 1 janar 2007.

## **KONFLIKTI NDËRMJET SË DREJTËS SË BASHKIMIT DHE SË DREJTËS KOMBËTARE**

Sidoqofte, raporti ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe të Drejtës kombëtare karakterizohet edhe nga fakti se herë pas here ato qëndrojnë edhe në pozita diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën. Me këtë rast shpeshherë flitet edhe për një farë kolizioni apo ‘përplasje’ mes së Drejtës së Bashkimit dhe së drejtës kombëtare. Situata të tilla krijohen gjithnjë kur një dispozitë e legjislacionit të Bashkimit, vendos drejtpërsëdrejti të drejta dhe detyrime mbi qytetarin e Bashkimit, në një kohë që përmbajtja e këtij akti bie në kundërshtim me një normë të caktuar të së Drejtës kombëtare. Çështja kryesore pas këtij problemi në dukje të thjeshtë janë dy pyetje qendrore që qëndrojnë në themelet e vetë BE-së, përgjigja e të cilave ka të bëjë me vetë ekzistencën e rendit juridik të BE-së, konkretisht me zbatimin e drejtpërdrejtë të së Drejtës së Bashkimit dhe me përparësinë e së Drejtës së Bashkimit mbi normat e së Drejtës kombëtare që bien në kundërshtim me te.

## **ZBATIMI I DREJTPËRDREJTË I TË DREJTËS SË BASHKIMIT NË TË DREJTËN KOMBËTARE**

Së pari, parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë do të thotë thjeshtë që e drejta e Bashkimit jep të drejta dhe cakton detyrime drejtpërdrejt jo vetëm ndaj institucioneve të Bashkimit dhe Shteteve Anëtare, por edhe ndaj qytetarëve të Bashkimit.

Një nga arritjet më të rëndësishme të Gjykatës së Drejtësisë është fakti se ajo e ka zbatuar këtë parim të së Drejtës së Bashkimit pavarësisht kundërshtive që kishin në fillim disa Shtete Anëtare, duke garantuar kështu vetë ekzistencën e rendit juridik të BE-së. Praktika e saj gjyqësore në këtë drejtim filloi me një çështje mjaft të përmendur tashmë, konkretisht me çështjen e firmës holandeze të transportit Van Gend & Loos. Kjo firma ngriti padi përpara një gjykate holandeze kundër autoriteteve doganore që i vendosën asaj detyrime të larta doganore mbi një produkt kimik të importuar nga Republika Federale e Gjermanisë. Në analizë të fundit, rezultati i kësaj çështjeje varej nga pyetja nëse edhe individët mund të bazohen në nenin 12 të Traktatit KEE-së, i cili, brenda Tregut të Përbashkët, ndalon në mënyrë të shprehur vendosjen e detyrimeve të reja apo rritjen e detyrimeve ekzistuese nga Shtetet Anëtare. Pavarësisht nga mendimet e shfaqura nga shumë qeveri apo dhe Avokati i Përgjithshëm në këtë

proces, Gjykata vendosi që nisur nga natyra dhe objektivi i Bashkimit, dispozitat e legjislacionit të Bashkimit duhet të ishin direkt të zbatueshme në të gjitha çështjet. Gjykata, në arsyetimin e vendimit të saj, u shpreh që:

“...Komuniteti përbën një rend të ri juridik....subjektet e të cilit nuk janë vetëm Shtetet Anëtare, por edhe shtetasit e tyre. Pavarësisht nga legjislacioni i Shteteve Anëtare, e drejta komunitare jo vetëm që vendos detyrime ndaj individëve, por synon gjithashtu që t’ju japë atyre të drejta. Këto të drejta lindin jo vetëm kur janë dhënë shprehimisht nga Traktati, por edhe nëpërmjet detyrimeve që vendos Traktati në mënyrë të përcaktuar qartë mbi individët, ashtu si edhe mbi Shtetet Anëtare dhe mbi institucionet e Komunitetit’.

Megjithatë, ky deklaram i guximshem i Gjykatës nuk na shpie shumë larg, pasi mbetet për t’u përgjigjur pyetjes se cilat dispozita të legjislacionit të Bashkimit janë direkt të zbatueshme. Fillimisht, Gjykata e mori në konsideratë përgjigjen e kësaj pyetje vetëm në raport me legjislacionin primar të Bashkimit, duke u shprehur se për individet, mund të jenë direkt të zbatueshme të ëgjitha ato dispozitave të Traktateve të Bashkimit që (i) vendosin kushte absolute, (ii) janë të plota në vetvete dhe të pavarura në afate ligjore dhe prandaj (iii) nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtejshëm nga Shtetet Anëtare ose institucionet e Bashkimit, në mënyrë që të respektohen apo të marrin fuqi ligjore.

Gjykata vendosi që ish-neni 12 i KEE-së i plotëson këto kriteret dhe që, për rrjedhojë, firma Van Gend & Loos mund të përfitonte të drejta, të cilat gjykata hollandeze duhet ti merrte parasysh. Mbi këtë bazë, gjykata holandeze i bëri të pavlefshme detyrimet e rritura doganore duke i konsideruar si në kundërshtim me Traktatin. Në vijim, Gjykata e Drejtësisë vazhdoi të zbatojë këtë arsyetim edhe për dispozita të tjera të Traktatit të KEE-së, që kanë për qytetarët e Bashkimit rëndësi edhe më të madhe se neni 12 . Vendimet që janë veçanërisht të rëndësishme për t’u përmendur në këtë drejtim, kanë të bëjnë me zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave për lirinë e lëvizjes (Neni 45 TFBE), lirinë e vendosjes (Neni 49, TFBE) dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve (neni 56,TFBE).

Lidhur me garancitë për lirinë e lëvizjes, Gjykata e Drejtësisë mori një vendim që i shpallte ato direkt të zbatueshme në çështjen Van Duyn. Faktet e kësaj çështjeje ishin si më poshtë: Në maj 1973 Zonjës Van Duyn, një shtetase holandeze iu refuzua leja për të hyrë në Mbretërinë e Bashkuar për

të filluar punë si sekretare tek një Kishë e Sajentologjisë (Scientology), një kishë që konsiderohej nga Ministria e Brendshme britanike si “shoqërisht e rrezikshme”. Zonja Van Duyn, duke u bazuar në rregullat e Bashkimit për lirinë e lëvizjes për punëtorët, ngriti një padi përpara Gjykatës së Lartë, me të cilën kërkoi t'i jepej e drejta të qëndronte në Mbretërinë e Bashkuar për qëllim punësimi dhe t'i jepej leje për të hyrë në Mbretërinë e Bashkuar. Në përgjigje të pyetjes që Gjykata e Lartë i kishte drejtuar Gjykatës së Drejtësisë, kjo e fundit arriti në përfundimin që neni 48 i Traktatit të KEE-së (neni 45 TFBE) është drejtpërsëdrejti i zbatueshëm, duke i dhënë kështu individëve të drejta që janë të zbatueshme përpara gjykatave të një Shteti Anëtar.

Gjykatës së Drejtësisë iu kërkua nga Conseil d'Etat (Këshilli i Shtetit) belg të shprehej për zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të dispozitave që garantojnë lirinë e vendosjes. Conseil d'Etat duhej të vendoste për një padi të ngritur nga një avokat holandez, J. Reyners, i cili donte të realizonte të drejtat e tij sipas nenit 52 të Traktatit të KEE-së (Neni 49 TFBE). Z. Reyners u ndje i detyruar të ngrinte padi, pasi pretendonte se i ishte mohuar ushtrimi i profesionit të juristit në Belgjikë, me arsyetimin se ishte shtetas i huaj, pavarësisht faktit që ai kishte dhënë provimet e provimet e nevojshme në Belgjikë. Në vendimin e saj të 21 korrikut 1974, Gjykata u shpreh që trajtimi i pabarabartë i shtetasve dhe të huajve në lidhje me vendosjen, nuk mund të vazhdonte më tej, pasi neni 52 i Traktatit të KEE-së kishte qenë direkt i zbatueshëm që me mbarimin e periudhës kalimtare, dhe për këtë arsye i jepte të drejta qytetareve të Bashkimit të fillonin dhe ushtronin një punë të caktuar në një Shtet tjetër Anëtar, njësoj si shtetas e këtij Shteti. Per pasojë, sipas këtij vendimi, z. Reyners duhej të lejohej të ushtronte profesionin e juristit në Belgjikë.

Në çështjen Van Binsbergen, Gjykatës së Drejtësisë iu dha mundësia të përcaktonte në mënyrë specifike zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave lidhur me lirinë për të ofruar shërbime. Në këtë çështje, mes të tjerash shtrohej pyetja nëse një dispozitë ligjore hollandeze, që përcaktonte se ëëvetëm persona që banonin në Hollandë kishin të drejtë të ishin përfaqësues ligjorë në Gjykatën e Apelit, ishte ose jo nëpajtim me normat e Bashkimit që garantojnë lirinë për të ofruar shërbime. Gjykata vendosi se kjo normë nuk ishte në përputhje me normat e Bashkimit, pasi të gjitha kufizimet të cilave duhet t'u nënshtrohen shtetasit e Bashkimit për shkak të shtetësisë ose vendit të banimit, shkelin nenin 59 të Traktatit të KEE (Neni 56 i TFBE), dhe prandaj janë të pavlefshme.

Gjithashtu, me rëndësi të madhe praktike është njohja e parimit të zbatimit të drejtëpërdrejtë të dispozitave për lirinë e lëvizjes së mallrave (Neni 41 TFBE), parimi i shpërblimit të barabartë për burrat dhe gratë (neni 157, TFBE), ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit (neni 25 TFBE) dhe liria e konkurrencës (neni 101 TFBE). Në lidhje me legjislacionin dytësor, çështja e zbatimit të drejtëpërdrejtë shtrohet vetëm në raport me direktivat dhe vendimet drejtuar Shteteve Anëtare, meqenëse zbatimi i drejtëpërdrejtë për rregulloret dhe vendimeve që iu drejtohen individëve, përcaktohet tashmë nga Traktatet e Bashkimit (Neni 288(2) dhe (4) TFBE). Që nga viti 1970, Gjykata e ka shtrirë parimin e zbatimit të drejtëpërdrejtë edhe për dispozitat e direktivave dhe vendimeve që iu drejtohen Shteteve Anëtare.

Rëndësia praktike e zbatimit të efektit të drejtëpërdrejtë të së Drejtës së Bashkimit në formën përmes së cilës ajo është zbatuar dhe përsosur nga Gjykata e Drejtësisë, duhet vlerësuarëëëë. Kështu përmirësohet pozicioni i individit, duke kthyer liritë e tregut të përbashkët në të drejta që mund të zbatohen nga gjykatat kombëtare. Prandaj, efekti i drejtëpërdrejtë i së Drejtës së Bashkimit, është një nga shtyllat e rendit juridik të BE-së.

## **EPËRSIA E SË DREJTËS SË BASHKIMIT MBI TË DREJTËN KOMBËTARE**

Zbatimi i drejtëpërdrejtë e dispozitave të legjislacionit të Bashkimit çon në një pyetje të dytë po aq themelore: çfarë ndodh nëse një dispozitë e legjislacionit të Bashkimit përcakton të drejta dhe detyrime të drejtëpërdrejta për qytetarët e Bashkimit por që në përmbajtje bie në kundërshtim me një normë të caktuar të së Drejtës kombëtare?

Një konflikt i tillë ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe së Drejtës kombëtare mund të zgjidhet vetëm nëse njëri i hap rrugë tjetrit. E Drejta e Bashkimit nuk përmban dispozitë të shprehur për këtë çështje. Asnjë nga Traktatet e Bashkimit nuk përmban dispozita që të parashikojnë, për shembull, se e Drejta e Bashkimit ka përparësi ose varet nga e Drejta kombëtare. Megjithatë, e vetmja mënyrë për të zgjidhur konfliktet ndërmjet të Drejtës së Bashkimit dhe së Drejtës kombëtare është t'i jepet përparësi të Drejtës së Bashkimit dhe të lejohet që këtë përparësi ajo ta ketë mbi të gjitha dispozitat kombëtare, që devijon nga një normë e Bashkimit, duke zënë vendin e tyre në rendet juridike kombëtare. Në

fund të fundit, pak do të mbetet nga rendi juridik i BE-së, nëse do të varej nga e Drejta kombëtare. Normat e Bashkimit mund të mënjanoheshin nga çdo norme e së Drejtës kombëtare. Nuk do të shtrohej më çështja e zbatimit uniforme dhe të barabarte të së Drejtës së Bashkimit në të gjitha Shtetet Anëtare. As BE-ja nuk do të ishte në gjendje të kryente detyrat që i janë ngarkuar nga Shtetet Anëtare. Aftësia e Bashkimit për të funksionuar, do të rrezikohej dhe ndërtimi i një Europe të bashkuar, tek e cila ka kaq shumë shpresë, nuk do të arrihej kurrë.

Probleme të tilla lidhur me raportet ndërmjet së Drejtës ndërkombëtare dhe së Drejtës kombëtare, nuk ekzistojnë. Nisur nga fakti që e Drejta ndërkombëtare nuk bëhet pjesë e rendit juridik të një vendi, derisa të përthithet me anë të një akti inkorporimi ose transpozimi, çështja e epërsisë vendoset vetëm në bazë të së Drejtës kombëtare. Në varësi të radhës së përparësisë që i jepet së Drejtës ndërkombëtare nga një sistem juridik kombëtar, mund të ketë përparësi mbi të drejtën kushtetuese dhe legjislacionin e zakonshëm, ose të ketë thjesht të njëjtin status si ligj. Marrëdhënia ndërmjet së Drejtës ndërkombëtare të inkorporuar ose transpozuar dhe së Drejtës kombëtare, përcaktohet duke zbatuar rregullin sipas të cilit dispozitat ë miratuara më së fundmi, kanë përparësi ndaj atyre të miratuara më përpara (lex posterior derogat legi priori). Megjithatë, këto norma kombëtare për konfliktin e të Drejtave nuk janë të vlefshme për raportet ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe së Drejtës kombëtare, sepse e Drejta e Bashkimit nuk bën pjesë në ndonjë rend juridik kombëtar. Çdo konflikt ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe së Drejtës kombëtare, mund të zgjidhet vetëm në bazë të rendit juridik të BE-së.

Edhe një herë i takoi Gjykatës së Drejtësisë, që nisur nga këto pasoja, - pavarësisht prej kundërshtimit nga disa Shtete Anëtare – të përcaktonte parimin e përparësisë të së drejtës së Bashkimit, si themelor, për vetë ekzistencën e rendit juridik të BE-së. Duke vepruar kështu, ajo ndërtoi shtyllën e dytë të rendit juridik të BE-së, krahas parimit të zbatimit të drejtpërdrejtë, që do ta kthente me në fund këtë rend juridik në një strukturë të qëndrueshme.

Tek ëcështja *Costa v ENEL*, Gjykata bëri dy konstatime të rëndësishme lidhur me marrëdhënien ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe së Drejtës kombëtare.

- Shtetet Anëtare kanë transferuar përfundimisht të drejta sovrane te një Komunitet i krijuar prej tyre, prandaj masat e njëanshme që do të miratoheshin në vijim nuk do të ishin në përputhje me konceptin e së Drejtës së Bashkimit.

- Sipas Traktatit, parimi është që asnjë Shtet Anëtar nuk mund të verë në diskutim statusin e së Drejtës së Bashkimit, si një sistem i zbatueshëm në mënyrë uniforme dhe të përgjithshme në të gjithë BE-në.

Nga kjo rrjedh që e Drejta e Bashkimit që u zbatua në përputhje me kompetencat e parashtruara në Traktate, ka përparësi ndaj çdo dispozite ligjore e Shteteve Anëtare që bie në konflikt me të. Ajo jo vetëm që është më e fuqishme sesa normat e mëparshme të së drejtës kombëtare, por ka gjithashtu një efekt ndalues edhe ndaj ligjeve të miratuara më pas.

Së fundi, Gjykata nuk vuri në diskutim shtetëzimin e industrisë italiane të energjisë, por në mënyrë krejt të prerë ëpërcaktoi qartësisht përparësinë e së Drejtës së Bashkimit mbi të Drejtën kombëtare.

Pasoja juridike e rregullit të përparësisë është që në rast të një konflikti të drejtash, e Drejta kombëtare që është në kundërshtim me të Drejtën e Bashkimit, pushon së vepruari dhe nuk mund të miratohet ëlegjislacion i ri kombëtar, përveçse kur është në përputhje me të Drejtën e Bashkimit.

Që nga ajo kohë Gjykata i është përmbajtur këtij përfundimi dhe për me teper, në fakt, e ka zhvilluar atë më tej në një aspekt. Kështu, ndërsa vendimi në çështjen Costa kishte të bënte vetëm me çështje të përparësisë që ka e Drejta e Bashkimit ndaj së Drejtës kombëtare të zakonshme, Gjykata me pas konfirmoi parimin e përparësisë edhe lidhur me raportet ndërmjet së Drejtës të Bashkimit dhe së Drejtës kushtetuese kombëtare. Megjithëse në fillim kishin hezitime, gjykatat kombëtare e pranuan në parim interpretimin e bërë nga Gjykata e Drejtësisë. Në Hollandë nuk kishte vështirësi, sepse përparësia e Traktatit mbi të Drejtën kombëtare theksohet shprehimisht në kushtetutë (Nenet 65 deri në 67). Në Shtete të tjera Anëtare, parimi i përparësisë të së Drejtës së Bashkimit mbi të drejtën kombëtare, është njohur gjithashtu nga gjykatat kombëtare. Megjithatë, gjykatat kushtetuese të Gjermanisë dhe Italisë refuzuan fillimisht të praninin përparësinë e të Drejtës së Bashkimit mbi të Drejtën kushtetuese kombëtare, e në veçanti lidhur me mbrojtjen që u garantohej të drejtave themelore nga Kushtetutat e tyre. Ato hoqën dorë prej këtyre kundërshtimeve vetëm kur mbrojtja e të drejtave themelore në rendin juridik të BE-së kishte arritur një standard që, në thelb, i korrespondonte asaj të kushtetutave kombëtare. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e Republikës Federale të Gjermanisë vazhdon të ketë rezerva për një integrim të metejshëm,

siç e ka bërë shumë të qartë këtë në vendimet e saj për Traktatin e Mastrohrit dhe, më së fundi edhe për Traktatin e Lisbonës.

## **INTERPRETIMI I SË DREJTËS KOMBËTARE NË PËRPUTHJE ME TË DREJTËN E BASHKIMIT**

Për të parandaluar konfliktin ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe asaj kombëtare që lind nga zbatimi i parimit të përparësisë, të gjitha mekanizmat shtetërorë, insitucione apo gjykata, që zbatojnë ose interpretojnë legjislacionin kombëtar, duhet ta bëjnë këtë në përputhje me të Drejtën e Bashkimit.

U desh një kohë tepër e gjatë që koncepti i interpretimit në përputhje me të Drejtën e Bashkimit të njihet nga Gjykata e Drejtësisë dhe të përfshihej në rendin juridik të Bashkimit. Pasi Gjykata e Drejtësisë në fillim e konsideroi me vend të siguronte që të drejtat kombëtare të ishin në harmoni me një direktivë vetëm kur kjo kërkohej nga gjykatat kombëtare, për herë të parë në 1984 në çështjen Von Colson dhe Kamann vendosi ëdetyrimin për të interpretuar të Drejtën kombëtare në përputhje me direktivat. Kjo çështje kishte të bënte me shumën e shpërblimit që duhej dhënë për diskriminimin kundër grave lidhur me mundësinë për punësim. Ndërsa dispozitat ligjore respektive gjermane parashikonin vetëm për shpërblim për ‘Vertrauensschaden’ (dëmi për shkak të një pritshmërie legjitime), Direktiva 76/207/KEE përcakton se e drejta kombëtare mund të parashikojë sanksione efektive, në mënyrë që të garantojë mundësi të barabarta lidhur ëmes punësimin. Megjithatë, meqë sanksionet nuk ishin konkretizuar më tej, direktiva nuk mund të konsiderohej drejtpërdrejt e zbatueshme në këtë pikë, prandaj ekzistonte rreziku që Gjykates se Drejtësisë i duhej të vendoste që, edhe pse e Drejta kombëtare nuk përputhej me të Drejtën e Bashkimit, nuk kishte arsye që gjykatat kombëtare që të mos merrnin parasysh të Drejtën kombëtare. Prandaj Gjykata e Drejtësisë vendosi që gjykatat kombëtare ishin të detyruara të interpretonin dhe të zbatonin në një mënyrë të tillë legjislacionin kombëtar për çështje civile, me qëllim që të garantohej një sanksion efektiv ne rast të konstatimit të diskriminimit për shkak të gjinisë. Një shpërblim tepër simbolik nuk do të plotësonte kërkesën për zbatimin e efektshëm të direktivës.


Gjykata e Drejtësisë përcakton parimin e përgjithshëm të bashkëpunimit luajal (Neni 4(3) TBE) si bazë ligjore për interpretimin e të Drejtës kombëtare në përputhje me të Drejtën e Bashkimit. Sipas këtij neni, Shtetet Anëtare



duhet të marrin të gjitha masat e duhura, të përgjithshme apo të veçanta, për të siguruar plotësimin e detyrimeve që lindin nga Traktati i BE-së ose që rezultojnë nga veprim i ndërmarrë nga institucionet e Bashkimit. Prandaj autoritetet kombëtare janë gjithashtu të detyruara të ofrojnë interpretimin dhe aplikimin e së Drejtës kombëtare me formulimin dhe qëllimin e së Drejtës së Bashkimit (detyrimi për bashkëpunim). Për gjykatat kombëtare, kjo pasqyrohet në rolin e tyre si gjykata europiane, në kuptimin që ato sigurojnë zbatimin e drejtë dhe respektimin e së Drejtës komunitare.

Një formë e veçantë e interpretimit të së Drejtës kombëtare në përputhje me të Drejtën e Bashkimit është interpretimi në përputhje me direktivat, sipas të cilit Shtetet Anëtare janë të detyruara të zbatojnë direktivat. Zbatuesit e ligjit dhe Gjykatat ëduhet të ndihmojnë Shtetet e tyre Anëtare të plotësojnë tërësisht këtë detyrim, duke zbatuar parimin e interpretimit në përputhje me direktivat. Interpretimi i së Drejtës kombëtare në përputhje me direktivat siguron përputhje me direktivat në nivelin e të cilave zbatohet ligji dhe kështu siguron që e Drejta kombëtare e zbatueshmërisë të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë uniforme në të gjitha Shtetet Anëtare. Kjo nuk lejon që çështjet të cilat sapo janë harmonizuar në nivel të Bashkimit me anë të direktivës, të diferencohen në nivel kombëtar.

Kufijtë e interpretimit të së Drejtës kombëtare në përputhje me të Drejtën komunitare qëndrojnë në formulimin e qartë të së Drejtës kombëtare që nuk është i hapur për interpretim; edhe pse, sipas së Drejtës komunitare, ekziston detyrimi për të interpretuar të Drejtën kombëtare në përputhje me të Drejtën e Bashkimit, e Drejta kombëtare nuk mund të interpretohet ‘contra legem’(në kundërshtim me ligjin). Kjo vlen gjithashtu në çështje ku legjislatori kombëtar refuzon qartazi të transpozojë një direktivë në të Drejtën kombëtare. Një konflikt që rezulton ndërmjet së Drejtës së Bashkimit dhe së Drejtës kombëtare, mund të zgjidhet vetëm me anë të procedimit kundër Shteteve Anëtare për mospërmbushje të detyrimeve sipas Traktatit (Neni 258 dhe 259 i TFBEE).



27 shtator 1964, Bruksel.  
Një makinë me targë europiane, e parkuar përpara ndërtesës  
'Joyeuse entrée', selia e ardhshme e Komisionit European,  
e cila ishte në ndërtim.

EUR 2975

NICOLI

## Përfundime

Cila është pamja e përgjithshme e rendit juridik të BE-së?

Rendi juridik i BE-së është themeli i vërtetë i Bashkimit European, sepse i jep atij karakterin e një Komuniteti të së Drejtës. Vetëm duke krijuar legjislacionin të ri dhe duke e zbatuar atë, mund të arrihen objektivat themelorë të Bashkimit. Rendi juridik i BE-së ka arritur tashmë shumë në këtë drejtim. Falë këtij rendi të ri juridik, hapja e kufijve në shkallë të gjerë, tregtia me mallra dhe shërbime, migrimi i punëtorëve dhe numri i madh i lidhjeve ndërkombëtare ndërmjet kompanive në tregun e përbashkët, janë pjesë e jetës së përditshme për rreth 500 milion njerëz. Një veçori tjetër e rëndësishme historike e rendit juridik të Bashkimit është roli i tij në ruajtjen e paqes. Me objektivin e tij për të ruajtur paqen dhe lirinë, është bërë e mundur të zëvendësohet forca si mjet i zgjidhjes së konflikteve me norma të së drejtës që i bashkojnë si individët ashtu dhe Shtetet Anëtare në një Komunitet të vetëm. Si rezultat, rendi juridik i Bashkimit është instrument i rëndësishëm për garantimin dhe ruajtjen e paqes.

Tërësia e legjislacionit të BE-së dhe rendi i saj juridik mund të mbijetojnë vetëm nëse përputhshmëria dhe ruajtja e këtij rendi juridik garantohen nga dy kolona kryesore: parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë të së drejtës së Bashkimit dhe parimi i përparësisë të së drejtës së Bashkimit mbi të drejtën kombëtare. Këto dy parime, ekzistenca dhe ruajtja e të cilave mundësohet nga Gjykata e Drejtësisë, garantojnë zbatimin uniforme dhe më përparësi të së Drejtës së Bashkimit në të gjitha Shtetet Anëtare.

Rendi juridik i BE-së, me të gjitha mangësitë e tij, jep një kontribut të çmuar për zgjidhjen e problemeve politike, ekonomike dhe sociale të Shteteve Anëtare të Bashkimit.

# Shtojcë

## JURISPRUDENCA

### Natyrë dhe përparësia e legjislationit të Bashkimit

Çështja Gend & Loos [1963] ECR 1 (natyrë e së Drejtës së Bashkimit; të drejta dhe detyrime të individëve).

Çështja 6/64 Costa v ENEL [1964] ECR 1251 (natyrë e së Drejtës së Bashkimit; zbatueshmëria e drejtpërdrejtë, epërsia e së Drejtës së Bashkimit).

Çështja 14/83 Von Colson dhe Kamann [1984] ECR 1891 (interpretim i së Drejtës kombëtare në përputhje me të Drejtën e Bashkimit).

Çështja C-213/89 Factortame [1990] ECR I-2433 (zbatueshmëria e drejtpërdrejtë dhe epërsia e së Drejtës së Bashkimit).

Çështjet e Bashkuara C-6/90 dhe C-9/90 Francovich dhe të tjerë [1991] ECR I-5357 (efekti i së Drejtës së Bashkimit; përgjegjësia e Shteteve Anëtare për mospërbushje të detyrimeve të Bashkimit: mostranspozimi i një direktive).

Çështjet e Bashkuara C-46/93 dhe C-48/93 Brasserie du pêcheur and Factortame ECR I-9343 (epërsia e së Drejtës së Bashkimit; përgjegjësia e përgjithshme e Shteteve Anëtare për mospërbushje të detyrimeve të Bashkimit).

Çështjet e Bashkuara C-10/97 deri në C-22/97 IN.CO.GE '90 [1998] ECR I-6307 (epërsia e së Drejtës së Bashkimit).

Çështja C-416/00 Morellato [2003] ECR I-9343 (epërsia e së Drejtës së Bashkimit).

Çështjet e Bashkuara C-397/01 deri në C-403/01 Francovich dhe të tjerë [2004] ECR

(interpretim i së Drejtës kombëtare në përputhje me të Drejtën e Bashkimit)

### Kompetencat e BE-së

Çështja 8/55 Fédération charbonnière de Belgique [1954–1956] ECR 292 (kompetenca të nënkuptuara; caktimi zyrtar i çmimeve).

Çështja 22/70 AETR [1971] ECR 263 (personaliteti juridik dhe kompetenca të BE-së për hartimin e traktatit).

Çështja 6/76 Kramer [1976] ECR 1279 (marrëdhëniet e jashtme; angazhimet ndërkombëtare; autoriteti i BE-së).

Opinion 1/91 [1993] ECR I-6079 (Marrëveshja I ZEE ; shpërndarja e kompetencave).

Opinion 2/91 [1993] ECR I-1061 (shpërndarja e kompetencave ndërmjet BE-së dhe Shteteve Anëtare).

Opinion 1/94 [1994] ECR I-5267  
(Marrëveshja OBT; shpërndarja e kompetencave)

Opinion 2/94 [1996] ECR I-1759  
(anëtarësimi i KE-së në KEDNJ;  
mungesa e kompetencave).

### Efektet e akteve ligjore

Çështja 2/74 Reyners [1974] ECR 631  
(zbatueshmëria e drejtpërdrejtë; liria e vendosjes).

Çështja 33/74 van Binsbergen  
[1974] ECR 1299 (zbatueshmëria e  
drejtpërdrejtë; ofrimi i shërbimeve).

Çështja 41/74 Van Duyn [1974] ECR  
1337 (zbatueshmëria e drejtpërdrejtë;  
liria e lëvizjes).

Çështja 11/77 Patrick [1977] ECR 1199  
(zbatueshmëria e drejtpërdrejtë; e  
drejta e vendosjes).

Çështja 70/83 Kloppenburg [1984]  
ECR 1075 (direktivat; zbatueshmëria e  
drejtpërdrejtë).

Çështja 152/84 Marshall [1986] ECR  
723 (direktivat; zbatueshmëria e  
drejtpërdrejtë).

Çështja 103/88 Costanzo [1989] ECR  
1861 (direktivat; zbatueshmëria e  
drejtpërdrejtë; kushtet; pasojat).

Çështja 322/88 Grimaldi [1989] ECR  
4407 (rekomandime; zbatueshmëria  
e drejtpërdrejtë ose mungesa e saj;  
respektimi nga gjykatat kombëtare).

Çështja C-188/89 Forster [1990]  
ECR I-3343 (direktiva; efekti i  
drejtpërdrejtë horizontal).

Çështja C-292/89 Antonissen [1991]  
ECR I-773 (deklarata në procesverbalin  
e Këshillit; status për qëllime  
interpretimi).

Çështja C-91/92 Faccini Dori [1994]  
ECR I-3325 (direktiva; efekti i  
drejtpërdrejtë horizontal).

Çështja C-431/92 Komisioni kundër  
Gjermanisë (Grosskotzenburg) [1995]  
ECR I-2189 (direktiva; efekti i së  
Drejtës objektive).

Çështja C-465/93 Atlanta  
Fruchthandelsgesellschaft [1995] ECR  
I-3761 (shqyrtimi i vlefshmërisë së një  
norme; titull paragjykimor; urdhërimi i  
masave të ndërmjetme; kushtet).

Çështja C-469/93 Chiquita Italia [1995]  
ECR I-4533 (efekt i drejtpërdrejtë i  
dispozitave të GATT dhe Konventës  
Lomé).

Çështja C-368/96 Generics [1998] ECR  
I-7967 (deklarata në procesverbalin  
e Këshillit; status për qëllime  
interpretimi).

Çështja C-144/01 Mangold [2005]  
ECR I-9981 (direktivë; efekti i  
drejtpërdrejtë horizontal).

### Të drejta themelore

Çështja 29/69 Stauder [1969] ECR  
419 (të drejta themelore; parimet e  
përgjithshme të së Drejtës).

Çështja 11/70 Internationale  
Handelsgesellschaft [1970] ECR  
1125 (të drejta themelore; parimet e  
përgjithshme të së Drejtës).

Çështja 146/73 dhe 166/73  
Rheinmühlen I, II [1974] ECR 33 dhe  
139 (deri në ç'pikë gjykatat kombëtare  
detyrohen nga vendimet e gjykatave  
më të larta).

Çështja 4/73 Nold [1974] ECR 491  
(të drejta themelore; parimet e  
përgjithshme të së Drejtës; tradita të  
përbashkëta kushtetuese).

Çështja 175/73 Amalgamated  
European Public Service Union [1974]  
ECR 917 (liria për të krijuar shoqata).

Çështja 130/75 Prais [1976] ECR 1589  
(liria e fesë dhe besimit).

Çështja 149/77 Defrenne [1978] ECR  
1381 (të drejta themelore; parimet e  
përgjithshme të së Drejtës).

Çështja 44/79 Hauer [1979] ECR  
3727 (të drejta themelore; parimet e  
përgjithshme të së Drejtës).

Çështja 85/79 Hoffmann-La Roche  
[1979] ECR 461 (të drejta themelore;  
parimi i së Drejtës për t'u dëgjuar).

Çështja 293/83 Gravier [1985] ECR  
593 (trajtim i barabartë; tarifat e  
studentëve).

Çështja 234/85 Keller [1986] ECR 2897  
(liria për të ushtruar një zanat ose  
profesion).

Çështje të Bashkuara 46/87 dhe  
227/88 Hoechst [1989] ECR 2919  
(të drejta themelore; parimi i së  
Drejtës për t'u dëgjuar; procedura  
administrative; paprekshmëria e  
shtëpisë; referencë në KEDNJ).

Çështja 265/87 Schröder [1989] ECR 2263  
(e drejta e pronësisë; liria për të ushtruar  
një zanat ose profesion; kufizimet).

Çështja 5/88 Wachauf [1989] ECR 2633  
(kufizime mbi të drejtat themelore).

Çështja C-219/91 Ter Voort [1992] ECR  
I-5485 (liria e shprehjes).

Çështja C-97/91 Borelli [1992] ECR  
I-6313 (të drejta themelore; e drejta  
për të ngritur padi në gjykata).

Çështja C-357/89 Raulin [1992] ECR  
I-1027 (trajtim i barabartë; ndalimi i  
diskriminimit për arsye kombësie).

Çështja C-144/91 Mangold [1992] ECR  
I-4165 (të drejta themelore; e drejta  
e vendosjes; liria për të ushtruar një  
zanat ose profesion).

Çështja C-2/92 Bostock [1994] ECR  
I-4165 (të drejta themelore; e drejta  
e pronësisë; liria për të ushtruar një  
zanat ose profesion; respektimi në  
zbatimin e BE-së)

Çështja C-280/93 Gjermania kundër  
Këshillit [1994] ECR I-5065 (e drejta  
e pronësisë; liria për të ushtruar një  
zanat ose profesion; kufizime në  
interesin publik).

Çështja C-415/93 Bosman dhe të  
tjerë [1995] ECR I-4921 (të drejta  
themelore; liria për të ushtruar një  
zanat ose profesion).

Çështja C-55/94 Gebhard [1995] ECR  
I-4165 (të drejta themelore; e drejta  
e vendosjes; liria për të ushtruar një  
zanat ose profesion).

Opinion 2/94 [1996] ECR I-1759 (të drejta themelore; aderimi i BE-së në KEDNJ).

Çështja C-377/98 Holanda kundër Parlamentit dhe Këshillit [2001] ECR I-7079 (dinjiteti i njeriut; e drejta për integritet fizik).

Çështja C-274/99 P, Connolly [2001] ECR I-1611 (liria e mendimit).

Çështja C-60/00 Carpenter [2002] ECR I-6279 (mbrojtja e familjes).

Çështja C-112/00 Schmidberger [2003] ECR I-5659 (kufijtë e të drejtave themelore komunitare; liria e tubimit dhe liria e mendimit).

Çështja C-276/01 Steffensen [2003] ECR I-3735 (e drejta për mbrojtje ligjore të efektshme).

Çështja C-25/02 Rinke [2003] ECR I-8349 (parimi i përgjithshëm i barazisë).

Çështja C-36/02 Omega [2004] ECR I-9609 (kufijtë e të drejtave themelore komunitare).

## **PARIMET E PËRGJITHSHME TË SË DREJTËS (PËRZGJEDHJE)**

### **Siguria juridike**

Çështje të Bashkuara 18/65 dhe 35/65 Gutmann [1967] ECR 61.

Çështja 98/78 Racke [1979] ECR 69.

Çështja 96/78 Decker [1979] ECR 101.

Çështja 61/79 Denkavit [1980] ECR 1205.

Çështjet 66/79, 127/79 dhe 128/79 Salumi [1980] ECR 1237.

Çështja 70/83 Kloppenburg [1984] ECR 1075.

Çështje të Bashkuara T-551/93 dhe T-231/94 deri në T-234/94 Industrias Pesqueras Campos dhe të tjerë [1996] ECR II-247

Çështje të Bashkuara T-116/01 dhe T-118/01 P & O European Ferries (Vizcaya) kundër

Komisionit [2003] ECR II-2957.

### **Proporcionaliteti**

Çështja 116/76 Granaria [1977] ECR 1247. Çështja 265/87 Schröder [1989] ECR 2237. Çështja C-161/96 Südzucker [1998] ECR I-281.

Çështja C-171/03 Toeters [2004] ECR I-10945.

### **Mbrojtja e pritshmërive legjitime**

Çështja 74/74 CNTA [1975] ECR 533.

Çështja 120/86 Mulder [1988] ECR 2321.

Çështja 170/86 Von Deetzen [1988] ECR 2355.

Çështja C-368/89 Crispoltoni I [1991] ECR I-3695.

Çështja T-119/95 Hauer [1998] ECR II-2713.

### Parimi i subsidiaritetit

Çështja T-29/92 SPO [1995] ECR II-289.

Çështja C-84/94 Mbretëria e Bashkuar kundër Këshillit [1996] ECR I-5755.

Çështje të Bashkuara C-36/97 dhe C-37/97 Kellinhusen dhe Këtëlsen [1998] ECR I-6337. I-6337.

Çështja C-491/01 British American Tobacco (Investments) and Imperial Tobacco [2002] ECR I-11453.

### Shtetësia e Bashkimit

Çështja C-85/96 Martínez Sala [1998] ECR I-2691.

Çështja C-184/99 Grzelczyk [2001] ECR I-6193.

Çështja C-224/98 d’Hoop [2002] ECR I-6191. Çështja C-413/99 Baumbast [2002]

ECR I-7091.

Çështja C-403/03 Schempp [2005] ECR I-6421.







Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009, pasi u ratifikua nga të 27 Shtetet Anëtare të Bashkimit European dhe solli mjaft ndryshime në legjislacionin dhe institucionet europiane.

ABC-ja e legjislacionit të Bashkimit European, e shkruar nga Klaus-Dieter Borchardt analizon zanafillat dhe zhvillimet e projektit european si një rend ligjor dhe përbën pa asnjë dyshim një burim reference për këto çështje.

Autori jep një shpjegim se si është ndërtuar Bashkimi European, parimet e tij themelore dhe rendin ligjor në mbështetje të tyre, duke e parë këtë në raport me ligjet kombëtare të Shteteve Anëtare.

Ky libër është i dizenuar për njerëz pa njohuri të specializuara ligjore të cilët dëshirojnë të kuptojnë efektet e legjislacionit european mbi jetën e tyre të përditëshme.

## ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit European

*Profesor Klaus-Dieter Borchardt*

Botuar nga:  
Ministria e Integritimit  
Rruga Papa Gjon Pali II, Nr. 3, Tiranë, Shqipëri.